



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 JANAR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
22. JANUARA 2009. GODINE

JANAR - JANUAR
2009

E enjte, më 22.01.2009, ora 10:00

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar, mirëmëngjesi !

I hap punimet e seancës së parë plenare të sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatohet se në sallë janë 98 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet për t'ia filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Për rend dite është lajmëruar kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë,

Unë do të shtroja dy çështje të cilat konsideroj se duhet të jenë në rend të ditës në këtë seancë. Çështja e parë ose pika e parë është se ky Kuvend ka angazhuar Komisionin për Legjislacion për një rezolutë për krimet e komunizmit tash e rreth 3 muaj, prandaj konsideroj se janë plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret që kjo rezolutë të trajtohet sot në rend të ditës. Dhe, së dyti, çështja... e ditëve të fundit që ka të bëjë me zgjedhjet. Kërkoj që një pikë e veçantë të rendit të ditës të jetë debati për zgjedhjet parlamentare në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Megjithatë, këtu tash kemi dy mocione. Për fjalë është lajmëruar edhe deputeti Smaka. Mendoj që nëse ke diçka tjetër, apo po vazhdojmë me dy mocionet që i ngriti shefi juaj i grupit parlamentar. Fjalën e ka deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar,
Më 10 nëntor të vitit 2008, grupi prej 6 deputetësh ia ka adresuar Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës amendamentin në rendin e ditës së radhës - Kuvendit të Republikës, për radhitjen e çështjes referuar Trustit Kursimor Pensional të Kosovës, konform nenit 23, paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Ishte dashur që brenda 3 javësh, më së largu, të radhitej kjo temë, por nuk është radhitur në disa seanca. Pyes, pse dhe a e ka shqyrtuar Kryesia, a ka farë konkluzioni në këtë drejtim? Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dëgjuat kërkesën e shefit të Grupit të AKR-së, do të thotë i ka dy kërkesa. Kërkesa e parë është rezoluta dhe, kërkesa e dytë, debati për zgjedhjet. Ne e

kemi një praktikë që për këto çështje paraprakisht të prononcohen shefat e grupeve parlamentare. Unë kërkoj nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që të deklarohet në emër të Grupit. Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Për pikën e parë që e shtroi zoti Makolli, jam që të futet në rend të ditës, sepse ajo rezolutë që është kërkuar të hartohet nga Komisioni për Legjislacion, ka bërë gati tre muaj. Për pikën e dytë do të duhej pak kohë, mbase për t'u konsultuar me grupet parlamentare, andaj për pikën e dytë kemi rezervat tona. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën shefi i Grupit, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet punën e Komisionit për sjelljen e rezolutës sa më shpejt që dënon komunizmin. Aq sa ne jemi të njoftuar, kjo rezolutë është duke u punuar në Komisionin për Legjislacion, sa më shpejtë që vjen në Parlament, mendoj që do të vijë radha dhe koha për të diskutuar dhe për ta marrë qëndrimin tonë.

Sa i përket çështjes së dytë, detyrë kushtetuese e Presidentit të Republikës është që në konsultim me partitë politike të vendosë këtë çështje. Tashmë e kemi një qartësim. Për debatet për çështjet që kërkojnë vazhdimisht, ne do të kemi mundësi që të konsultohemi më vonë, por në momentin që e kemi një vendim, apo një qartësim të kësaj çështje, mendoj që debatet vetëm vazhdojnë të sjellin konfuzion edhe më shumë. Sidoqoftë, ne do të jemi të gatshëm të konsultohemi, por detyra kushtetuese i takon Presidentit, Presidenti në konsultim me Qeverinë dhe me partitë politike vendos për këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, e ka fjalën deputeti Lulzim Zeneli .

LULZIM ZENELI: Sa i përket pikës së parë për sjelljen e rezolutës për miratim në Kuvendin e Kosovës, grupi ynë parlamentar ka dhënë kontributin në komisionin përkatës dhe ne shpresojmë që shumë shpejt kjo do ta marrë dimensionin përfundimtar që seanca plenare të vendosë.

Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë, Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe grupi i saj parlamentar kanë bërë të qartë qëndrimet e tyre, që janë të njohura për opinionin. Për çështjet që kanë të bëjnë dhe janë të interesit të përbashkët, ne kërkojmë që të shtrohen seriozisht dhe të arrihet një konsensus ndërpartiak, është çështje e Kryetarit të vendit që

kjo të arrihet sa më shpejtë. Pra, Grupi Parlamentar i LDD-së do t'i përdorë të gjitha format që kjo çështje në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi të adresohet sa më parë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi i Grupit, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!

Propozimi për rezolutë mendojmë se do të duhej të ishte në rend të ditës, mirëpo me qenë se nuk është nuk mund ta fusim sot, ne besojmë se në një seancë të radhës ky do të duhej të radhitej.

Ndërsa, sa i përket debatit për zgjedhjet, mendojmë se edhe ky debat duhet të jetë çështje e diskutimit në Kuvend, mirëpo prapë duhet të ketë kohë që deputetët të përgatiten, kështu që nuk është një çështje e cila mund të futet në rend të ditës sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputetja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK:

Teşekkür ederim.

Sayın İbrahim Makolinin birinci teklifini, yani komunizmlle ilgili gündeme alınmasını öneriyoruz. İkinci noktayla ilgili yorumumuz yok.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedice,
Poštovani gospodine premijeru,
Vladin kabinetu,
Uvažene kolege poslanici,

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke kada bude dobila tekst rezolucije koju komisija radi, izjasniće se o tome, znači danas ne može se uvrsti u dnevni red. Što se tiče izbora, slažem se da se treba praviti dogovor sa predsjednikom i političkim partijama, međutim mislim da još nije došlo vreme da se o tome raspravlja u Skupštini i da to bude prioritet celog društva zato što ima mnogo ozbiljnih stvari. Ja bi se više bavio posledicama globalne ekonomske krize, koja može lako da pogodi i ovo područje i mnogim drugim stvarima, a ukoliko bude bilo koncensusa političkih partija da se tako nešto dogodi, da se uvrsti i u Skupštinu, znači i možda će doći i do toga. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Kam për obligim ta njoftoj Kuvendin, më falni që s'e bëra më herët! Kemi të formuar grupin parlamentar “Zajedno” dhe kemi njoftimin se Vezira Emrush është shefe e Grupit. Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Slaviša Petković, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Za prvu tačku ne znam šta je bitno, šta je tu skupštinski bitno, dali se osudjuju zločini komunizma ili ne.

Što se druge tačke tiče, pošto nam sledi rasprava o radu Vlade, godišnji izveštaj sledeće sednice, tako da se će tu videti da li treba otvarati raspravu izborima ili ne. Znači, rezultati Vlade će pokazati koliko su nam potrebni izbori. Tako za danas ne mislim da treba to bude na dnevni red.

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të shkojmë në votim për mocionin e parë, kërkoj prononcimin e kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Pas ngarkesash që kemi marrë nga Kuvendi i Kosovës, ne brenda afatit të paraparë kemi hartuar Rezolutën. Ajo është dërguar me kohë në Sekretarinë e Kuvendit, është në të gjitha gjuhët dhe është e gatshme. Ka marrë edhe raportin përfundimtar nga Komisioni për Buxhet që nuk ka implikime buxhetore. Pra, nëse Kuvendi vendos që të diskutohet sot për rezolutën, janë të gjitha mundësitë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, sipas procedurave shkojmë në votim të dy mocioneve, në fillim të parin, pastaj të dytin.

Fillimisht votojmë për mocionin për ta futur në rend të ditës Rezolutën për dënimin e krimeve të komunizmit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 31 “kundër” dhe 13 abstenime, Kuvendi e futi në rend të ditës Rezolutën që dënon krimet e komunizmit, pika e fundit e rendit të ditës për seancën e sotshme dhe lus Administratën që ta shpërndajë tekstin e Rezolutës të përgatitur nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Në radhë e kemi mocionin e dytë, të kërkuar nga shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, për të bërë debat për zgjedhjet.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “kundër”, 23 “për” dhe 8 abstenime, Kuvendi nuk e futi këtë pikë - mocionin e dytë të AKR-së në rend të ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

- **Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 11, 15, 16, 18 dhe 19 dhjetor 2008**

Të nderuar deputetë,

Procesverbalet dhe transkriptet e seancave plenare të mbajtura më 11, 15, 16, 18 dhe 19 dhjetor 2008, u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në këto procesverbale? Nuk kanë. Atëherë konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 11, 15, 16, 18 dhe 19 dhjetor 2008.

Pika e dytë e radhës, është:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Pyetja e parë, Suzan Novobrdaliu, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, Kryetar!
Përshëndetje për të gjithë,

Qyteti antik mesjetar i Novobërdës është një nga vendet më turistike në Kosovë, sidomos Kalaja e Novobërdës. Por, ky qytet me vlera të larta kulturore, historike është lënë pas dore si shumë vende të tjera kulturore- turistike. Që të vizitohet Kalaja, nuk ka rrugë të asfaltuar, ndriçim, shenja orientuese dhe ciceron. Pyetja, zoti Kryeministër: A do të jetë prioritet i vitit 2009 kthimi në identitetin e këtij vendi turistik dhe kulturor me qëllim që të rritet numri i turistëve?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën!
Ju njoftoj se në sallë janë 105 deputetë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete Novobrdaliu,
Të nderuar deputetë,
Pajtohem se deri më tani nuk ka pasur një përkujdesje institucionale- shtetërore për Kalanë e Novobërdës. Gjithashtu, unë e kam vizituar Kalanë, por nga ky vit mund t'ju informoj se është ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në kuadër të këtyre prioritetëve të investimeve kapitale ky projekt do të implementohet në tri vitet e ardhshme. Është ndarë edhe buxheti për vitet 2009, 2010 dhe 2011, pra për mandatin qeverisës. Për vitin 2009, 60.000 euro, për vitin 2010, 100.000 € dhe për vitin 2011, 100.000 €, gjithashtu.

Aktivitetet konkrete që do të ndërmerren janë, do të thotë, harta arkeologjike e zonës, incizimi i objekteve arkitektonike, hartimi i projekteve restauruese, hartimi i planit menaxhues, hartimi i planit të promovimit.

Ndërsa, sa i përket infrastrukturës rrugore, sigurisht se do të hartohet apo është duke u punuar një plan- projekt i përbashkët i tri ministrive : Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Transportit dhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me komunën përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Pyetja e radhës është nga deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin e Punës dhe të Çështjeve Sociale, zotin Nenad Rashiq. Deputet, mund ta parashtroni pyetjen!

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sayın Bakan

65 yaşını doldurmamış vatandaşlarımızın büyük bir çoğunluğu Kosova Cumhuriyeti dışındaki farklı ülkelerden emeklilik maaşı veya maddi sosyal yardım alıyorken, bu kişilerin çoğu eş zamanda Kosova Cumhuriyeti Bütçesinden de emeklilik maaşı veya maddi sosyal yardım almaktadır. Diğer taraftan gerçekten maddi sosyal yardıma ihtiyacı olan ne Kosova Cumhuriyetinden, ne de dışından hiçbir maddi destek görmeyen henüz 65 yaşını doldurmamış, ancak sağlık durumları nedeniyle vazife malülü vatandaşlarımızın sayısı da az değildir.

Sayın Bakan

Vatandaşların bu konudaki ağlaşılarını göz önünde bulundurarak, ihtiyaç sahibi diğer kişilerin sayılarında artış sağlamak maksadıyla daha elverişli koşulların yaratılması konusunda Bakanlığınızın rolü ne olacaktır.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Poštovani premijeru,

Zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Enis, hvala na pitanju! Kao što verovatno i vi znate, upoznati ste da naša šema koju imamo i 32 regionalna centra, koji su svugde prisutni u evidenciji ljudi koji primaju beneficije od nas, odnosno o kojima se staramo, je do sad bila vrlo detaljna, precizna. Ja ne kažem da se nisu dešavali određeni propusti, da određeni individualci nisu bili registrovani na vreme, ali ono što mi sa terena znamo, je to da je sve u glavnom pod kontrolom. Samo ovom decentralizacijom i sam ovim prenosom ovlašćenja, kao što znate, ti će centri za socijalni rad biti pod opštinama, tako da će moža to doprineti da i sama opština bude više uključena, odgovornija da te standarde i da sve te ljude, koje oni sigurno najbolje znaju, mogu da okluče ukoliko se desilo da je bilo nekih propusta.

Što se tiče same naše šeme, tu su uključeni svi ljudi, svi stanovnici Kosova i nema za sad nikakvih potreba da bi trebala biti stvarana neka druga šema koja bi pre svega iziskivala mnogo vremena, mnogo truda a i novca, da bi to što se tiče vašeg pitanja, mogli da uradimo na način da ljudi određeni dobiju ili nedobiju određenu penziju ili socijalnu

pomoć, jer kao što znate, ljudi koji su prethodno radili u nekim drugim državama i nekim drugim mestima imaju absolutno pravo i to je unutar zakona tih drugih mesta, dali će njima da daju penziju ili socijalnu pomoć ili šta već. Mi se samo trudimo da u vezi naših ljudi, naših korisnika sa naše šeme da njihova prava u potpunosti ispoštujemo. Tako da mislim da je ovo ono šta je u našoj mogućnosti i ono što ćemo se truditi da što blje uradimo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, ke pyetje shtesë?

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti ministër!
Por, ankohen qytetarët e Kosovës, sepse me të vërtetë ekzistojnë ligjet në ato vende jashtë Kosovës, që qytetarët e Kosovës të cilët kanë punuar dhe që momentalisht marrin pensione edhe jashtë vendit apo ndihmë sociale prej rajonit apo diku tjetër, në të njëjtën kohë marrin edhe prej buxhetit të Kosovës. Ndërkaq, qytetarët e tjerë të Kosovës, të cilët me të vërtetë meritojnë edhe duhet të marrin ndihmë sociale, nuk kanë mundësi për shkak të çështjeve të cilat i dimë të gjithë. Pra, për këtë e pata fjalën- a do të formoni ndonjë komision brenda Qeverisë së Kosovës apo brenda Ministrisë që ta ndërpresim këtë, me të vërtetë qytetarët të cilët marrin ndihmë sociale edhe jashtë vendit, por edhe nga buxheti i Kosovës, sepse është një shumë e madhe e qytetarëve të cilët meritojnë të marrin këtë ndihmë sociale?

KRETARI: Zoti ministër,

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Enis, da vam kažem ovako vrlo iskreno, da bi mi to mogli da ostvarimo, treba da imamo jednu globalnu mrežu svetsku, gde bi mi mogli da znamo šta ko prima iz kojeg regiona, iz koje države. Znači, pošto je to u ovom momentu vrlo teško izvodljivo, ja mislim da je to možda u nekom futurističkom vremenu, možda ubuduće da postoji ta neka globalna mreža, ali sad u ovom momentu, stvarno mislim da nije realno da očekujemo da možemo da znamo što ko prima iz raznih drugih mesta, raznih zemalja iz Evrope, sveta ili iz Afrike, recimo. Tako da u ovom momentu nije realno da imamo takvu bazu podataka. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!
Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Punës dhe të Çështjeve Sociale, zotin Nenad Rashiq. Deputet Zemaj, e ke fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
Unë, vitin e kaluar e kam lexuar këtë pyetje. Nëse e ka mbajtur në mend ministri, mirë, nëse nuk e ka mbajtur, le të përgjigjet.

KRYETARI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, predsedniče!
Poštovani deputete,
Poštovani poslanici,
Znam da je pitanje koje ste postavili bilo u vezi zaustavljanja, eliminiranja opasnih poslova i mi smo već usvojili u Vladi jedno administratvo uputstvo, vrlo precizirano šta

se misli, odnosno koje su kategorije računate kao deca, tako da čak i sa vrlo bitnim detaljima u vezi toga koliko bi samo dete moglo ili mlad čovek da bude angažovan u određenim poslovima. To je već potpisano, ja mislim pre mesec i po dana, i radili već smo puno na tome. Mi smo već formirali komitet koji unutar Ministarstva, funkcioniše već nekih 5 ili 6 meseci i dosad je bilo održano 6 sastanaka koji su bili baš u tom pravcu za eliminisanje tih poslova i, kao rezultat toga, izabrali smo tri opštine koje će biti kao probni balon, ili pilot projekat, koji će pokazati kakve će rezultate imati administrativno upustvo na baš te opštine, tako da su ti centri za socijalni rad i socijalni radnici u tim opštinama, a to su: Obilić, Gnjilane, i ..., izvinjavam se, i Drenas, tako da ćemo od njih prve informacije koje budemo dobili, upotrebiti za kasniju implementaciju u svim opštinama. To je znači, ono što smo uradili u zadnjem periodu i rukovodićemo se saznanjima koja budemo dobili sa ovog pilot projekta. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shitesë?

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër, edhe unë mbes me shpresë që është një çështje e ndjeshme për fëmijët që janë në Republikën e Kosovës dhe për punët që detyrohen. E dyta, e dëshmove se je një ministër i mençur, sepse të kanë akuzuar disa bashkëkombës tuaj se nuk je shumë i mençur, e paske mbajtur në mend pyetjen prej vitit të kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pyetja e radhës, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministren e Energjetikës, zonjën Justina Pula.
Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!
Kosova vazhdon të vuaj nga mungesa e energjisë elektrike. Kjo po shkakton probleme të mëdha në zhvillimin dhe funksionimin e jetës në Kosovë, si të familjeve, ashtu edhe të bizneseve.

Qeveria e kaluar për zgjidhjen e këtij problemi pati shpallur projektin e Termocentralit “Kosova C”, ndërsa Qeveria aktuale ka shpallur projektin e Termocentralit “Kosova e Re”.

Zonja ministre, cili është dallimi ndërmjet këtyre dy projekteve?

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA JUSTINA PULA: I nderuari Kryetar i Parlamentit,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
E nderuara deputete Gjylnaze,

Para se të jap përgjigjen në pyetjen tuaj, së pari dua të ndërlidhem me fjalinë tuaj: “Kosova vazhdon të vuaj nga mungesa e energjisë elektrike”.

Përkrahja e gjithanshme që Qeveria ka bërë, duke pasur parasysh edhe iniciativën e punëtorëve dhe të menaxhmentit të KEK-ut, unë mendoj se kemi shënuar rezultate të dukshme në vitin 2008.

Rezultatet me të mira deri më tani janë shënuar në nxjerrjen - mihjen e linjtit- në prodhim, në faturim dhe në inkasim. Plani i prodhimit, i bazuar në bilancin elektroenergjetik të vitit 2008, shënon një tejkalim dhe është një prej periudhave më të mira që është prodhuar ndonjëherë energjia elektrike.

Nxjerrja e qymyrit dhe deponitë të cilat janë në Termocentralet A dhe B, kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme, të mos them të paparapara gjatë periudhave të këtyre nëntë vjetëve.

Në fushën e faturimit dhe të inkasimit ka rezultate të dukshme. Faturimi është realizuar diku rreth 25%, ndërsa inkasimi rreth 19%. Qeveria do të vazhdojë ta përkrahë KEK-un për ta rritur performansën e tij në vitin 2009, që do të rezultojë me një rezultat shumë më të mirë se në vitin 2008.

Konsumi është në rritje, prandaj është paraparë të ndërtohet termocentrali i ri dhe projektet tjera sikur që është projekti i Zhurit dhe 16 hidrocentrale të vogla.

Projekti i ri, në fakt, është emri “Kosova e re”, është emri i ri i projektit, ndërsa emërtimi “Kosova C” është sinonim i vazhdimësisë së projekteve ekzistuese të termocentraleve A dhe B, të cilët janë kapacitete shumë të vjetruara 40 vjet apo 25 vjet. Për këtë arsye, ky projekt ka të bëjë me një teknologji shumë më të avancuar, me një efikasitet më të gjitha masat sa iu përket direktivave të Bashkësisë Evropiane.

Termocentrali i ri, në fakt, do t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe besoj që do të jetë shumë më i avancuar se kapacitet gjeneruese të cilat janë menduar me projektin C, si vazhdimësi. Ndërkohë, kemi një shtet të ri, kemi një projekt të ri, e kemi një komitet drejtues, me një strukturë të re dhe me një numër të ri të anëtarëve Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Zonja ministre, është e qartë nga përgjigja juaj që nuk ka asnjë dallim. Keni mundur shkurt dhe qartë ta thoni që s’ka dallim. Pyetja ime është: -Pse po vonoheni tash më shumë se një vit për ta zgjidhur këtë problem? Qytetarët sigurisht që nuk përfitojnë nga kjo vonesë, por çka përfiton Qeveria?

MINSITRJA JUSTINA PULA: Kemi një komitet të ri tash, kemi një strukturë të re, kemi një numër të ri të anëtarëve të Komitetit, kemi një koncept shumë të ri sa i përket projektit të ri. Nuk kemi dashur të shpejtojmë, sikurse që kanë dashur qeveritë para nesh. Prandaj, kemi një vizion të qartë, të lutem, do të vijë deri të ndryshimi i paketës, përfitimeve dhe shumë çështje nga të cilat do të përfitojë populli i Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputeti Hajdin Abazi, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputet, e ke fjalën!

HAJDIN ABAZI: Në të vërtetë, unë i kam dy pyetje për zotin ministër, por besoj që i ka marrë të dyja. Pra, po e lexoj pyetjen e parë.

Në Ferizaj me rrethinë është një numër i madh i njerëzve që kanë nevojë për shërbime të dializës. Ministria e juaj e ka kuptuar rëndësinë e kësaj nevojë dhe ka realizuar objektin dhe teknologjinë e nevojshme, por problem është kuadri mjekësor me kompetencë për ta përdorur këtë teknologji dhe për ta futur, pra, në funksion.

Pyetja shtrohet: -Kur parasheh dhe kur do të ketë mundësi Ministria që ta realizojë edhe kuadrin, që sa më parë të vihet në funksion gjithë kjo që është përgatitur gjer me tani në komunën e Ferizajt?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti deputet,

Fillimisht, më lejoni t'ju përgëzoj për përkujdesjen në kontinuitet që e keni për qytetarët e Ferizajt, me vizita të shpeshta në Ministrinë e Shëndetësisë, me zgjidhjen e problemit të qytetarëve që ju kanë votuar.

Në Republikën e Kosovës kemi qendra të dializës, ku përdoret aparatura më e sofistikuar dhe materiali shpenzues më i mirë i kohës në të cilën jetojmë. Në komunën e Ferizajt gravitojnë diku rreth 35 pacientë, të cilët aktualisht dializën e bëjnë në Spitalin rajonal të Gjilanit.

Në mungesë të fondeve për një kohë të gjatë, Ministria e Shëndetësisë nuk ka mund ta zgjidhë këtë problem dhe vitin e kaluar ne i kemi dhënë prioritet themelimit të një qendre të dializës në Ferizaj, projekt i cili ka filluar vite më parë.

Duke mos pasur mjete, kemi kërkuar që për vazhdim të kontratës për gjashtë muaj, të Frezinusit, që të na japë një donacion për ndërtimin e qendrës në Ferizaj. Qendra në Ferizaj është ndërtuar, pajisja ka ardhur, është testuar dhe përrurimi do të bëhet më 17 shkurt, në njëvjetorin e pavarësisë së vendit tonë.

Sa i përket numrit të mjekëve dhe punëtorëve tjerë, ne jemi të ndërgjegjshëm për kufizimet që i kemi nga Ministra e Ekonomisë dhe Financave, si kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar, por duke iu falënderuar Kabinetit të Kryeministrit dhe vendimit të Qeverisë për rritje të numrit të mjekëve për 91, ne do të bëjmë maksimumin që dy mjekë, tre mjekë apo sa të ketë nevojë nga Qendra Klinike, nga konkursi i Qendrës Klinike Universitare që të dedikohen për atë spital. Pra, shpresojmë që qytetarët të cilët në ditë kanë udhëtuar më se 80 deri 100 km për një dializë, ashtu tri herë në javë, do ta kenë një qendër shumë të mirë të dializës në Ferizaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë? Jo! Ju faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputet, e keni fjalën!

RIZA SMAKA: Zoti ministër,

Çështje problemore e referuar dispozitës së nenit 295 të Ligjit nr. 0270 për sigurimin e komunikacionit rrugor. Kjo është pyetja: Aplikimi edhe problemet rreth aplikimit në praktikë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Ministra të nderuar, deputetë,

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Policia e Kosovës vazhdimisht harton projekte dhe plane operative për ta ngritur vetëdijen e pjesëmarrësve në komunikacion dhe për të ngritur nivelin e sigurisë në rrjetin rrugor të Republikës së Kosovës. Në këto projekte qëllim kryesor është zvogëlimi i numrit të aksidenteve rrugore, e posaçërisht ulja e numrit të aksidenteve me fatalitete. Po ashtu, edhe për çështje të tilla konkrete dhe për gjithçka që është në përputhje me ligjin, Ministria e Punëve të Brendshme ka një koordinim dhe bashkëpunim edhe me Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

Lidhur me ngasjen e mjeteve motorike nga ana e drejtuesve të mjeteve me kohëzgjatje të tejkaluar sipas rregullave në fuqi, Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar disa plane të quajtura, të cilat janë zbatuar edhe punuar, po ashtu, nga policia, automjetet transportuese, ku i është kushtuar një kujdes i veçantë mjeteve me mbi 3.5 tonë që qarkullojnë në rrjetin rrugor, e sidomos të atyre mjeteve që qarkullojnë si transit nëpër vendin tonë dhe paraqesin një rrezik permanent për qytetarët dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor.

Kontrolli i drejtuesve të mjeteve mbi 3.5 tonë nga ana e policisë bëhet duke kontrolluar tahografin që është një proces i zakonshëm dhe duke kërkuar dokumentacionin, i cili përmban pushimet apo itinerarin e çdo mjeti, varësisht prej veprimtarisë e cila kryhet. Ndërsa, kontrollin e shoferëve- instruktorëve, krahas kontrollit që e kryen policia e Kosovës, e kryejnë edhe inspektorët e Ministrisë së Transportit.

Në bazë të analizave që hartohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, për gjendjen e sigurisë në rrjetin rrugor të Republikës së Kosovës, mund të themi se policia e Kosovës, respektivisht policia e trafikut, ka ndëshkuar rreth 1000 drejtues të mjeteve gjatë vitit 2008 për moszbatim të kohëzgjatjes të drejtimit të mjetit motorik me mbi 3.5 tonë. Ndërsa, duke analizuar faktorët kontribuues të ndodhjes së aksidenteve rrugore, në përgjithësi del se ky faktor nuk është faktori kryesor për aksidente. Më lejoni t'i them këta faktorë sipas radhitjes.

Faktorët tjerë kontribuues, sipas radhitjes janë: tejkalimi i shpejtësisë; manipulimi i pasigurt me automjet; mospërshtatja e shpejtësisë kushteve të rrugës dhe atyre atmosferike, gjendja jo e rregullt teknike e automjetit etj. Pra, ky është një faktor, por nuk është faktor që është në rangun kryesor të aksidenteve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputet, ke pyetje shtesë? Ju faleminderit edhe nga ana e juaj!

Deputeti Hajdin Abazi, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.
Deputet, e ke fjalën!

HAJDIN ABAZI: Zoti ministër, Qendra spitalore e Ferizajt ndodhet në brendi të qytetit, kurse për shërbime gravitojnë aty komuna e Kaçanikut, të Hanit të Elezit, të Shtërpçës dhe të Shtimes, shpesh ndodh edhe të Vitisë dhe të Lipjanit, kështu që për shkak të ngarkimit të trafikut është problematike hyrja në qytet, në rastet emergjente sidomos. Prandaj, pyetja ime është, sa vijon: -Meqenëse ka hapësirë në territorin e komunës së Ferizajt, a ka Ministria e Shëndetësisë ndonjë plan që të realizojë një qendër spitalore, të paktën sa i përket emergjencës, diku përkaj vije magjistrale, me qëllim që shërbimet edhe për qytetarët, por edhe për komunat që gravitojnë përreth të jenë më të lehta dhe kështu të ketë mundësi për shërbime më adekuate?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit!

Zoti deputet, rrjeti i objekteve shëndetësore të Republikës së Kosovës deri në pavarësi ka qenë rrjet i një ish sistemi dhe për një shtet të pavarur, ku shërbimet duhet të jenë të integruara, emergjenca duhet t'i përshtatet edhe infrastrukturës tjetër. Duke parë dinamikën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore, ne kemi ardhur në përfundim që na nevojitet një analizë detaje e ekspertëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë që ne ta bëjmë rikonfigurimin e emergjencave në Republikën e Kosovës. Ai studim nga konsulentët e Bankës Botërore dhe, në veçanti, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, është kryer dhe gjatë shkurtit do ta kemi rekomandimin, të cilin ne do ta respektojmë.

Gjatë kësaj kohe, në Ministri të Shëndetësisë dhe në mbështetje të Qeverisë, një grup i ekspertëve të vendit tonë ka qenë në trajnime për emergjencë në qendrat më të mira të trajnimeve dhe besoj që një prej rekomandimeve, bie fjala, do të jetë që ne ta kemi një qendër të emergjencës diku afër Komoranit, si udhëkryq, por edhe në Ferizaj, sepse është udhëkryq edhe ajo pjesë është diku për më se 350.000 banorë.

Sa i përket lokacionit, unë kam biseduar me kryetarin e Ferizajt dhe besoj që kryetari i komunës së Ferizajt do të na japë një lokacion të përshtatshëm që në këtë udhëkryq, i cili besojmë do të jetë i rëndësishëm, të jetë një qendër emergjente që ju ofron ndihmë qytetarëve të vendit. Po ashtu, edhe në drejtim të Podujevës, për shkak të rrugës e cila pritet në vitet e ardhshme të funksionalizohet, do të jetë një qendër e re emergjente, por për vitin 2008, është vit i përgatitjes së projekteve dhe besojmë që në planin buxhetor për vitin 2010 do të fillojë ekzekutimi i tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetje shesë? Nuk ka! Ju faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.
Deputete, e keni radhën e fjalës!

GJYLNAZE SYLA: Nëntë vite pas përfundimit të luftës, Kosova ende ballafaqohet me një problem shumë të rëndësishëm dhe të ndjeshëm, siç është çështja e personave të pagjetur. Sipas të dhënave të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në Kosovë tani janë afërsisht 2000 të pagjetur, mbi 800 mbetje mortore janë gjetur në territorin e Serbisë, në Batajnicë, Pertrovosellë, Peruçac.

Pyes Kryeministrin, a ka ngritur Qeveria e Kosovës padi penale ndaj Serbisë për vrasjen, zhvendosjen e kufomave dhe fshehjen e krimit?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ka qenë një prej problemeve kjo që është diskutuar tash e dhjetë vjet prej të gjitha qeverive të Kosovës, por edhe Qeveria që e udhëheq unë, tanimë Qeveria e Republikës së Kosovës, angazhohet që krimet të cilat janë kryer të zbardhen në tërësi dhe kryerësit e këtyre krimeve të dalin para drejtësisë sa më parë që është e mundur.

Familjet që kanë humbur të dashurit e tyre duhet të gjejnë drejtësi për dhimbjet dhe vuajtjet që u janë shkaktuar, por natyrisht duhet të jetë një drejtësi që është kërkuar, po kërkohet edhe prej institucioneve të Kosovës.

Gjithashtu, në sferën e brendshme, institucionet kosovare të drejtësisë janë ende në konsolidim e sipër, duke zhvilluar potencialet e veta për hetime dhe ndjekjen e plotë të krimit.

Në aspektin ndërkombëtar, ne i mbështesim përpjekjet e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë.

Ndëshkimi i krimeve të rënda, të spastrimit etnik dhe të gjenocidit, rëndom nuk është i mjaftueshëm për një popull nëse nuk përcillet me një katarsis të brendshëm dhe kërkimfalje të sinqertë. Vetëm kjo është garanci se krimet dhe qëllimet për të kryer krime nuk do të ndodhin edhe në të ardhmen.

Ne, veprimet tona të mëtutjeshme, si institucione të Republikës së Kosovës, do t'i bëjmë në koordinim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, çështja e të pagjeturve është çështje e faktit të gjallë për gjenocidin që ka ushtruar Serbia në Kosovë. A keni kërkuar ju konform, siç ka mbështetje tjera, që Serbia ta reduktojë ushtrinë e vet që gjenocidi mos të përsëritet, si argument shumë të rëndësishëm, njëri nga këto argumente dhe mos të na ngajë që Jeremiqi të dalë me kundërshtime kundër Forcës së Sigurisë?

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, ti po kërkon nga unë diçka që duhet të ndërmarrë Uashingtoni, Brukseli dhe NATO. Unë nuk mund të ndërhyjë në çështje të brendshme të transformimeve të ushtrive nacionale të vendeve në rajon, por për gjithë ne si institucione, si popull, ajo që ka bërë Serbia në Kosovë, e ka vetëm një emër. Ai është gjenocid.

Tash, unë si Kryeministër i Kosovës, me të gjitha autoritetet tjera institucionale kemi diskutuar, me Kryqin e Kuq, me të gjitha autoritetet ndërkombëtare dhe kjo çështje do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe do të jetë një prej çështjeve më të diskutueshme që të zgjidhet sa më shpejtë që është e mundur.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Kryeministër!

Radha është për deputeten Myrvete Pantina. Pyetje për Ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku.

Deputete, e ke fjalën!

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kosova ka marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë me disa vende të rajonit dhe është pjesë e marrëveshjes për tregti të lirë të Evropës Qendrore apo CEFTA-n.

Prodhuesit kosovarë përballen me konkurrencën e madhe në tregun vendor. Shumë herë produktet sezonale vendore nuk mund të shiten në tregun e vendit për shkak të hyrjes së sasisë së madhe të mallrave nga importi.

Zoti ministër, Ministria e juaj çka po ndërmerr për t'i mbrojtur produktet sezonale vendore?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuari Kryetar,
Kryeministër,
Ministra, të nderuar deputetë,
E nderuara deputete

Më lejoni së pari t'ju informoj se katër marrëveshje bilaterale me Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnjën e Hercegovinën e Kroacinë janë konsoliduar në marrëveshjen për tregti të lirë të Evropës Qendrore, të njohur si marrëveshje CEFTA 2006, e cila ka hyrë në fuqi në gjysmën e dytë të vitit 2007. Ndër objektiva tjera, si nxitja e investime, zgjerimi i tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, sigurimi i kushteve të drejta të konkurrencës, mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, kjo marrëveshje ka për objektiv edhe eliminimin e barrierave dhe të deformimeve të tregtisë.

Neni 2 i Marrëveshjes përcakton se një ndër obligimet themelore është që tarifat bazë doganore janë ato që aplikojnë në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, e të cilat duhet t'iu nënshtrohen reduktimeve të mëvonshme, ndërsa neni 3 përcakton se të gjitha kufizimet sasiore duhet të shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, nëse nuk do të vendosen kurrfarë kufizimesh të reja sasiore.

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova nuk ka pasur pothuajse fare tarifa doganore, përjashtuar një numër të vogël produktesh me Kroacinë, si qumështi, gjalpi dhe yndyrat, djathi, mishi i konservuar dhe zarzavatet e konservuara dhe, natyrisht, kurrfarë kufizimesh sasiore për importe dhe me të gjitha shtetet anëtare të CEFTA-s dhe, rrjedhimisht, në përputhje me nenet e cekura më lartë, ne nuk kemi të drejtë të vendosim tarifa të reja doganore apo kufizime të ndryshme sasiore. Natyrisht,

duke marrë parasysh specifikën e produkteve bujqësore, Marrëveshja me nenin 11 obligon palët që të eliminojnë të gjitha subvencionet në këtë fushë. Megjithatë, në mënyrë që t'i mbrojmë prodhimet tona nga ndonjë praktikë e tillë eventuale, MTI-a ka hartuar dhe përmes Qeverisë ka përcjellë në Parlament Projektligjin për masat antidamping, i cili ka kaluar në leximin e parë. Ndër të tjera, ky Projektligj parasheh themelimin e Komisionit për Hetimin e Importeve të dampuara apo të subvencionuara, i cili pas hetimit të hollësishëm në vendin eksportues merr masa mbrojtëse në përputhje me Marrëveshjen e përgjithshme mbi tregtinë dhe tarifën, të njohur si GAT, gjegjësisht rregullat e OBT-së.

Aktualisht Qeveria e Kosovës ka krijuar lehtësira fiskale për fermerët, duke marrë parasysh se të gjitha imputet e nevojshme bujqësore janë të liruara nga të gjitha ngarkesat fiskale, kurse të gjitha pajisjet dhe mekanizmi i nevojshëm bujqësor janë të liruara nga tarifën doganore prej 10%.

Në anën tjetër, MTI-ja po angazhohet në edukimin e fermerëve që ata të planifikojnë më mirë se ku mund të jenë konkurrues me prodhimet e tyre në treg dhe të ndryshojnë praktikën e nxjerrjes së menjëhershme të prodhimeve të tyre në treg.

Në fund, më lejoni t'ju informoj se javën e ardhshme do të mblidhet Komiteti për Bujqësi i CEFTA-s, ku janë paraparë bisedime bilaterale me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kroacinë mbi harmonizimin e masave sanitare dhe fitosanitare me qëllim të eliminimit të barrierave jotarifore dhe rritjes së eksportit të prodhimeve tona. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë?
Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, ne e dimë që Kosova nuk ka pasur tarifa doganore, nuk ka përdorur deri më tani, mirëpo me vendet me të cilat ka marrëveshje Kosova për marrëdhënie tregtare, a respektohet parimi reciprocitetit apo, së paku, a keni kërkuar që të respektohet ky parim me vendet nënshkruese të Marrëveshjes.

KRYETARI: Ministër, keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Pos opstrukcioneve nga ana e Serbisë dhe e Bosnjës e Hercegovinës, që tanimë e dini, në aspektet tjera, sa u përket produkteve bujqësore, Marrëveshja respektohet.

KRYETARI: Ju faleminderit, Ministër!
Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.
Deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër, Qeveria e Republikës së Kosovës me vend, me kohë, kohë më parë e ka pas formuar Komisionin për implementimin e ligjeve. Rendi juridik i Kosovës është shumë i ndërlikuar, ka së paku tri burime juridike dhe ekziston një laramani e akteve juridike të përgjithshme sa u përket burimeve dhe natyrës, karakterit dhe, si të them

kështu, terminologjive juridike dhe në praktikë janë gjasat se ka shumë kolizione dhe probleme rreth aplikimit. Si qëndron çështja e këtij Komisioni, nuk është dhënë asnjë raport deri më tash për punën e këtij Komisioni, për funksionin e tij që iu ka besuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Smaka! Komisioni është formuar, është duke punuar, gjithçka do të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, keni pyetje shtesë? Nuk ke! Ju faleminderit! Deputetë, Ministri i Shërbimeve Publike është në udhëtim zyrtar. Kalojmë në pyetjen tjetër. Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete, e ke fjalën!

TEUTA HADRI: Zoti ministër, pyetja ime e kaluar u është bërë juve për çështjet e rimbursimit të punëtorëve shëndetësorë, që ua keni ndaluar dhe dëmtuar në pagë që nga 2003 dhe, ju zoti ministër, para këtij Parlamenti jeni zotuar se këto pagesa do t'u kthehen shumë shpejtë pjesë-pjesë punëtorëve shëndetësorë. Pyetja: Po, sot, si do t'i përgjigjeni këtij Parlamenti, pse këto para nuk janë kthyer dhe kush po i mban këto para?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, e nderuara zonja deputete! Ashtu siç kam thënë këtu, në Kuvendin e Kosovës, ashtu edhe është duke u vepruar lidhur me këtë çështje.

Rimbursimi, dhënia e certifikatave dhe deklaratat e rimbursimit janë në proces për të gjithë punëtorët shëndetësorë të vendit tonë. Ky proces ka filluar në një bashkëpunim intensiv me Sindikatën Shëndetësore të Mjekësisë, përmes procesit të trajnimeve të përbashkëta në mënyrë që kjo punë të kryhet dhe për këtë qëllim, ju garantoj se nuk ka shmangie nga realizimi. Realiteti i administratës tonë është ky që është, që ne nuk kemi një sistem elektronik të integruar, ku me disa veprime mund të kryhet ky proces për të gjithë punëtorët shëndetësorë dhe fakti qëndron se realizimi i rimbursimit dallon prej një njësie në njësi tjetër buxhetore. Bie fjala, nga raportet që i kemi lidhur me këtë çështje nga Gjilani, ata informojnë se i kanë kryer deri në vitin 2008 të gjitha dhe tash janë në përfundim të këtyre punëve sa i përket pjesës së dytë të vitit 2008. Po ashtu, Vushtrria informon që janë kryer për të gjithë, një pjesë e madhe është kryer edhe në Pejë. Në Qendrën Klinike Universitare, menaxhmenti i tyre e ka bërë kthimin për të gjithë ata që në Qendrën Klinike Universitare punojnë si punë të dytë, do të thotë janë në pjesën arsimore, ndërsa këtu e kanë vetëm pjesën shëndetësore, për të cilën kanë pasur ndalesa diku për 20%. ndërsa për punëtorët tjerë të Qendrës Klinike Universitare ky proces ende nuk është i përforcuar dhe aty veprohet sipas një Rregulloreje, që është numër 2004/52 mbi tatimin e të ardhurave personale. Qendra Klinike ka kërkuar mbështetje në staf, sepse kjo kërkon një punë më të madhe dhe ne jemi duke bërë përpjekje që t'i ndihmojmë me kuadër që ky proces, i cili për ne është i pandalshëm, ne

nuk do të ndalemi derisa të kryhet për të gjithë qytetarët. Nuk kemi marrë asnjë masë që kjo të ndërpritet, përkundrazi e kemi filluar procesin, jemi në bashkëpunim me sindikatën dhe ne na vjen keq që nuk kemi në Republikën tonë administratë digjitale, që kjo....

(ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Faleminderit, ministër! A keni pyetje shtesë, apo vazhdoni një pyetje tjetër që e keni? Urdhëroni, deputete!

TEUTA HADRI: Zoti ministër, ka dyshime se këto pagesa të punëtorëve janë kah keqpërdoren, nuk dihen bankat, nuk dihet kodi dhe dihet se prej 2003 deri sot janë 6 vite që këto janë me kamatë. Kush e shfrytëzon këtë kamatë që kanë ndej në bankë, ju apo QKUK, duhet të dihet! Sqaroni para Parlamentit dhe punëtorëve, për kamata?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Zonja deputete, kjo është vetëm një prej çështjeve që nga fillimi i mandatit jemi duke e zgjidhur dhe që janë të grumbulluara që nga viti 2003. Kemi arritur që ta përfundojmë me sukses problemin e grumbulluar për trajtim jashtë vendit nga viti 2003 deri në fund të vitit 2008. Këtë çështje e kemi trashëguar nga viti 2003 dhe besoj që së shpejti do të përfundojë. Është një angazhim i shtuar i njësive buxhetore të punëtorëve në shëndetësi. Unë kam besim të plotë se Agjencia Tatimore e Republikës së Kosovës i respekton ligjet në fuqi dhe besoj se kjo çështje do të kryhet me sukses dhe, nëse dikush e shkel ligjin, natyrisht që do të përgjigjet. Unë nuk jam në dijeni që dikush merr kamata individuale për këtë çështje. Ministria e Shëndetësisë, sigurisht jo! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Teutë Hadri, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete, e ke fjalën!

TEUTË HADRI: Zoti ministër, punëtorët shëndetësorë ju ngarkojnë juve me përgjegjësi për ndaljen dhe zbritjen e kujdestarive edhe asht aq të vogla nga 10 euro në shtatë, që ua keni bërë, se ju keni thyer vendimin e mëparshëm që është marrë për ngritjen e kujdestarive. Pyetja: Me çfarë dhe a ka vendim Ministria juaj dhe pse është ndalur kjo pagesë dhe nuk i keni njoftuar punëtorët me ndonjë vendim që po ndalet?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, deputete Hadri! Ju njoftoj se Ministria e Shëndetësisë nuk ka rekomanduar asnjë masë, as që ka marrë ndonjë vendim lidhur me kujdestari. Vendimi është i brendshëm, është pjesë e menaxhmentit të Qendrës Klinike Universitare, e cila ka qenë e shtyrë që në mungesë të fondeve të mjaftueshme për muajin tetor që t'i paguajë të gjithë, ka vendosur që për të gjithë ta bëjë një zbritje të njëjtë, që ta paguajë kujdestarinë e tetorit, ndërsa atë pjesë të borxhit ta shpaguajë në vitin 2009. Bie fjala, mjeku specialist në një kujdestari të rëndomtë jashtë vikendit, paguhet 19,52 centë, ndërsa të premtëve paguhet, bie fjala, 39,04 centë dhe në vend të 39 eurove, menaxhmenti i ka paguar për muajin tetor nga 32 euro për kujdestari, ndërsa për infermiere, në vend të 11,12 centë, i ka paguar 7 euro, ndërsa këtë pjesën tjetër ka mbet

borxh, i cili do të paguhet gjatë vitit 2009. Ne nuk kemi marrë asnjë vendim për zbritje, as për ndalesë, kjo është ekskluzivisht kompetencë e tyre dhe ne do t'i mbështesim me ndonjë mbulesë eventuale të ndonjë borxhi, por ata janë të obliguar që t'i përcjellin me shumë kujdes të hyrat vetanake dhe ta respektojnë marrëveshjen e mirëkuptimit që e kanë me ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a ke pyetje shtesë?

TEUTË HADRI: Zoti ministër, kush është përgjegjës për këtë vendim që ju e keni thyer këtë memorandum të mirëkuptimit të kaluar dhe a jeni ju – QKUK, kush po i thyen këto vendime, kur ju po e thyni edhe vendimin tuaj që e keni marrë me numër 80/2008 për 40 euro dhe kush përgjigjet për këto thyerje?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Zonja deputete, Ministria e Shëndetësisë as unë nuk kam thyer asnjë vendim, të cilin ju e citoni. Çështjen e kujdestarive për muajin tetor e ka vendosur menaxhmenti i Qendrës Klinike Universitare, i shtyrë që të bëjë një pagesë uniforme për të gjithë, duke hyrë në obligim që atë pjesë ta plotësojë gjatë vitit 2009. Lidhur me 44 euro, që është pjesë e stimulimit për mbështetje të reformave, paguhet ekskluzivisht nga të hyrat vetanake, të hyrat vetanake që mblidhen gjatë një muaji duhet të barazohen në Ministri të Ekonomisë dhe të financave, të përfillen të gjitha procedurat të cilat janë dhe nëse të hyrat mblidhen, do të ketë mbështetje, nëse të hyrat nuk mblidhen, atëherë natyrisht se nuk do të ketë mbështetje. Kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë janë spitalet dhe Qendra Klinike Universitare, ndërsa sistemi primar është kompetencë e komunave dhe ai problem zgjidhet në nivel atje ku është e përcaktuar me ligj, në nivel komunal. Nuk kemi thyer kurrfarë vendimi!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashit. Deputete, e ke fjalën! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi!

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër i Shëndetësisë, renovimi i Klinikës Neurologjike po zgjatë qe 5 muaj. Ndërkohë, prej muajit nëntor punimet janë ndalur tërësisht, edhe pse renovimi i objektit është brenda, duke lënë Klinikën në kushte shumë të rënda për punë, me vetëm dy dhoma për të sëmurët e paralizuar dhe shumë të rëndë. Për shkak të kushteve shumë të rënda, mjekët kujdestarë janë të detyruar t'i kthejnë të sëmurët në shtëpi, me ç'rast iu nënshtrohen kërcënimeve dhe maltretimeve të shpeshta. E pyes ministrin e Shëndetësisë, pse është ndalur renovimi i Klinikës Neurologjike?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zonja deputete! Më lejoni që fillimisht t'ju them fjalën e fundit, që punimet aty nuk janë ndalur. Sa i përket kronologjisë, projekti për renovimin e Klinikës Interne është një prej projekteve të vitit 2008. Ne kemi angazhime shtesë që të bëjmë renovimin e të gjitha institucioneve gradualisht, në kuadër të mundësive tona buxhetore. Si pjesë e Projektit për vitin 2008, kanë qenë të ndara diku

400.000 euro. Fillimi i implementimit ka qenë më 18 prill, pasi që në mungesë të ofertuesve të përgjegjshëm, më 23 qershor është ripërsëritur konkursi – tenderi, apo si quhet, dhe punimet kanë filluar më 9 shtator të vitit 2008. Për shkak të moslëshimit të hapësirës që të kryhen punët njëkohësisht në tërë objektin, ka filluar punimi i pjesërisht, aq sa ju keni lejuar hapësirë për punëdhënësin. Andaj, kjo punë është duke u vazhduar. Ne na vjen keq që është gjatë dimrit dhe ky proces do të kryhet gjatë marsit. Ne asnjëherë nuk e kemi ndaluar punën. Sikur hapësira të ishte lejuar, të ishte liruar me kohë që të punohet në tërë objektin, kjo kishte për t'u kryer më shpejt, por kryhet më ngadalë. Ne na vjen keq, por nuk kemi pasur mundësi tjera.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju e keni keqkuptuar... Nuk po rinovohet Klinika Interne, por Klinika Neurologjike dhe punët janë ndaluar, sepse unë shkoj çdo ditë në mëngjes atje dhe ata ju akuzojnë juve që ua keni ndaluar pagesën dhe kisha pët t'ju lutur që të mos i relativizoni gjërat, sepse na keni marrë në qafë, edhe punëtorët shëndetësorë, edhe të sëmurët.

MINISTRI ALUSH GASHI: Kuvendi është shumë vend i mirë për kuvend, por kërkon korrektësi. Sa i përket ndaljes së pagesave, kjo nuk qëndron, por ne si Ministri dhe si Qeveri nuk do të financojmë projekte pa mbulesë. Për këtë projekt gjatë vitit pagesat janë realizuar në vlerë 199.963,26 centë dhe janë të ndara për vitin 2009, pasi ta kryejnë punën, jo pa e kryer punën, si përpara. Janë të ndara 159.449,29 centë, i presin në ditën e përfundimit të punimeve, jo më herët.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar Kryemnistër,

Patëm fatin e hidhur që gjatë luftës dhe pas saj të vritet një numër i madh intelektualësh dhe veprimtarësh të shquar të çështjes kombëtare, siç ishin, ndër të tjerë: profesor Fehmi Agani, Bajram Kelmendi, Enver Maloku, Latif Berisha, Agim Hajrizi dhe, pas luftës, Xhemajl Mustafa, përfaqësues të komunave, siç ishin Ukë Bytyçi, Ismet Raci dhe deputeti i Parlamentit të Kosovës, zoti Ismajl Hajdari dhe disa të tjerë, të njohur për opinionin.

Zoti Kryeministër, kur do të rregullohet me ligj statusi i këtyre veprimtarëve të shquar dhe kur do të merren në përkujdesje institucionale familjet e tyre...

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Zonja Aliu,

Zonja dhe zotëri deputetë,

Të drejtat për pensione dhe benificione tjera të ndryshme për dëshmorët dhe për të tjerët të rënë në periudhat e ndryshme historike dhe kohore, për veprimtarët të çështjes kombëtare, janë të përcaktuara qartë në dispozitat e nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Përmes këtij projektligji është paraparë që të nxirret edhe një akt nënligjor nga Qeveria e Kosovës, ku i përcakton kriteret, kushtet dhe rrethanat e përcaktimit të statusit të tyre dhe ne jemi të bindur, e kemi diskutuar disa herë në Qeveri këtë çështje, jemi të bindur se me nxjerrjen e ligjit, me aktet nënligjore do të përcaktojmë në mënyrë të qartë për secilin individ në cilëndo periudhë kohore.

KRYETARI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, deputete? Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Zoti Kryeministër,

Përafërsisht, këtë pyetje e kam bërë edhe në mandatin e kaluar dhe sot e asaj dite nuk është zgjidhur statusi i këtyre veprimtarëve dhe familjet e tyre nuk janë marrë në përkujdesje institucionale. Por, unë, pas një informacioni para 4-5 dite, që e kam dëgjuar, do të thotë pas bërjes së pyetjes, kam shpresë që kjo çështje të zgjidhet shumë shpejt dhe kërkojmë nga ju që të mos vonohet kjo çështje. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Pyetje nuk ka! Faleminderit! Deputetë të nderuar, i kemi edhe pesë pyetje, nëse me pëlqimin tuaj vazhdojmë, përndryshe koha është harxhuar. A jeni dakord që t'i vazhdojmë edhe 5 pyetje dhe t'i kryejmë? Mirë, pasi e kemi prezencën edhe të ministrave, po vazhdojmë. Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputete, e ke fjalën!

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Kam informacione që në Burgun korrektues të Lipjanit ndodhet një numër i të rinjve, të cilët vuajnë dënimin për vepra të ndryshme penale. Zonja ministre, pyetja për ju është: Cilat janë masat që janë ndërmarrë dhe do të ndërmerren për ngritjen profesionale dhe intelektuale të këtyre të rinjve në mënyrë që këta të rinj, pas vuajtjes së dënimit të bëhen pjesë integruese dhe zhvillimore të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjala është për ju, zonja ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Posaçërisht, e nderuar zonja deputete Aliaj,

Përgjigja ime në pyetjen tuaj është: Në Qendrën korrektuese në Lipjan mbahen të miturit me masa të shqiptuara edukative dhe të miturit me dënim burgimi për të mitur, edhe femrat. Meqë interesimi juaj, deputete e nderuar, është për të miturit, do të përgjigjem direkt në pyetjen e shtruar.

Të miturit me masë edukative: Numri i të miturve me masë edukative në Qendrën Korrektuese në Lipjan është gjithsej 15, prej tyre shkollën fillore e vijnë 8 të mitur, kurse shkollën e mesme e vijnë 7. Pos arsimimit fillor dhe të mesëm, të miturit ndjekin

edhe trajnime në këto lëmi: për instalues të elektros -2, në lëmin e ndërtimtarisë -4 dhe në lëmin hidroinstalues -2. Trajnimet profesionale i kanë kryer 7 mitur të gjatë vitit kalendarik 2008.

Të miturit me dënim burgu për të mitur: Numri i të dënuarve me burg për të mitur në Qendrën Korrektuese në Lipjan është -12, prej tyre shkollën fillore e vijon -1, shkollën e mesme -6, kurse 5 të mitur e kanë përfunduar shkollën fillore dhe të mesme. Pos arsimimit fillor dhe të mesëm, ata ndjekin edhe trajnimet profesionale, në lëmin hidroinstalues -2 të mitur, në lëmin e kuzhinierisë, të kamerierëve dhe për përgatitjen e llojeve të ndryshme të ushqimit nga brumi, si picat, ëmbëlsirat, buka, kilet, burek e tjera – trajnimin e ndjekin 3 të mitur. Diplomat për aftësim profesional i lëshon Qendra komunale për punë sociale në Lipjan. Gjatë vitit kalendarik 2008, -7 të mitur i kanë kryer trajnimet profesionale.

Sa i përket arsimimit të të miturve, ju përkujtoj se Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Arsimit në vitin 2008 ka nënshkruar Memorandum mirëkuptimi, me të cilin këtyre të miturve iu mundësohet ndjekja e mësimi në lokale të veçanta të Qendrës korrektuese me pajisje adekuatë dhe plan-program të shkollave publike, në të cilin ligjëratat i mbajnë arsimtarët e shkollave publike të komunës së Lipjanit dhe dëftesat e diplomat për kryerjen e arsimit fillor dhe të mesëm i lëshon Drejtorati i Arsimit Komunal i Lipjanit. Femra të mitura në Qendrën korrektuese në Lipjan nuk ka, as me masë edukative, as të dënuara me burg për të mitur. Është vepruar kështu në mënyrë që të miturit të mos stigmatizohen dhe pas përfundimit të masës edukative apo të burgut, kur të dalin, të risocializohen dhe të mos kenë fare shenja se kanë qenë dikur në Qendrën korrektuese për të mitur...

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputete, a ke pyetje shtesë?

SANIJE ALIAJ: Jo!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputete, e ke fjalën! Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu!

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti Kryetar! Ju përshëndes të gjithëve! Një prej objektivave të Ministrisë së Drejtësisë është fillimi i aplikimit të reformave në sistemin e drejtësisë. Edhe përmes mediave flitet se do të bëhen reforma në sistemin e drejtësisë dhe së shpejti të gjithë gjyqtarët do të aplikojnë për rizgjedhje dhe riemërim. Zonja ministre, si është e mundur të bëhet zgjedhja e gjyqtarëve kur akoma nuk është aprovuar Ligji mbi gjykatat? Nëse është projekti gati, përse nuk është aprovuar në Kuvend? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: E nderuara, zonja deputete Shehu, Paraprakisht dëshiroj t'ua bëj me dije se nuk ka qenë dhe nuk është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë menaxhimi i gjykatave dhe i prokurorive të Kosovës, por kjo

është përgjegjësi e Këshillit Gjyqësor Prokurorial të Kosovës, që është aktualisht duke vepruar, e më vonë do të ndahen këto në dy pjesë.

Megjithatë, do t'i përgjigjem pyetjes tuaj, deputete e nderuar, për aq sa kam njohuri për çështjen që e keni ngritur në pyetjen tuaj.

Më 16 dhjetor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-123 për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky ligj rregullon përbërjen e përkohshme dhe punët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës gjatë shqyrtimit gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën të përshtatshmërisë së të gjithë kandidatëve për emërimet e përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë deri në pensionimin e tyre. Procesi i emërimit do të bëhet në përputhje me nenin 151 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këshilli është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, hartimin e rregullave të gjykatave, në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe dhënien e rekomandimeve për themelimin e gjykatave të reja. Përgjegjësitë e Këshillit ushtrohen në pajtim me nenin 11, paragrafi 2 të ligjit të cituar.

Prandaj, meqë me nxjerrjen e këtij ligji është krijuar baza ligjore, është e mundshme që të emërohen gjyqtarë dhe prokurorë në institucionet respektive. Pakoja e ligjeve: Ligji për gjykatat, Ligji për Prokurorinë, Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe Ligji për Këshillin Prokurorial, janë ligje me të cilat do të bëhet reforma gjyqësore, përkatësisht organizimi i institucioneve respektive gjyqësore e prokuroriale, kompetenca dhe shtrirja e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë i ka hartuar këto katër ligje dhe të njëjtat në tremujshin e parë të këtij viti do t'i dorëzohen Qeverisë, për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputete, a keni pyetje shtesë? Mirë! Faleminderit! Vazhdojmë! I kemi edhe 3 pyetje dhe të tria janë nga deputetja Njomza Emini. Po shkojmë sipas radhës. Pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar dhe deputetë, kolegë,

Zotëri Zhabir Zharku, kryetar i Komunës së Kaçanikut, është akuzuar për rrëmbim dhe detyrim, si dhe në shtëpinë e tij është gjetur armatim. Për, zotëri Zharkun ishte lëshuar edhe një arrest, si dhe është ngritur një padi ndaj tij. Sipas Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, neni 159, për një vepër të tillë penale kryerësi i veprës mund të dënohet me burgim deri në 5 vjet. Zotëri Zharku vazhdon të jetë kryetar i Komunës së Kaçanikut. Pyetja: Cili është qëndrimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal ndaj rastit të zotëri Zhabir Zharkut?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryeministër, të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Emini,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është kompetente dhe është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të ligjit në çdo rast, pra edhe kur bëhet fjalë për kryetarët dhe ekziston mundësia që të iniciohet procedura për suspendimin e kryetarit të komunës atëherë kur plotësohen kushtet e parapara me ligj, atëherë kur ka vendim të gjykatës, kur kryetari është penguar që ta ushtrojë detyrën e vet ose kur bie ndesh me Ligjin për vetëqeverisjen lokale – neni 56.3 në pikat a), d) dhe g), pra atëherë kur e ndërron vendbanimin ngase është detyrim të jetë qytetar i atij vendbanimi, atëherë kur ka vendim të gjykatës për vuajtje dënimi për më gjatë se 6 muaj dhe atëherë kur mungon në punë pa arsye për më gjatë se 3 muaj. Gjatë gjithë kohës tjetër, pra përveç këtyre kushteve, ne udhëheqim me parimin e prezymimit ose do të thotë të pafajësisë – deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Pra, edhe në këtë rast, kryetari ka të drejtë që të ushtrojë funksionin e tij deri në vendimin përfundimtar të gjykatës dhe të njoftoj se deri tash nuk kemi pasur rast që të plotësohen këto parakushte ligjore e që ne të bëjmë ndonjë veprim të ngjashëm edhe në raste të tjera. Kjo është. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Jo! Vazhdojmë me pyetjen e fundit, për shkak se ministrja s’e ka marrë pyetjen nga ana juaj. Deputetja Njomza Emini, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

NJOMZA EMINI: Po hyjmë në muajin e 12-të që kur policët e komunitetit serb marrin paga nga buxheti i Kosovës dhe nuk kryejnë detyrën zyrtare. Kemi dëgjuar disa deklarime, mirëpo ende nuk ka veprime konkrete për këtë problematikë. Po bëhen 12 muaj që këta policë paguhën duke mos shërbyer në policinë e Republikës së Kosovës. Pyetja: A do të vazhdojë Qeveria e Kosovës, me këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme, t’i paguajë policët e komunitetit serb edhe pse ata nuk e kryejnë detyrën zyrtare dhe mbi çfarë baze është marrë një vendim i tillë?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuar deputete,

Tanimë ju e dini që nga shpallja e pavarësisë jemi përballur me një abstenim të pjesëtarëve të policisë së Kosovës nga radhët e komunitetit serb. Ky refuzim i zinxhirit komandues ka ardhur edhe si pasojë e një presioni të vazhdueshëm që e kanë pasur këta pjesëtarë të policisë kryesisht nga jashtë vendit. Ne kemi ndjekur një qasje të matur kundrejt këtyre zhvillimeve duke bërë suspendimin me pagesë të tyre. Vendimi është marrë me qëllim të ruajtjes së karakterit multietnik të policisë së Kosovës. Edhe pse ka pasur vlerësime të ndryshme nga opinioni publik, ne kemi vlerësuar se kostoja financiare në këtë rast është më pak relevante se sa insistimi ynë që të mbetemi të kemi një polici multietnike. Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se pjesëtarët e policisë së Kosovës nga radhët e komunitetit serb janë ballafaquar me presion kryesisht nga Qeveria e Beogradit dhe disa liderë politikë e religjiozë të komunitetit serb këtu në Kosovë. Pozicioni ynë është shumë i qartë. Policët e suspenduar janë pjesë e institucioneve shtetërore të Kosovës dhe ne kemi po ashtu përgjegjësi për t’i mbrojtur dhe për t’i përkrahur ata edhe në momentet kur ata janë në një presion të vazhdueshëm. Në këtë frymë, ne po bëjmë dhe

do të bëjmë gjithçka që është në mundësinë tonë për t'i përkrahur që ata sa më shpejt ta tejkalojnë këtë gjendje. Në këtë kontekst, ne kemi vazhduar t'i inkurajojmë pjesëtarët serbë të policisë së Kosovës që të kthehen në vendet e tyre të punës dhe të kontribuojnë në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Më lejoni t'ju them, zonja deputete, që kohëve të fundit kemi reagime shumë pozitive edhe pas involvimit dhe mbështetjes së EULEX-it, reagime pozitive edhe nga takimet e përbashkëta nga bashkëpunimi që vjen edhe nga eprorët e policisë së Kosovës dhe takimet që i kanë po ashtu edhe me pjesëtarët serbë të policisë që veprojnë atje. Por, një gjë është tanimë e sigurt se nuk mund të vazhdohet gjatë një gjendje e tillë nëse nuk do të ketë lëvizje pozitive në këtë drejtim dhe ne planifikojmë marrjen e masave të cilat shpeshherë i kemi bërë publike dhe dëshiroj t'ju them po ashtu që kohëve të fundit kemi në adresë të Ministrisë së Punëve të Brendshme një interesim të shtuar të pjesëtarëve të komunitetit serb për t'u bërë pjesë e policisë së Kosovës. Kjo është inkurajuese, por gjithnjë mbetemi me insistimin për t'i kthyer ata.

Edhe ky qëndrim i yni po ashtu konsiston në një fakt tjetër, i cili është i rëndësishëm - investimi i gjatë disavjeçar që është bërë nga buxheti i Kosovës për t'i trajnuar ata, për t'i përgatitur ata për policë, prandaj

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën deputetes Njomza Emini!

NJOMZA EMINI: Sipas asaj që tha ministri, bashkëpunimi me policë serbë... Në këtë rast do të doja të dija sa është shifra që policët serbë janë kthyer dhe cili është numri i tyre deri më tani.

KRYETARI: Ke përgjigje? Urdhëroni!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju e dini, 10% zyrtarisht i kemi pjesë, 10% pjesë nga shuma e policisë që kemi. Ju e dini, tashmë i kemi 8.000. Prej kësaj pjese 350 kanë qenë ata që kanë refuzuar zinxhirin komandues, prej këtij numri 315 – 17 janë kthyer, zyrtarisht janë kthyer, 2 prej tyre kanë vdekur dhe jemi në proces.

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se dy pyetjet që ishin të drejtuara për ministrin Arsim Bajrami, në mungesë të tij, do të thotë mbesin për seancën e radhës dhe pyetja e deputetes Njomza Emini për ministren Justina Pula mbetet për seancën e radhës. Kështu, tani kemi përfunduar këtë pikë të rendit të ditës. Një pauzë deri në ora 12:00 dhe kthehemi për të vazhduar me pika të tjera të rendit të ditës.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUES I SEANCËS NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë, Vazhdojmë me punimet e seancës së Kuvendit. Në radhë është pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për biocide

Ju njoftoj se në sallë janë 64 deputetë dhe janë plotësuar kushtet që të vazhdojmë punën.

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar që, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara Kryesi,

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Në Kosovë, me legjislacionin mjedisor, legjislacionin për shëndetësi si dhe legjislacionin për mbrojtjen e bimëve, deri më tani fusha e produkteve biocide nuk është rregulluar.

Duke u bazuar në këtë, në praktikat e përvojat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mendojmë se është krijuar nevoja për këtë projektligj, me të cilin do të rregullohen vendosja në treg dhe përdorimi i produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës.

Projektligji ka për qëllim të adresojë çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore lidhur me administrimin e produkteve biocide. Ligji është i bazuar në direktivën 98/8 të Komisionit Evropian e cila, parimisht, është vlerësuar dhe aprovuar në nivel evropian. Kjo do të thotë se të gjitha produktet biocide pak a shumë janë të dëmshme, sepse shumica e tyre përbëhen nga substancat aktive të dëmshme.

Ligji për produktet biocide mundëson përdorimin e rregullt të produkteve biocide. Me këtë ligj janë përcaktuar kushtet e veçanta për përdoruesit e produkteve biocide, të cilat janë karakterizuar si të rrezikshme, shumë toksike, kancerogjene, mutagjene, toksike për reproduksion dhe të cilat nuk duhet të gjenden në shitje të lejuara.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është të caktojë dhe rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojë shëndetin e njeriut, të kafshëve dhe të mjedisit.

Mungesa e ligjit dhe zbrazësitë e deritanishme ligjore, e bën projektligjin të rëndësishëm së veçantë për shkak:

- se duhet kompletuar legjislacionin vendor në raport të nevojave për të vënë rregull në fushën e prodhimit, nxjerrjes në treg, përdorimit dhe monitorimit të produkteve biocide;
- të harmonizimit të rregullave me shtetet tjera të Bashkimit Evropian dhe me qëllim të qarkullimit të lirë të produkteve biocide në treg unik;
- se duhet harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian;

- se legjislacioni sekondar për produktet biocide duhet hartuar dhe për të duhet kohë mjaft e gjatë.

Projektligji është hartuar në bazë të rregullave të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores për Punën e Qeverisë së Kosovës.

Gjatë hartimit të këtij projektligji, për bazë është marrë legjislacioni i vendeve të rajonit. Për këtë projektligj është dhënë përkrahje edhe nga TAEX-i dhe se grupi i punës për hartimin e tij ka punuar së bashku me ekspertët e TAEX-it.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dispozitat e ligjeve që duhet përafruar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

Projektligji përmban 11 kapituj, 62 nene dhe plus 21 shtojca të ndara në dy grupacione.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë nga buxheti, përveç buxhetit të përcaktuar me vlerësim rregullativ dhe formular për vlerësim financiar.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj ta aprovonë në parim Ligjin për produktet biocide. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Nëse kërkon fjalën kryetari i komisionit parlamentar funksional? Jo! Kalojmë në radhën e grupeve parlamentare. Për fjalë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, është paraqitur deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për produktet biocide dhe jo si është në rendin e ditës “për biocide”, rregullon kushtet e qitjes në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e lëndëve me përmbajtje biocide me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe të shtazëve, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Në Ligjin për produktet biocide përfshihen edhe produktet biocide të cilësuar të rrezikshme toksike, kancerogjene e tjerë, të cilat nuk duhet të dalin në treg. Në Kosovë fusha e produkteve biocide nuk ka qenë deri tash e rregulluar as në ligje për mbrojtjen e mjedisit dhe as në ligjet për shëndetësinë dhe për mbrojtjen e bimëve.

Ligji për produktet biocide është komplementar me Ligjin për kemikate. Këto dy ligje e plotësojnë njëri-tjetrin. Me Ligjin për produktet biocide, pos Ministrisë për Mbrojtjen e Mjedisit, janë të ndikuara edhe Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Projektligjit i janë bashkëngjitur edhe një mori shtojcash, të cilat e plotësojnë Ligjin si dhe vërejtjet e Agjencisë për Integritet Evropian, të cilat kryesisht janë bërë rreth harmonizimit të termave në gjuhët shqip-anglisht.

Grupi Kuvendor i Partisë Demokratike e miraton, në parim, këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, për fjalë është paraqitur deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues! Faleminderit ministër për paraqitjen e ligjit. Ne e mbështesim si Grup Parlamentar dhe kontributin tonë e japim në komisione funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Hestet Cakolli e ka fjalën!

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për produktet biocide ka për qëllim kryesor të caktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive për prodhimin e produkteve biocide dhe njëkohësisht të mbrojë shëndetin e njerëzve, të shtazëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ky projektligj është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian Numër 98/8EC dhe ky konstatim mund të vërtetohet edhe me listat e dhëna në shtojcat 1, 1a dhe 1b, ku në këto lista janë definuar kushtet për të cilat regjistrohen substancat aktive për... të produkteve biocide.

Projektligji për produkte biocide është i hartuar në 62 nene, ku në disa nene të caktuara, ne si Grup Parlamentar i Aleancës Kosova e Re kemi disa vërejtje konkrete, për shembull, në nenin 4 pika 1, 2 dhe neni 8 pika 10 dhe disa vërejtje të përgjithshme, por ne si Grup Parlamentar do të angazhohemi që të japim kontributin tonë nëpërmjet përfaqësuesve tanë në komisionet ku do të shqyrtohet ky projektligj. Prandaj, ne pajtohemi që të procedohet më tutje Projektligji për produktet biocide. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar, Lulzim Zeneli e ka fjalën!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet, në parim, miratimin e këtij projektligji që konsiderojmë se është një prej ligjeve që plotëson pakon e ligjeve në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të popullatës. Është ligj që u tha nga ana e ministrit dhe parafolësit, që është harmonizuar dhe standardizuar me standardet e Bashkimit Evropian, mirëpo qasja jonë si Kuvend i Kosovës dhe ndoshta edhe qasja e ministrit pas miratimit të këtyre ligjeve që kanë të bëjnë me shëndetin dhe drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit, këto ligje do të duhej ta adresonin dhe plotësonin vizionin e Qeverisë që të ndërtojë mekanizma dhe të merret më seriozisht me kontekstin e mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit sot nuk është vetëm domosdoshmëri për Kosovën dhe shëndetin e popullatës, por është edhe standard për proceset e integritetit, prandaj le të shkojë kjo si porosi për ministrin dhe Ministrinë përkatëse se çështja e mjedisit duhet të renditet në një agjendë shumë më prioritare në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni që të filloj me qëllim që të kuptohet sa më lehtë se çka rregullon ky projektligj dhe se çka do të thotë vetë fjala biocid. Do të thotë, rrjedh nga fjala greke e latine dhe ka kuptimin e substancave që shkatërrojnë organizmat. Pra, sot në botë ndodhet një numër i madh i substancave, të cilat janë të dobishme nga se mund të shfrytëzohen për shkatërrimin e organizmave të dëmshëm si të insekteve, të fungjeve, të baktereve e të këpurdhave dhe kështu ndihmojnë në përmirësimin e higjienës së përgjithshme dhe ambientin më të shëndoshë e, natyrisht, edhe të popullatës më të shëndoshë.

Megjithatë, këto mund të kenë edhe efektet anësore të dëmshme dhe unë do t'i ndajë sidomos dy: ato të ndikimit në shëndet dhe të ndikimit në ambient. Sa i përket shëndetit, së paku janë dy lloje kryesore të rrezikut për shëndetin – intoksikacioni akut ose helmet aksidentale dhe sëmundjet që shkencëtarët kohëve të fundit i lidhin sidomos me paraqitjen e kancereve dhe në këtë aspekt pjesa më e ndjeshme ose vulnerabile janë sidomos fëmijët.

Pra, thënë shkurt, biocidet janë të definuara si substanca aktive dhe preparate që përbëjnë një ose më shumë substanca aktive, që janë të prezantuara në formën që përdoruesi furnizohet me qëllim të shkatërrimit, të ndalimit ose të kontrollit të organizmave të dëmshëm në aspektin kimik dhe biologjik.

Sa i përket qëllimit që synon ky projektligj, është që të sigurojë nivelin e lartë të mbrojtjes shëndetësore, por edhe të shtazëve dhe të ambientit. Pra, duke caktuar, bërë kushtet dhe rregullativat për mënyrën se si do të trajtohen këto produkte, si do të tregtohen në nivelin që është i pranueshëm për rrezikun si dhe inkurajimin e tregtimit me rrezikun më të vogël të mundshëm për shëndetin e njeriut dhe ambientin.

Sa i përket fushëveprimit, prodhimet biocide që do të plasohen në treg dhe kushtet e përcaktuara janë rregulluar gjerësisht për biocidet me veprimet që i përmenda më herët. Prodhimet biocide që aplikojnë janë diku 23 lloje të produkteve dhe janë të përjashtuara disa nga produktet biologjike. Këto mund të gjendet të gjitha në shtojcat që i janë bashkëngjitur Projektligjit e të cilat, në të vërtetë, janë të bazuara në vetë direktivën e BE-së 98-8EC. Por, sa i përket harmonizimit me direktivën, është harmonizimi sa u përket parimeve, por nuk mund të bëhet plasimi ose qarkullimi i produkteve edhe me vendet e BE-së në qoftë se i referohet një neni të direktivës, pasi që për zbatimin e tij duhet të inkorporohet plotësisht direktiva dhe jo të citohet një pjesë e direktivës.

Mënyra se si është rregulluar është se për bazën e këtyre vendimeve lidhur me autorizimet që përfshijnë tri fusha qendrore janë paraparë procedurat për substancat aktive, procedurat për prodhimet dhe rregullat e përkohshme. Kurse, sa i përket bazës së vendimeve, është autoriteti që bën vlerësimin e rrezikut për njerëzit, shtazët dhe ambientin që mund të vijë si rezultat i përdorimit të këtyre produkteve.

Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit, është me rëndësi të theksohet se është një ligj kompleks, në disa vende shumë i paqartë, por që kërkon koordinimin dhe punën e së paku tri ministrive: të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë. Janë paraparë edhe mbikëqyrjet inspektive nga të tri këto ministri, tri inspektorate: mjedisor, sanitar dhe fito-sanitar. Gjithashtu, janë paraparë gjordat që janë prej 50.000 deri në 100.000 euro. Megjithatë, në fund, unë do t'i theksoj mangësitë e këtij projektligji.

Sa i përket vlerësimit buxhetor, nuk janë paraparë sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve për vlerësimet buxhetore 2009-2011 dhe, po ashtu, edhe pse fitohet përshtypja se kostoja është e ulët dhe mund të absorbohet brenda buxhetit të Ministrisë, megjithatë mbetet e paqartë se si do të bëhet zbatimi i dispozitave që dalin nga udhëzimi administrativ. Po ashtu, është paraparë një numër i madh i udhëzimeve administrative, por jo edhe afatizimi i këtyre udhëzimeve administrative që lidhet direkt me zbatimin e ligjit.

Dhe, në fund, sa i përket këtij projektligji, kërkoj një sqarim prej ministrit. Aty, në pjesën e memorandumit shpjegues, thotë se Ligji bazohet, pra neni 10 pika c) se “Ligji bazohet në Kushtetutën e Kosovës dhe në Kornizën kushtetuese”. Cilës kornizë kushtetuese i referoheni, zoti ministër? Unë mendoj se ajo duhet të fshihet. Padyshim, si duket, i referohet Kornizës kushtetuese të tejkaluar tani.

Prandaj, po të merren parasysh këto vërejtje tona, ne në parim do ta mbështesim. Pra, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet me vërejtjet e propozuara. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputetja Shpresa Murati!

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući! S obzirom da su biocidni proizvodi hemijske aktivne supstance koje prvenstveno direktno ili indirektno utiču na zdravlje ljudi, na životinje i životnu sredinu u opšte, znači zemljište, vode i vazduha, donošenje ovog zakona je zaista jako značajno. Iako nisu navedeni članovi Radne grupe koji su učestvovali u izradi ovog nacarta zakona, verujem da su bili uključeni i eksperti iz Ministarstva poljoprivrede i Ministarstva zdravstva s obzirom da će ova ministarstva u okviru svojih oblasti delovanja i odgovornosti imati ključnu ulogu prilikom primene ovog zakona preko Agencije veterine i prehrane, to jest preko fito-sanitarnih inspektora kao i sanitarnih inspektora.

Znači, radi se o jednom nacrtu zakona koji je zaista seobuhvatan, koji detaljno reguliše pitanje iz oblasti, koji će zajedno sa Zakonom o hemikalijama upotpuniti ovu oblast. Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj predlog zakona i daće svoj doprinos kako bi dobili jedan dobar zakonski dokument sprovodljiv u praksi. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanoviç e ka fjalën!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući! I Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će podržati ulazak u proceduru jednog ovakvog zakona. Sve eventualne sugestije u cilju unapredjenja i poboljšanja kvaliteta ovog zakona daćemo preko svojih predstavnika u funkcionalnim komisijama.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga grupi i ri parlamentar, që është themeluar, nuk ka të paraqitur. Ftoj deputetin Riza Smaka të marrë fjalën!

RIZA SMAKA: Faleminderit zoti kryesues!

Procedura e amendimit të akteve ligjore është relativisht e ngatërruar dhe e implikuar me disa vështirësi, prandaj do të shfrytëzoj rastin që parimisht disa vërejtje të cilat shpresoj se në procedurën e ardhshme do të trajtohen dhe do të merren, si të them, për bazë për riformulim të disa pikave që janë nebuloze. Po e zëmë, ndër të tjera, në nenin 60 të Projektligjit thuhet atje se afati për miratimin e akteve nënligjore 36 muaj, do të thotë, po i bie 3 vjet. Kjo nuk ka kurrfarë kuptimi. Po të ishte vetëm 6 muaj, do të ishte tepër, se jo 36 muaj. Prandaj, ta kemi, si të them, si inspiracion për debatim në procedurat e ardhshme.

Ose, bie fjala, në këtë dokument përdoren shkurticat. Nuk lejohet në praktikat legjislative që këto akronime të përdoren, por gjithmonë titulli me emërtimin e plotë. 59-shi, thotë: “dënohet me gjobë”. Më të parën herë, gjoba nuk është fjalë shqipe dhe kur thuhet dënohet, dënohet me të holla, po e zëmë, e jo të “dënohet me gjobë”, sepse po bëhet një pleonazëm e panevojshme.

Dhe, përfundimisht, neni 61, thotë kështu: “çdo udhëzim administrativ apo akt nënligjor tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet”. Do të thotë, shfuqizohet. Ajo është një normë krejtësisht e panevojshme, sepse akti ligjor është më i lartë dhe aktet nënligjore gjithmonë duhet të jenë në harmoni. E kjo është një dispozitë tipike që e tregova veç për demonstrim, se ka edhe dispozita të tjera. Kaq sa i përket vërejtjeve parimore. Ndryshe, ky dokument është i nevojshëm për ne dhe e mbështes miratimin e tij në procedurën e rregullt. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Pasi që nuk ka tjerë të lajmëruar për fjalë, kërkohet dhe kërkohet deklarimin me votim për miratimin, në parim, të këtij Projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet në parim Projektligji për biocide.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

Në sallë janë të pranishëm 80 deputetë.

Kalojmë në pikën e katërt të radhës për sot:

- Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë

Konstatimet hyrëse: Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 6 nëntor 2008 dhe është proceduar për shpallje te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 84 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti e ka kthyer në rishqyrtim Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka rishqyrtuar Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Raporti, me rekomandime, iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj që në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Poštovane kolege poslanici,

U uvodnim napomenama rekli ste da je predsednik Republike vratio ovaj zakon Parlamentu i Predsedništvo je obavezalo Komisiju za zdravstvo, rad i socijalno staranje da ponovno razmotri ovaj zakon. Komisija je to uradila i predlaže jedan amandman, a to je da se briše tačka 1.2 člana 16. ovog zakona koji je zbog toga i vraćen.

Inače, član 16. tačka 1.2 predviđa mogućnost prekida trudnoće zbog kriminoloških razloga u 22-goj nedelji trudnoće i indukovani porodjaj i kasnije preporukom lekara i nakon potvrđivanja od strane nadležnih institucija koje su ovlašćene da utvrde da li je trudnoća posledica nekih od krivičnih dela: 1.1. silovanja, 1.2. polnih odnosa i trudnoće bez saglasnosti i to je bio razlog da se vrati znači ovaj zakon, od neželjenih polnih odnosa žena koje su žrtve trgovine ljudima i prinudnog polnog iskorišćavanja i polnog odnosa sa maloletnicima ili incesta.

Seksualni odnosi i trudnoća bez saglasnosti predviđenih u članu 16. tačka 1.2. nisu kvalifikovani kao krivična dela u privremenom Krivičnom zakoniku Republike Kosova i ne mogu se obuhvatiti kao kriminološki razlozi za prekid trudnoće u članu 16. Zakona o prekidu trudnoće.

Komisija je prihvatila sugestije kancelarije predsednika Republike i predlaže znači jedan amandman kako bi se Zakon usaglasio sa Krivičnim zakonikom Republike Kosova, da ne bi došlo do inicijative za promenu krivičnog zakonika. Znači, komisija jednoglasno predlaže Parlamentu da prihvati ovaj član kako bi zakon bio potpisan od strane predsednika Republike Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Të nderuar deputetë, pasi që është herë e parë që e kemi një rast të tillë, kur një ligj kthehet në rishqyrtim, në bazë të Kushtetutës dhe të kompetencave që i ka Presidenti, ju lus që të dëgjoni këshillën juridike lidhur me vendimmarrje. Pra, unë do ta lexoj.

Në bazë të nenit 80, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, minimumi i nevojshëm është 61 vota “për”, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

Pra, për t’u konsideruar i shpallur ky ligj dhe për të kaluar, duhen 61 vota të jenë “për” amendamentin e propozuar nga Komisioni.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar nga komisioni funksional, të paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Pra, është një amendament dhe atë e votojmë tash:

Ju faleminderit! Konstatoj se me 72 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1 të propozuar nga komisioni funksional. Pra, Kuvendi miratoi ndryshimet e propozuara mbi Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë dhe ligji konsiderohet i shpallur. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës, pika e pestë e rendit të ditës për sot:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Konstatimet hyrëse: Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me nenin 3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe propozimin e Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Rekomandimi i komisionit, bashkë me biografitë e kandidatëve, iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e komisionit raportues, zotin Bahri Hyseni, që në emër të Komisionit, para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë dhe duke u bazuar në një shkresë të Institutit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në

Ligjin për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe duke marrë parasysh që për një kohë të gjatë ka qenë një zbrazësi në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, ku ka munguar një prokuror publik, që ka qenë anëtar i këtij Këshilli nga komuniteti serb, për shkak të mungesës së një anëtari që ka qenë këshilltar i ish-kryeministrit të kaluar në Qeverinë e Kosovës, me qëllim të plotësimit të anëtarëve dhe të Këshillit Drejtues që të jetë funksional, sepse për një kohë të gjatë nuk ka vepruar, ka marrë rekomandimet e Institutit të Këshillit Gjyqësor dhe ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës dhe nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës që të çojnë nga një propozim në bazë të kriterëve që duhet t'i përcaktojnë në bazë të Ligjit ekzistues për Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Në mbledhjen e 17 shtatorit 2008, ne kemi shqyrtuar rekomandimin nga Qeveria e Kosovës dhe rekomandimin nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës dhe si komision kemi konstatuar që kandidatët e propozuar i plotësojnë, e kanë përgatitjen profesionale dhe i plotësojnë kriteret që të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që t'i ketë parasysh këto rekomandime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Nuk ka të lajmëruar për fjalë. Më falni, për fjalë është lajmëruar deputeti Nait Hasani. Urdhëroni!

NAIT HASANI: Unë desha të përshëndes, por mua më intereson a ka ndonjë kriter kur zgjidhen njerëzit që merren me punë dhe ne i votojmë këtu. Këtu ne kemi, pikërisht për këtë Nazmi Mustafën që e votojmë, tash kërkohet të votohet, thuhet se prej të 95-tës deri në 2000-shen ka punuar punëtor nën administratën e Beogradit, në Prizren. A ka ndonjë kriter apo kemi ne ndonjë kriter apo vetëm veç t'i votojmë, t'i zgjedhim, ta mbushim një deponi edhe të ecim në kontinuitet. Për mua është e papranueshme të votohet njeriu i tillë i cili drejtpërsëdrejti deri në vitin 2000 punon në administratën e Beogradit në Prizren, prokuror, bën hetime dhe tani ne e votojmë dhe veç ia ndërrojmë gjendjen.

Unë kërkoj të paktën t'i kthehet, sepse pikërisht Këshilli Gjyqësor, i prokurorëve, është i përbërë me njerëz të tillë, jo vetëm këtu, si Këshill, por edhe nëpër të gjitha prokuroritë i kemi njerëzit e tillë, njerëz që kanë punuar prej '74 i kemi nëpër prokurori. Njerëz të cilët i kanë bërë të gjitha dënimet, të gjitha krimet e tash prapë kërkonin ne t'i votojmë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nëse ka...Ftoj kryetarin e komisionit parlamentar funksional, zotin Bahri Hyseni ta marrë fjalën. Bahri Hyseni e ka fjalën!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Pa dashje të hyj në debat, ne ju kemi përmbajtur nenit 3 të Ligjit ekzistues dhe unë do ta citoj: Neni 3, pika 3 kërkon përbërjen e anëtarëve që duhet t'i ketë Instituti Gjyqësor i Kosovës, në këtë rast Këshilli Drejtues. Thotë, përbëhen: 1 anëtar nga Qeveria e Kosovës, 2 anëtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës, 1 anëtar nga Prokuroria Publike e Kosovës, 1 anëtar nga Fakulteti Juridik të Universitetit të Prishtinës, 1 anëtar nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, 1 anëtar nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, 1 anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, 1 anëtar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.

Në këtë rast, Komisioni për Legjislacion ka pasur mandat vetëm të shikojë se propozimet a janë bërë prej institucionit të cilin e kërkon ligji dhe a i plotësojnë kriteret përgjithshme profesionale që të procedohen në Kuvend, pa u lëshuar në biografinë e kandidatëve. Ndoshta, deputeti plotësisht ka të drejtë, mirëpo në këtë rast, si komision, ne nuk kemi pasur të drejtë të lëshohemi në biografinë e kandidatëve, e aq më pak edhe në të kaluarën e kandidatëve. Për këtë arsye, ne i kemi rekomanduar Kuvendit të Kosovës që këta kandidatë sot, nëse dëshiron, mund t'i votoj, nëse jo, natyrisht që fjalën e fundit e ka Kuvendit i Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Lus deputetët që të paraqiten për fjalë. Besa Gaxherri e ka fjalën!

BESA GAXHRRI: Ju faleminderit, zotëri kryesues! Shumë shkurt, nuk dua të bëjë debat, por vërtet nuk mundem të pajtohem me kryetarin e Komisionit për Legjislacion. Është e vërtetë që këta e kanë zbatuar ligjin, do me thënë, prej cilit institucion duhet të vijë anëtar i këtij këshilli, por realisht ne jemi deputetë dhe kemi përgjegjësi, në radhë të parë politike, që vërtet njerëzit të cilët janë marrë, siç e sqaroi kolegu im, Naiti, edhe në të kaluarën, me dënime, e dimë çfarë, e që fatkeqësisht sot e kemi edhe një rezolutë këtu qesharake për këtë gjendje, për këtë çështje, unë mendoj se duhet të mendojmë mirë dhe i ftoj kolegët që këta njerëz nuk duhet të votohen pa i verifikuar mirë kush janë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka, deputeti Driton Tali! Le të përgatitet deputeti Ismet Beqiri.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Unë, atë që desha ta them, e tha zonja Gaxherri. Me të vërtetë duhet të jemi shumë syçelë dhe mendjehapur me këta individë, aq më shumë me këtë propozimin e dytë, duke pasur parasysh biografinë e këtij zotëriut, përfillet që ka marrë pjesë edhe në ekipin e Millosheviqit në Rambuje.

Është përgjegjësi e jona që mos t'i votojmë këta njerëz. Jemi përfaqësues të ligjit dhe kjo, mendoj, së pari propozimi i tij ka qenë antiligjor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

ISMET BEQIRI: Përshëndetje, zoti kryesues! Unë nuk e kontestoj atë që e tha zoti Nait. Unë kam propozim që të votohen individualisht. Nuk mund ta hedhim propozimin në grup për shkak të biografisë kontestuese eventuale të njërës, e të bie edhe kandidati tjetër, nëse për atë nuk kemi asgjë që e konteston. Prandaj, nëse votohet, propozimi im është të votohet ndaras për të parin dhe ndaras për të dytin dhe pastaj deputetët janë ata që vendosin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Një sqarim e ka kërkuar kryetari i komisionit, por paraprakisht, para tij fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, po ajo që pata për ta thënë, u tha, kështu që nuk dua ta përsëris.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryetari i komisionit parlamentar, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Unë mendoj që për Bedri Bahtirin nuk ka asnjë dilemë, sepse është punëtor i Ministrisë së Drejtësisë dhe është i dalluar sa i përket aspektit për legjislacion. Sa i përket propozimit të dytë, duhet ta kemi parasysh se përbërja e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kërkon që dy veta apo dy anëtarë t'i ketë nga minoritetet. Unë e thashë arsyen pse është propozuar kandidati. Që 7 muaj, Këshilli apo Instituti Gjyqësor i Kosovës nuk funksionon për shkak se zoti Sllobodan Stevanović, që ka qenë anëtar i këtij Komisioni, nuk merr pjesë në mbledhje. Shoqata e Prokurorëve, në pamundësi që ta gjejë dikë tash nga radhët e komunitetit serb, është detyruar që të fus dikë nga minoritetet, në këtë rast po më duket se është turk, dhe ka propozuar me qëllim që Institutin Gjyqësor të Kosovës ta bëjë funksional për shkak të pamundësisë për t'u mbledhur për shkak të mungesës të këtyre dy anëtarëve. Prandaj, kjo ka qenë ndoshta arsyeja e Shoqatës së Prokurorëve, mirëpo megjithatë le të mbetet që Kuvendi t'i votojë një nga një dhe le të vendosë në fund Kuvendi. Ku faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!

Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

SADIK IDRIZ: Poštovani predsjedavajući, ja lično ne poznajem ovog kandidata, ali smatram da bi trebalo da se glasa u paketu i da kandidat prodje iz ovih razloga: prvo, kandidat kojeg je predložilo Društvo tužilaca Kosova, on je tužilac u ovom trenutku, ako je mogao biti izabran za tužioca, može biti izabran i za člana Borda ovog Instituta iz redova ostalih zajednica.

Od ostalih zajednica veoma je mali broj sudija koji je do 99-ge godine mogao da bude izvan institucija i to je jasno. Ako želimo znači da ispoštujemo ove kriterijume, da imamo ljude u ovim institucijama i ako ovi ljudi, znači ako ovaj čovek, zaista ja njega lično ne znam, samo znam da je do treće godine fakulteta studirao na albanskom i onda je negde 90 godine prešao na srpski jezik, znači to ono što znam iz informacija sa strane, ali ako je čovek, znači ako u ovom trenutku obavlja funkciju tužioca, ako nije dobar, mislim da li je bošnjak ili kako se izjašnjava, to ne znam, ali ako u ovom trenutku obavlja funkciju tužioca i ako za to nema problema, zaista mislim da bi ovo bilo samo dodatno. Drugo je pitanje u biografiji, ako ima nekih podataka da je u svom radu, u tom periodu imao nekih negativnih aktivnosti. Ovo što sam čuo za Rambuje, ja mislim da nije, jer mi znamo ljude koji su bili tamo, ali mi iz zajednice iz koje, znači najbliži ovaj čovek ako pripada kompletno našoj zajednici, predlažemo da bude usvojen i da prodje kao član ovoga Borda Instituta. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, përgatitet deputeti Riza Smaka.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Seriozisht është skandaloze që në pozita të tilla të rëndësishme të institucioneve të zgjidhen njerëz me të kaluar të dyshimtë. Prandaj, është shumë i domosdoshëm, sepse kjo nuk është hera e parë në të cilën propozohen njerëz me të kaluar të dyshimtë dhe këtu shihet se sa i nevojshëm është Ligji për pastërtinë e figurës në Kosovë. Prandaj,

propozoj që Qeveria e Kosovës, në radhë të parë Kuvendi i Kosovës, në afat sa më të shpejt kohor të nxjerrë Ligjin për pastërtinë e figurës, në mënyrë që njerëz të tillë të cilët në të kaluarën kanë vepruar kundër interesave të qytetarëve të Kosovës, kundër Kosovës, të mos e kenë mundësinë të zgjidhen në pozita të tilla, për më tepër që personi në fjalë është edhe prokuror në Prokurorinë Speciale të Kosovës, që lë për të nënkuptuar se në pozita të tilla shumë të rëndësishme janë infiltruar njerëz me ta kaluar të dyshimtë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Riza Smaka e ka fjalën, përgatitet deputeti Bojan Stojanović

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni vetëm një konkludim që ka rëndësi për këtë çështje dhe për çështje të tjera të ngjashme kështu.

Kur ka qenë zoti Kushner këtu, ka qenë Këshilli Gjyqësor i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe unë e kam pas drejtuar atë këshill, kur i kemi pas propozuar kandidatët për gjykatës edhe për prokurorë të Gjyqësorit të Kosovës. E kemi pasur një qëndrim shumë të pastër dhe korrekt edhe të pranueshëm nga të gjithë. Ka pasur edhe përfaqësues të minoriteteve, që ata/ato të cilët/të cilat kanë punuar në regjimin e pro regjimit hegjemonist, nuk mund të promovohen në funksione të gjyqësorit. Prandaj, nuk dua që të bëj, si të them, propagandim që mos të votojmë, por unë personalisht asnjëherë nuk do të kisha votuar për këtë zotëri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Bojan Stojanović dhe, i fundit, le të përgatitet deputeti Enis Kervan

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine presedavajući!

Ja nisam mislio da se javim za reč, ali pošto smo počeli raspravu o tome o kvalifikacijama i prošlosti, biografiji ljudi koji su imenovani, da kažem da mi nismo ni mogli dobro da pročitamo to zato što prevoda nije bilo. Nama dolazi prevod samo ono što dolazi od strane Vlade ili od strane Skupštine. Medjutim, vidim da ovde ima nekih udruženja i samih biografija ili CV, ovih ljudi koji su kandidati, nema na srpskom jeziku tako da mi ne znamo o čemu se tačno radi.

Ono što jeste činjenica, ja sam se javio za reč da ovo mi sve liči na jednu priču da želimo da ostanemo u večitoj sadašnjosti, a to ćemo uraditi na način upravo kao što smo krenuli da se stalno osvrnemo na prošlost. Ja se slažem i nisam kompetentan da ocenim o tome, o kvalitetima i pogotovo o tome dali je neko napravio neku, kako da kažem, možda čak i prljavštinu u svojoj prošlosti. Da li je kriv, dali je radio protiv nekoga, za to postoje institucije i postoje organi, jer se isto kaže, ko je bezgrešan, neka prvi baci kamen. Niko se od nas nije rodio juče. Ajde da pogledamo u kom sistemu smo završavali škole, obrazovanje, sticali edukaciju, dali su baš svi počeli da rade samo u institucijama od 99 ili se to dešavalo i ranije. Mi ćemo u načelo podržati ove preporuke, podržaćemo Vladu jer smo sastavni deo. Toliko od mene. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nuk pata ndërmend ta marr fjalën, por dëshiroj t'ju sqaroj dhe një sqarim të saktë dhe të sigurt se kandidati në fjalë nuk është nga radhët e komunitetit turk, këtë edhe kolegu Bahri nuk e ka shikuar, ndoshta, mirë. Edhe në letër shumë mirë, në pjesën e gjuhës së kandidatit, shkruan se gjuha shqipe dhe serbo- boshnjake është e rrjedhshme dhe anglishtja. Ne e dimë se në Prizren gati të gjithë flasin turqisht, por ky zotëriu as turqishten nuk e flet bile, le që nuk është i komunitetit turk.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar edhe një deputet. Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Unë e mora fjalë për arsye se në biografinë e tij, zoti Nazmi Mustafi paraqet punën që e ka kryer në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ka qenë në Inspektorat dhe në Drejtorinë e Punësimit. Nuk kanë pasur vërejtje kolegët e tij për punën e tij në Ministri, unë e kam gjetur si Departament, si të gjitha departamentet tjera kur janë krijuar ministritë dhe vetëm e pata për sqarim, sepse përmend vizitën time në Bosnje kur kam qenë me delegacionin e Kosovës si ministër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, më lejoni që t'ua lexoj një këshillë juridike lidhur me vendimmarrjen në këtë rast. Me ligj nuk është definuar forma e shumicës së votave dhe as mënyra e votimit. Lus deputetët që të deklarojnë- Kuvendi a ta mbështesë propozimin e deputetit, Ismet Beqiri, që votimi të bëhet individual, pra e hedh në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Hedh në votim propozimin e deputetit Ismet Beqiri, që Kuvendi në këtë rast të votojë individualisht. Votojmë tash.

Ju faleminderit!

Me 59 vota „për“, 5 „kundër“ dhe 6 abstenime, Kuvendi vendosi që mënyra e votimit të jetë individuale në këtë rast, prandaj lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Në sallë janë 80 deputetë.

Vë në votim kandidatin Bedri Bahtirin. Lus regjinë dhe deputetët të deklarojnë. Votojmë, tash:

Me 55 vota „për“, 17 „kundër“ dhe 8 abstenime, Kuvendi e votoi dhe e emëroi Bedri Bahtirin, anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Vë në votim dhe lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim kandidatin Nazmi Mustafi.

Votojmë, Tash:

Ju faleminderit!

Me 62 vota „kundër“, 13 vota „për“ dhe dy abstenime, Kuvendi nuk e emëron zotin Nazmi Mustafi për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Me këtë përfundon kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës dhe të fundit për sot:

6. Raport me rekomandim lidhur me Projektrezolutën kundër krimeve të komunizmit në Kosovë

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që para Kuvendit të prezantojë Projektrezolutën.

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në vlerat më të larta të rregullimit kushtetues të Republikës së Kosovës, pas autorizimit nga Kuvendi i Kosovës që të nxjerrë apo të përgatisë një rezolutë për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovës, në shumë mbledhje të organizuara nga Komisioni, në bashkëpunim me të gjithë anëtarët që janë prezentë nga grupet e ndryshme parlamentare, në bashkëpunim edhe me mekanizmat tjerë të cilët e kanë përcjellë punën e Kuvendit të Kosovës dhe natyrisht të Komisionit, duke marrë për bazë edhe vendet fqinje, duke i marrë për bazë rezolutat të cilat kanë nxjerrë për të dënuar regjimet e sistemeve totalitare komuniste, duke marrë për bazë edhe Rezolutën e Shqipërisë, Deklaratën e Kroacisë, të vendeve Baltike, Kuvendit të Kosovës i ka përgatitur këtë Rezolutë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke iu referuar Rezolutës 1481 dhe Rezolutës së mëparshme nr. 1096, të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 2006, përkatësisht më 1996, për dënimin e krimeve të regjimeve totalitare komuniste;

Duke marrë parasysh faktin tashmë të njohur dhe të verifikuar, se regjimet totalitare komuniste shoviniste në ish-Jugosllavi, në vijimësi, në mënyrë sistematike dhe të institucionalizuar kanë ushtruar format nga më të rënda të politikave kriminale, zaptuese, diktatoriale, represive dhe gjenocidale, në funksion të zbrazjes etnike, shkombëtarizimit dhe të ndryshimeve të dhunshme të përbërjes etnike të Kosovës dhe të viseve të tjera;

Duke qenë i motivuar fuqishëm, populli i Kosovës për një transicion të suksesshëm drejt një të ardhmeje të lirë, paqësore, demokratike, pluraliste, tolerante dhe evropiane, në frymën e Preambulës së Kushtetutës Evropiane dhe dokumenteve tjera universale për të drejtat e njeriut;

Duke pasur synim parësor transformimin e thellë e të gjithanshëm të shoqërisë së re kosovare dhe ndërtimin e një realiteti të ri të demilitarizuar, të demonopolizuar dhe të dekriminalizuar si alternativë të vërtetë dhe të qëndrueshme ndaj të kaluarës së hidhur, represive e gjenocidale dhe krijimin e parakushteve të nevojshme për shtet të së drejtës dhe sundim të ligjit;

Duke qenë i përkushtuar t'i respektojë, mbrojë, avancojë dhe t'i inkorporojë në vazhdimësi vlerat më të larta si pjesë e pandashme e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, që si qëllim të sajë parësor e kanë shkëputjen nga e kaluara totalitare komunisto-shoveniste 50- vjeçare dhe integrimin në familjen e madhe evropiane, përkatësisht në strukturat evropatlantike;

Duke u rreshtuar në krahun e gjithë atyre popujve që fuqimisht dhe në mënyrë institucionale i gjykuan dhe i dënuan krimet e kryera nga ana e regjimeve totalitare, komuniste-shoviniste në vendit e tyre;

Kuvendi i Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

Rezolutë për dënimin e krimeve të regjimeve totalitare- komuniste në Kosovë.

Kuvendi i Republikës i dënon krimet e ushtruara në mënyrë sistematike e të institucionalizuar nga ana e regjimeve totalitare komuniste-shoviniste ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke i përfshirë vrasjet në masë, shfarosjet, burgosjet, izolimet dhe torturat çnjerëzore, diskriminimin, segregacionin, dhunimet, shpronësimet arbitrare, plaçkitjet dhe rrënimin sistematik të bazës ekonomike e sociale dhe ekzistuese, dëbimin dhe depërtimin në masë, shkeljet e të drejtave dhe lirive individuale, kolektive, kombëtare, fetare, politike, kulturore si dhe forma të tjera të dhunës dhe të terrorit fizik e psikik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës i dënon edhe të gjitha krimet e regjimeve totalitare komuniste- shoviniste të kryera ndaj të gjithë popujve të ish-Jugosllavisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për vlerësim të drejtë e meritore të gjendjes dhe të dhe të statusit të viktimave të politikës kriminale e gjenocidale, rehabilitimin e tyre juridik, shoqëror, shëndetësor, si dhe për trajtimin adekuat dhe me bazë ligjore për pasojat, dëmtimet dhe vuajtjet e pësuar në përputhje me praktikën e vendeve të tjera me transicion të suksesshëm.

Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për hulumtim dhe hetim të gjithanshëm shkencor e ligjor, objektiv dhe të përgjegjshëm, vendor e ndërkombëtar të dimensioneve të peshës dhe të pasojave të politikave kriminale, represive, shkombëtarizuese dhe gjenocidale të regjimeve totalitare komuniste- shoviniste në ish-Jugosllavi ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe mbi këtë bazë, vënie para drejtësisë vendore e ndërkombëtare të urdhërdhënësve dhe autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve ende të pa dënuara;

Kuvendi i Republikës së Kosovës vlerëson se dënimi adekuat i përgjegjësve dhe i bartësve të krimeve, si dhe procesi i lustrimit dhe riverifikimit në drejtësinë tranzicionale është në funksion të drejtpërdrejtë të normalizimit të gjendjes dhe të vendosjes së shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, politikës së pajtimit, të parandalimit, si dhe të shfaqjeve të hakmarrjes e të revanshizmit në të ardhmen;

Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për një proces gradual, të përgjegjshëm dhe të planifikuar mirë të hapjes së dosjeve të krimeve dhe bartësve të tyre në përputhje me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë, me specifikat e transicionit kosovar dhe në pajtim me rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe me praktikën e vendeve me transicion të suksesshëm;

Kuvendi i Republikës së Kosovës i bashkëngjitet thirrjes së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dërguar të gjitha vendeve komuniste dhe paskomuniste, që nëse nuk e kanë bërë gjer më tani, ta vlerësojnë historinë e komunizmit dhe të kaluarën e vet, duke u distancuar qartë nga krimet e kryera nga regjimet totalitare komuniste- shoviniste dhe t'i gjykojnë ato pa kurrfarë dileme;

Kuvendi i Republikës së Kosovës në vazhdimësi dhe me përkushtim do të punojë për emalimin e të gjitha pasojave të shkatërruara nga regjimet totalitare komuniste-shoviniste dhe do të bashkëpunojë me të gjithë popujt dhe vendet në rajon dhe më gjerë për krijimin e stabilitetit, paqes, mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit;

Kuvendi i Republikës së Kosovës vlerëson se në këtë mënyrë ne do të kontribuojmë që të gjithë popujt të ndërtojnë një të ardhme të tyre dhe të punojnë bashkërisht për paqe dhe për prosperitet të gjithmbarshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E dëgjuat kryetarin e Komisionit për Gjyqësi dhe Legjislacion. Tekstin e keni marrë dhe mendoj që është radha e shefeve të grupeve parlamentare ta thonë fjalën e tyre. Faleminderit, profesor!

Fjalën e ka në emër të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja. E ke thënë paradite. Atëherë, e ka fjalën Lutfi Haziri, shefi i Grupit të LDK-së.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar,

Ne edhe në mëngjes, para fillimit të seancës në parim e kemi mbështetur punën e Komisionit. Në radhë të parë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dëshiroj t'i përkujtoj në shenjë respekti të gjitha viktimat, familjet dhe njerëzit që kanë vuajtur nga pasojat e regjimit që tashmë ka kaluar, është mundur, është fituar dhe sigurisht kjo është çështje e një debati më të madh se sa vetëm e një rezolute që do të miratohet.

Ka ende njerëz të humbur, ka ende njerëz të varrosur rrugëve që nuk kanë mund të trajtohen kurrë ashtu siç duhet, ka shumë pasoja dhe shumëçka që kemi përballuar edhe sot i vuajmë edhe i ndjejmë. Por, besoj thellë që involvimi i Qeverisë, nga rekomandimet që i nxjerr kjo rezolutë, është i domosdoshëm. Unë do të dëshiroja ta kem fjalën e Kryeministrit të Kosovës këtu, ose të përfaqësuesit të Qeverisë, sepse neni 3 në veçanti kërkon angazhime serioze vetëm të Parlamentit me nxjerrjen e legjislacionit për të rregulluar statusin dhe gjithçka që kërkon nga ajo rezolutë, por kërkon dhe ka implikime tjera. Andaj, mendoj që, përveç një debati më të madh që duhet ta bëjmë ne, brenda grupeve tona parlamentare, brenda partive tona, brenda shoqërisë tonë, para se të votohet kjo rezolutë duhet të përcillet edhe me akte të tjera. Qeveria domosdoshmërisht duhet ta ndihmojë Parlamentin, në mënyrë që miratimi i kësaj rezolute të shkojë jo vetëm si pasojë e kërkesës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për t' i dënuar formalisht regjimet. Populli ynë dyfish ka vuajtur edhe pasojat e regjimit, edhe pasojat etnike brenda atij regjimi. Andaj, duke pasur parasysh specifikat tona, kërkesat tona, mendoj që kjo rezolutë do kohë, do debat, do angazhim serioz, e në veçanti involvim më të madh të Qeverisë. Këtu, nëse lexohet me kujdes, dënohet krimi, nuk dënohet regjimi. Krimet i ka bërë sistemi komunist. Sistemi komunist nuk dënohet, por krimet që kanë ndodhur brenda sistemit komunist. Prandaj, duke mos u bërë modest, kërkoj falje prej

tjerëve, anëtarët e familjeve tona, gjyshërit tanë, baballarët tanë janë rrugëve ende, nuk kanë mund të trajtohen kurrë siç duhet edhe ka shumë njerëz që kanë mbetur ende pa u zbuluar- të humbur. Kërkon angazhim më serioz, është çështje e ndjeshme. Ne duhet të jemi serioz, mendoj që duhet të involvohet Qeveria më shumë, të involvohet debati i brendshëm në Kosovë, që duhet ta përcjellë dhe Parlamenti ta bëjë aktin e fundit me votim formal. Faleminderit!

KRYETARI: A mundesh më shkurt të na thuash, cila është kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike?

LUTFI HAZIRI: Kërkesa është që Qeveria duhet ta japë qëndrimin e vet. Teksti nuk është i qartë, nuk është i definuar deri në fund, është punuar sipas modeleve.

KRYETARI: Kjo është punuar në Parlamentit, jo në Qeveri, a?

LUTFI HAZIRI: Jo, s'po dua ta bart askund, dëshiroj ta miratojmë një rezolutë e cila është e qartë, e saktë dhe e cila obligon dikë për të bërë diçka. Nuk mund të miratojmë rezoluta e të mos implementojmë asgjë. Ne nuk mbështesim vetëm miratimin deklarativ të një rezolute, e cila nuk thotë kurrëgjë në vete, dënon deklarativisht pa u marrë me atë që kemi kaluar. Së paku unë nuk mund ta trajtoj një rën që më së shumti na ka lënë keq të gjithë neve edhe njerëz që duhet të kenë respektin tonë. Ne e mbështesim kur të qartësohet rezoluta deri në fund, të detajizohet dhe ndahen obligimet e Qeverisë, të Parlamentit edhe vazhdojmë të punojmë. Vazhdojmë të punojmë në implementimin e kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, për hir të vërtetës, unë dua ta them, unë të kuptova tash, por një sqarim mendoj, ndoshta, në fjalor, ne i dënojmë krimet e komunizmit, përndryshe mos të ishin krimet, ne s'kemi pasur pse e dënojmë një shoqëri po të mos kishte bërë krime. Ju jeni që të mos votohet sot rezoluta.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe paradite, kur kam propozuar që të futet në rend të ditës, kam pasur parasysh që Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht Komisioni për Legjislacion këtë rezolutë e ka punuar tash e tre muaj ditë dhe do të ishte shumë më e arsyeshme që ju, si Kryetar i Kuvendit, Kryesia e Kuvendit të japë një sqarim se pse kjo rezolutë është vonuar teri tash?

Kjo rezolutë është në mbështetje të plotë të Rezolutës të Këshillit të Evropës, e cila thërret vendet postkomuniste për dënimin e krimeve të regjimeve komuniste dhe jo për dënimin e regjimeve. Andaj, është në përputhje të plotë me këtë rezolutë, sikurse që në asnjë rast nuk konsiderojmë se ka implikime buxhetore edhe përkundër faktit se thërret për rehabilitim të të gjithë atyre të cilët kanë pësuar nga këto krime, por jemi shumë të vetëdijshëm që shoqëria kosovare, shteti i Kosovës e ka për borxh që të nxjerrë ligje në ardhmen, përmes të cilave do t'i dëmshpërblejë të gjithë ata të cilët kanë qenë viktimat e krimeve të komunizmit në periudha të ndryshme kohore. Me vetë vaktin që kemi qenë kërkuar që kjo të hyjë në rend të ditës, natyrisht se jemi pro kësaj rezolute.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kujtoj se së pari si Kuvend i Kosovës do të duhej të ishim shumë më serioz kur trajtojmë çështje të tilla, në mënyrë që çështje të tilla të mos devalvohen dhe të shndërrohen si pjesë të cilat do ta dëmtonin punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Si Grup Parlamentar ne e mbështesim që ballafaqimi me një periudhë kohore, duke i dënuar krimet e sistemit komunist, ne mendojmë se e mbyllim një kapitull i cili ka shkaktuar aq vuajtje dhe dhimbje, jo vetëm për popullatën e Kosovës, por edhe rajonin si tërësi. Ne, atë që po e bëjmë sot, e kanë bërë shumë vende tjera postkomuniste dhe Kosova me këtë hap vetëm e përcjell ciklin e shteteve të tjera të cilat sot i takojnë bllokut evropian, bllokut të Bashkimit Evropian. Prandaj, konsideroj që kjo rezolutë do të jetë shprehje e qëndrimit politik të Kuvendit të Kosovës, të cilin qëndrim do ta përcjellin edhe aktet tjera të mëvonshme që do të përcillen me miratimin e pakos së ligjeve për pastërtinë e figurave publike, për hapjen e dosjeve dhe ciklet të cilat Kosovën përfundimisht do ta radhisin në grupin e vendeve që dëshirojnë ta përmbyllin një kapitull dhe të shikojnë nga e ardhmja edhe perspektiva e saj.

Prandaj, si Grup Parlamentar konsiderojmë që Komisioni i Kuvendit të Kosovës ka bërë një punë që duhet të vlerësohet dhe ne jemi pro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se duhet të qartësohet pozicioni i Kosovës në lidhje me krimet që kanë ndodhur në të kaluarën dhe deputetët e Aleancës me siguri shumica do ta votojnë një rezolutë të këtillë. Sidoqoftë, unë po e shfrytëzoj rastin duke marrë leje prej grupit, që ta jap një mendim timin për këtë rezolutë. Dhe mendimi është që kjo rezolutë është e kotë, që kjo rezolutë është ndarëse, ndanë njerëzit, dhe që ne të gjithë e dimë këtu se krimet që kanë ndodhur kundër popullit të Kosovës, më së paku kanë pasur karakter ideologjik ose komunist, e kanë pasur karakter etnik. Kanë ndodhur edhe para komunizmit, kanë ndodhur edhe pas komunizmit dhe kjo që po bëjmë ne sot me këtë rezolutë, për mendimin tim, nuk do të ketë kurrfarë peshe pozitive në Kosovës, përpos se ka për t' i ndihmuar ndarjes në Kosovë. Këto po i them për ata që nuk e dinë, sikur shumë deputetë tjerë këtu, t' ju tregoj vetëm se i takoj një familje e cila ka qenë e shpronësuar, e vrarë, e përzënë, e persekutuar, e ndaluar për t'u shkolluar. Domethënë, unë nuk e kam aspak të paqartë se për çka po flasim, por po u them edhe njëherë deputetëve të Kuvendit të Kosovës se rezolutë më të kotë kurrë nuk ka bërë Kuvendi i Kosovës, rezolutë që nuk ka për të na ndihmuar fare. Faleminderit!

KRYETARI: Nejse, këtu i patëm dy qëndrime. Në emër të Grupit Parlamentar "7+" kush po e merr fjalën, Myfera apo? Nuk e kanë kërkuar fjalën. SLS-ja nuk e kanë kërkuar fjalën. Deri me tani janë lajmëruar 13 deputetë.

Fjalën e ka Ramë Buja.

RAMË BUJA: Konsideroj që kjo rezolutë nuk është aq joserioze sa të mos jetë gati askush nga Qeveria këtu. Unë propozoj që ta bëjmë një orë pauzë dhe të vijmë edhe Kryeministri dhe i gjithë Kabineti qeveritar dhe pastaj mund të flasim.

KRYETARI: Faleminderit! Ne mund ta bartin përgjegjësinë ku të dëshironi, nëse doni të gjyqësia.

E ka fjalën Sabri Hamiti. Anëtarët e Kryesisë kanë përparësi.

SABRI HAMITI: Duhet të kenë, edhe mësohuni që duhet të kenë!

Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Krasniqi,

Zotërinj dhe kolegë deputetë,

Unë shumë herë kam dëgjuar këtu që bëjnë zhurmë çka po na duhet Qeveria, po na e bë agjendën e po na e prish Kuvendin. Kësaj radhe jemi ne që e kemi bërë agjendën me këtë pikë dhe mos e lypni hiq Qeverinë pra, se s'ju duhet gjë. Qeveria s'e ka vu në rend të ditës sot, por janë deputetët që e votuan dhe çka po ju duhet pra Qeveri tash? Të jemi konkret dhe konsistent çka themi, të mos bëjmë propaganda të kota.

Dola të flas për këtë propozim rezolutë, të cilën, siç e dini, e ka propozuar partia më e madhe në Kuvend - Partia Demokratike e Kosovës, të cilën në emër të partisë – të LDK-së, e kam përkrahur atëherë. Është hartuar nga një komision që përbërjen nuk e di krejt kusht ka punuar, por s'është me rëndësi, ne sot e kemi përpara. Ky tekst, për informimin tuaj, deputetë të nderuar, dhe të atyre që kanë qejf të bëjnë replika me Kryesinë, ka qenë në Kryesi edhe unë e kam lexuar dhe ju them tash unë juve, edhe Ibrahimit, konkretisht, pse unë mendoj... Atëherë, unë jam unë, Sabri Hamiti, që në Kryesi kam thënë që ky tekst nuk e vlen për t'u votuar. Po ju them edhe sot këtu, shumica bëjnë të çka donë në Kuvend, po unë këtë tekst qysh është, nuk do ta votoj sot. Jo pse s'dua të votoj rezolutë kundër komunizmit, por duhet të shkruhet më mirë, më saktë. Kjo është krejt historia e këtij teksti dhe e Kryesisë. Pse ky komision s'ka dashur ta ripunojë tekstin, është problem i tij? Nëse doni, e hapim diskutimin dhe të pushojë të folurit e paargumentuar. Unë po ju them çka kam thënë, shqyr Zotit tash po shkruhen fjalët gjithkund në germa edhe në Kryesi, unë vetëm po e përsëris. Zonja dhe zotërinj, edhe këtë tekst që e keni para s'po e lexoni mirë. Sikur ta lexonit mirë çka shkruan shqip, ju vetë s'e votoni sot. Ju s'jeni duke e parë që në tekstin shqip, duke pohuar diçka, mohohet, po ju s' e shihni. E, nëse s'e lexoni, është dokument, bëni marrëzi të madhe. Pra, qoftë për idetë, qoftë për tekstin, ju s' guxoni ta votoni kështu, po duhet të merret, bile pushim dhe të redaktohet ky tekst. Unë ju thashë, e thotë në dy vende atë që mendon se s'duhet të thuhet, po Zoti na ruajt, ata që e kanë shkruar, shkruajnë kështu qysh shkruajnë.

Unë nuk po flas për koalicion, por po flas për një rezolutë, zotëri. Merre fjalën e repliko, e ke të drejtën, unë mezi po pres. Pra, teksti, qëndrimi, s'ka pse bisedojmë, sepse kemi vendosur në Kuvend që të bëhet. Komisioni është angazhuar, po kjo nuk do të thotë kurrë që një dokument që vjen prej Komisioni, nuk e mban të drejtën të ripunohet dhe thirrja ime sot këtu është që patjetër të ripunohet, jo pse lyp Qeveria, po pse lypim ne deputetët. Jam unë që po lyp individualisht. Tutje nuk do të flas për tekst, se unë mendoj që teksti publikisht nuk korrigjohet, një rezolutë ku janë 120 deputetë, po ulen 2 – 3 veta dhe e korrigjojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, është mirë që vërtet, ka të lajmëruar bukur shumë. Ne po e marrim një pauzë për drekë, e pas dreke e vazhdojmë. Urdhëro, Ibrahim Makolli, për replikë.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në radhë të parë konsideroj se fjalori i tillë është fyerje për deputetët e Kuvendit të Kosovës, është fyerje për Komisionin i cili është angazhuar të punojë këtë rezolutë, absolutisht. Unë konsideroj që nuk kemi nevojë për leksione të tilla, pavarësisht prej nga vijnë.

Së dyti, më duhet të them diçka të cilën nuk do të doja ta them. Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Hamiti, e dini shumë mirë pse e keni shtyrë që tre muaj ditë. Dhe, absolutisht nuk është e vërtetë që kjo rezolutë nuk është në pajtim me standardet që kërkohet, sepse ka qenë shumë lehtë të ulet dhe të harmonizohet dhe të rregullohet një tekst. Por, ju e dini shumë mirë dhe nuk është hera e parë që këtë Kuvend e vëni në lajthitje si anëtar i Kryesisë, sepse dikush tjetër ka kërkuar nga ju që të mos hyjë në rend të ditës. Dhe, duhet ta keni guximin ta thoni të vërtetën, zoti profesor dhe të gjithë të tjerët. Sa i përket asaj, jo të lutem, sa i përket asaj se a ka ditur ky Komision a nuk ka ditur të shkruaj, është çështje krejt tjetër. Kuvendi i Kosovës e ka autorizuar Komisionin për Legjislacion dhe Komisioni ka anëtarë të të gjitha subjekteve politike dhe prandaj është dashur që kjo të rregullohet, por jo në këtë formë që gjithherë t'i iket fajësisë dhe fajësia t'i hidhet te dikush tjetër. Absolutisht, unë jam i gatshëm shumë, zoti profesor, me ju dhe me të gjithë të tjerët të polemizoj për këto çështje, por nuk jam i gatshëm që ta bart përgjegjësinë e kujtdo qoftë, i cili nuk e ka guximin që t'i thotë gjërat ashtu si janë.

KRYETARI: Faleminderit! Kundër replikë, deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Po s'kam çka bëj, ky... Shiko, fjalori që thotë të vërtetën, është fjalori më i mirë në dynja. Fjala që lidhet me sendin, me kuptimin, është fjala më me peshë. Pse e thotë të vërtetën, e dhemb, ajo është problem tjetër. Unë edhe njëherë po të thërras, për të mos bërë zhurma të kota. Merre atë copë teksti, merre një pushim, nëse dini mirë shqip, lexojeni. Ju e gjeni vetë që keni në tekst probleme në shprehje, sepse teksti e thotë të kundërtën e asaj që e kërkoni, zotëri. Sa i përket asaj se kush i ka thënë Kryesisë, unë të garantoj që mua kurrëgjë s' më thotë në këtë dynja prej se jam në Kuvend tinëz askush. Nëse ke teori tinëzllaku, që ku janë deputetët, çohu e thuaj. Dhe, unë e mbarova këtë diskutim për këtë. Unë, po ju them, nuk dua me qëllim, meqë po thua, s'dua, po ia lë vetëdijes, dijes së juaj të Komisionit për ta këqyrë tekstin, a e thotë teksti atë që e mendon. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit!

Pauzë, deri në orën 15,00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë debatin.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Po, faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Me qenë se u tha shumë edhe u debatua, u replikua në pjesën para kësaj pauze, në tekstin e Projektrezolutës, kam disa vërejtje.

Në pjesën e parë këtu, nomenklaturë, që përmenden për formën e totalitarizmit edhe të dhunës së ushtruar, nuk figuron askund gjenocidi në mesin e të gjitha atyre, dhunës që është ushtruar nga regjimi kriminal komunist. Kështu që kisha pasur dëshirë që brenda tekstit të jetë edhe fjala gjenocid, sepse ajo ishte ajo kryesorja që ne e tejkaluam këtë periudhë postkomuniste. Edhe në pikën e dytë të tekstit të rezolutës nuk kemi nevojë të marrim obligime ne për gjithë ish- Jugosllavinë, sepse nuk është Kuvendi Federativ ky, po ne mund t'i dënojmë krimet e regjimit totalitar komunist-shovinist të kryera ndaj popullit të Kosovës nga ish- regjimi i Jugosllavisë, sepse thotë ndaj gjithë popujve të Jugosllavisë. Pra, nuk kemi nevojë t'i marrim ne ato obligime, është Kuvendi i Republikës sonë. Ka edhe shumëçka, por besoj se do ta trajtojnë edhe deputetët e tjerë gjatë debatit. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Do të flas shkurt sa për korrektësi dhe për hir të njoftimit edhe të deputetëve dhe të opinionit, unë po e lexoj vetëm shkurt përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të datës 18 nëntor 2008 përkitazi me Projektrezolutën, ku thuhet: “Të rishikohet teksti i Projektrezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë prej vitit 1945 deri në vitin 1999, nëse i njëjti mund të ketë implikime buxhetore”. Sipas kësaj, Kryesia e Kuvendit nuk ka pasur vërejtje në tekstin e Rezolutës, por ka pasur vërejtje në mundësinë që ky të ketë implikime buxhetore. E ndjeva këtë nevojë, sepse më herët kishte tendenca që kjo projektrezolutë të paraqitet si diçka e cila nuk i plotëson kushtet. Ne edhe në Komision kemi vlerësuar se Kuvendi dhe këta deputetë janë ata të cilët, natyrisht, do ta plotësojnë me vërejtje, në mënyrë që të jetë rezoluta më e kapshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti .

GANI GEÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kur diskutohet për komunizmin dhe krimet e komunizmit dhe rezolutat që dënojnë atë dhe veprat e komunistëve në Evropën Juglindore, doemos duhet t'i miratojmë edhe ligjet që i bashkëngjiten kësaj rezolute, siç është Ligji për pastërtinë e figurave dhe ligje të tjera. Ne duhet t'i ndajmë epokat, epokën staliniste nga epoka demokratike perëndimore.

Për mua personalisht dhe për shumë familje në Drenicë, ende është e pakuptimtë se kush është hero? A është hero Fadil Hoxha, që pushkatoi në Drenicë qindra burra, a janë heronj Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica? Prandaj, nuk mund të jenë të dytë heronj. Unë nuk di, sinqerisht po them, a janë heronj: Stalini, Enver Hoxha e Dushan Mugosha, a janë heronj Mitat Frashëri, Hysen Tërpeza e Xhafer Deva. Xhafer Deva dihet që ka ligjëruar në Universitetin Amerikan.

Të nderuar deputetë,

Unë do të ndalem pak në diskutimet e amendamenteve kushtetuese të bëra në vitin 1988 nga disa anëtarë të Kabinetit qeveritar, por edhe nga udhëheqësia më e lartë e shtetit të Kosovës.

Fjala është për ministrin e Shërbimeve Publike, zotin Arsim Bajrami, i cili në kumtesën e vet, të cilën unë e kam siguruar nga Instituti për Kërkime Juridike Shkencore, botuar në vitin 1988 për diskutimet, për amendamentet kushtetuese të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të Republikës së Serbisë, thotë: "Presionet publike po vijnë në shprehje nga ngjarjet kundër revolucionare të vitit 1981, nga pozita e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, me kërkesat e tyre që Krahina Socialiste Autonome e Kosovës të konstituohet si Republikë. Domethënia e këtyre deklaratave dhe kërkesave është e njohur për opinionin dhe dihet karakteri i tyre antikushtetues".

Të nderuar, më poshtë nuk kam qare pa i përmendur edhe deklaratat e Presidentit Sejdiu, në faqe 46, ku thotë: "Nga e kaluara jo e largët, të cilës ia kemi kthye shpinën për të sotmen dhe të nesërmen, për të mirën pikërisht duke iu falënderuar Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë si avangardë e klasës punëtore. Në emër të demokracisë dhe në emër për demokracinë dëshirohet që ne të zhvishemi nga vlerat e arritura me gjak, djersë që kemi arritur të përbashkët dhe t'i veshim rrobat e reja, të cilat në fakt ne i kemi provuar më herët."

Ndërsa, në faqen 66, thuhet: "Programi i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë ofron vizionin e qartë" në të cilin, pos tjerash, thuhet: "Duke udhëhequr nga parimi i njohur leninist - komunist do të kultivojmë në kuadër të Republikave Popullore, para së gjithash idenë e vëllazërim- bashkimit të popujt e Jugosllavisë me idenë e internacionalizmit socialist". Shtrohet pyetja? Kush është hero këtu? A janë heronj studentët që ishin në listat e zeza po në vitin 1988, a janë heronj këta që e përkrahën dhe diskutuan në këtë mënyrë në vitin 1988.

KRYETARI: Gani, rezolutën e kemi, nuk e kemi fjalën për dosje.

GANI GECI: Pikërisht për rezolutën është fjala dhe për diskutimet komuniste. Nuk po flas për të tjerët, sepse dihet se prej vitit 1945 e deri në përfundim të luftës në vitin 1999, luftës së fundit: Drenica, Anamorava, Ferizaj, Dukagjini, Mitrovica, të gjitha pjesët e Kosovës kanë hequr nga regjimi komunist dhe titist. Hiq më mirë nuk kemi kaluar as nga regjimi, as nga shokët, siç kanë qenë Enveri e Tito deri në vitin 1945.

Dhe, në luftën e fundit ia kemi parë sherrin titizmit dhe enverizmit, sepse mu në Drenicë filluan të vriten pas shpine në emër të luftës bijtë më të mirë të nationalistëve shqiptarë. Shtrohet pyetja: a ka është hero Smajl Hajdari, a janë heronj ata që e vranë Smajl Hajdarin, këtu nuk ka dy parë heronj, një parë duhet të jenë. Po e përfundoj citatin. Shërbimi Informativ Amerikan në vitin 1945 dhe Kongresi Amerikan kanë miratuar një rezolutë ku thuhet se komunizmi është më i rrezikshëm se kolera dhe malaria dhe kjo epidemi e rrezikshme duhet të luftohet me të gjitha mjetet. Nga ajo kohë, kundër komunizmit shteti amerikan ka ndarë mjete marramendëse për luftimin e kësaj epidemie

mjaft të rrezikshme për botën. Dhe, në vitin 1989 përmbysën këtë regjim në gjithë botën, duke përjashtuar këtu disa vende të vogla si në Kubë dhe Koren e Veriut.

Andaj, unë kërkoj pas miratimit të kësaj rezolute, shumë shpejtë të miratojmë Ligjin për pastërtinë e figurave shtetërore, sepse nuk mundën nga tri parë heronj të jenë në një vend edhe ata që i kanë vra, edhe ata që janë vrrarë. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Hajdaraj e ka fjalën!

ADEM HAJDARAJ: Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Unë dola këtu t'i them nja dy- tri fjalë përkitazi me këtë rezolutë. Flas si anëtar i Komisionit për Gjyqësi...

KRYETARI: Të kisha lutur, më fal deputet, realisht diskutimi lë të jetë në tekstin e rezolutës se kjo është pika e rendit të ditës. Prandaj, respektoni rendin e ditës. Nuk po ju them vetëm juve, po më vjen keq, por po e them për të tjerët.

ADEM HAJDARAJ: ... dhe si anëtar të Komisionit kemi punuar një kohë të gjatë në këtë rezolutë. Pasi që kemi menduar se është kthyer, ne deshëm që ta shohim edhe një herë, mirëpo me kërkesën e Grupit Parlamentar këtu, ajo hyri dhe u votua për te dhe unë mendoj që duhet të votohet dhe duhet të kalojë kjo rezolutë. Sa për atë se si kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së edhe kryetari i Grupit Parlamentar i LDK-së, që ishin shumë të zëshëm atëherë që të shkojë kjo rezolutë, tashti u tërhoqën në mënyrë të befasishme që unë çuditë si u tërhoqën kështu dhe na qitën në dilemë se çka të bëjmë? A ta kthejmë rezolutën përsëri pas, a të votojmë, a të mos votojmë. Kështu nuk duhet të veprohet. Ne nuk jemi marrë vesh si Komision Parlamentar, besoj as PDK-ja, as komisionet e tjera, as LDK-ja se çka do të bëjmë përkitazi me të?

Unë dua të them këtu se kjo është një deklaratë për këtë rezolutë. Nuk është e vërtetë që duhet ne ta kthejmë për shkak se duhet ta shohë Qeveria, duhet të implikohet Qeveria, siç u tha këtu më parë. Qeveria do t'i bëjë ligjet të cilat do ta përcjellin rezolutën dhe ne përsëri si deputetë duhet të bisedojmë për ato rezoluta dhe të marrim qëndrime, t'i heqim ato që janë të tepërta, ndërsa t'i shtojmë çka është e nevojshme.

Nuk është e vërtetë fare, se unë jam gjuhëtar, që rezoluta ka shumë gabime. Mund ta ketë ndonjë gabim drejtshkrimor, ortografik, përndryshe që një pasus e kundërshton pasusin tjetër, kjo është e paqëndrueshme. Le të thotë kush të dojë, madje edhe profesori.

Replikë, kur ta kryejë unë, zoti profesor. Domethënë, nuk po flasim këtu për gabime drejtshkrimore, se gabimet drejtshkrimore, ortografike po ka në të gjitha dokumentet që i ka pru ky Kuvend, madje edhe kur botohen në "Gazetën zyrtare" dalin gabimet drejtshkrimore. Nuk e di a kanë njerëz që i shikojnë ato, unë disa herë kam ngritur zërin edhe në Parlament edhe në Komision, përsëri nuk është marrë parasys.

Sa i përket asaj se unë e përkrah rezolutën, nuk është e vërtetë se dua të hakmerrem edhe pse jam bir i një të burgosuri politik në Goli Otok. 7 vjet i ka bërë baba im dhe ai më ka

thënë disa herë se nuk është e vërtetë se vetëm shqiptarët kanë qenë në Goli Otok. Kanë qenë edhe serbët, edhe malazezët, edhe kanë qenë edhe kroatët edhe të tjerët. Pse, pse na kanë munduar ne më së shumti, ajo është çështje tjetër pse kemi qenë shqiptarë, por është edhe çështja ideologjike këtu. Bile, kur thoshte për Vllada Dapçeviqin që nuk ka dashur Pekën ta pres, Peka Dapçeviqin aty ta pres, e kanë varur e nuk ka dashur të flas me te se ka qenë komunist. Dua të them se duhet kjo të tumiret, mos i vëni duart në sy se është e vërtetë se nuk jemi për hakmarrje, por nuk jemi as për ekstrem, siç doli një ditë, për shembull, në gazeta se duhet ky, ky, e ky, me emra që u përmendën edhe ata që kanë qenë të mirë, edhe merren si banditë, ku ta di unë si drogirasha e tjerë. Prandaj, të jemi real e të jemi të matur! Unë nuk flas sa për të më parë opinionin, sa për të fituar vota, por flas prej zemrës dhe flas nga shpirti se nuk po veprohet mirë nganjëherë, se po na qitni në lajthitje me mendime. Nëse është shef i grupit parlamentar, duhet të flasim të gjithë ashtu. Nuk është e vërtetë që duhet, nëse është i partisë sime, duhet të flas. Tjetërkund merren qëndrime partiake edhe mandej është çështje tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti është lajmëruar për replikë.

SABRI HAMITI: Jo, jo, më kanë thirr.

Zoti Kryetar, unë tjetrën herë kam folur në parim dhe unë me të vërtetë nuk e kam shfrytëzuar të drejtën për tekst. Nëse këtë tekst vendosim ta votojmë, unë kam plotë vërejtje dhe, natyrisht, do të dal t'i lexoj. Unë, tash për tash prapë nuk dua edhe një herë të përgjigjem, sepse po dua që t'ua provoj koncentrimin. Unë, kolegut tim që foli para meje, edhe një herë po i them - lexoje tekstin, se ndërmend nuk e kam t'ju them pa e parë vetë çfarë gabimesh keni, që janë materiale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Unë konsideroj që obligimet që dalin nga Rezoluta e Assamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për dënimet e krimeve dhe të gjenocidit të sistemit komunist dhe për debatin rreth tekstit të Rezolutës, tani të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet të logjikojmë shumë seriozisht dhe të sillemi konform përgjegjësi që i kemi para qytetarëve, para votuesve dhe si deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Mua nuk po më pëlqejnë këtu debatet, ...promovuese për të shitur mend dhe patriotizma, jemi shoqëri në fund të dekadës së parë të shekullit XXI dhe gjërat duhet studiuar, analizuar dhe të thuhën ashtu si janë.

Unë në parim e përkrah Rezolutën, e përkrah edhe vendimin e këtij Kuvendi që edhe Kosova, madje si vendi më i ri në botë dhe që ka pësuar më së shumti edhe si komb, edhe si vend, edhe si nocion gjeografik nga të gjitha kombet e reja dhe shtetet e reja nga ish-Federata Jugosllave. Ne kemi pësuar. Unë rrjedh nga një familje që jemi persekutuar, jemi shpronësuar dhe që 64 vjet e kam gjyshin edhe axhën që s'ju kanë gjendur eshtrat. Por, të dalim këtu dhe të bëjmë përçarje, të shesim mend dhe të flasim fjalë të mëdha për patriotizma dhe aspekte shkencore në Parlament, ju lutem, të gjitha partitë parlamentare që janë këtu në këtë Kuvend, i kanë pasur përfaqësuesit e vetë në

Komisionin për Legjislacion. Ne, si grup parlamentar i LDD-së, jemi shumë komfor, jemi shumë të ftohtë dhe kemi konsensus të plotë që kjo rezolutë, mbase edhe mund të ndryshohet, duhet të shkojë tutje, sepse rrjedh edhe si obligim, edhe si orientim i shoqërisë kosovare, edhe si projekt nacional që të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane. Dhe, rezoluta duhet të ecën tutje, dua ta përmbushim këtë obligim dhe të drejtës t'i thuhet e drejtë, të padrejtës e padrejtë, krimin krim, të adresohen, por është me rëndësi që pas aprovimit të kësaj rezolute, ekzekutivi i vendit, Qeveria e Kosovës dhe ne, si Parlament i Republikës së Kosovës, të shkojmë tutje me ligjet konkrete, por me koka të ftohta, sepse jemi popull i vogël, jemi një shtet i ri dhe jemi shtet i brishtë dhe na duhet një konsensus institucional- politik dhe nacional që të shkojmë tutje.

Unë kërkoj edhe nga kolegët tjerë deputetë që të mos bëjnë fjalime të mëdha për konsume, por thjeshtë ta shikojmë këtë çështje si tejet serioze dhe të shkojmë tutje me një konsensus edhe institucional, edhe politik, edhe nacional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Bajram Kosumi, e ka fjalën.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

I nderuari Kryeministër,
Kolegë deputetë,

Unë po dal këtu të flas se kartelën s'e kam, më ka humbur kartela që disa muaj. Kjo është arsyeja pse dal për të folur këtu.

I nderuar Kryetar dhe të nderuar kolegë,

Besoj se jemi ndër vendet e fundit në Evropë që i dënojmë krimet e komunizmit. Nuk jam krejt i sigurt, ndoshta, Serbia ende s'e ka dënuar, përndryshe të gjitha vendet e tjera ish- komuniste i kanë dënuar krimet e pushteteve komuniste. Dhe, është dashur të pritët që edhe në Kosovë të ndodhë kjo. Nuk ka ndodhur më herët, sepse s'kemi qenë shtet dhe kemi pasur detyra tjera para vetes dhe ne kemi ruajtur gjatë më shumë se një dekadë një unitet që është dashur të jetë një unitet për ta bërë shtetin e Kosovës, një unitet i përgjithshëm, dikush i thotë një unitet kombëtar, çfarëdo nocioni që përdorë, por një unitet politik është dashur të ketë shoqëria jonë, klasa jonë politike për ta realizuar shtetin e Kosovës. Shteti i Kosovës është realizuar dhe ne tash duhet të ballafaqohemi me disa prej problemeve që kemi trashëguar nga e kaluara dhe të cilat i kemi heshtur gjatë këtyre 15 – 20 vjetëve të fundit. Dënimi i krimeve të komunizmit është një prej këtyre problemeve thelbësore që ne nuk kemi folur shumë për këtë, nuk jemi marrë shumë me këtë temë, por tash duhet të merremi me këtë.

Mënyra më e lehtë mua më duket, ndoshta, që të mos merremi fare me këtë temë. Por po ju garantoj se mosmarrja me këtë temë është zgjidhja më e keqe, mosmarrja me këtë temë është do të thotë ta lëmë derën të hapur për çfarëdo forme të reagimit, qoftë për revanshizëm, qoftë për forma tjera. Mënyra më e mirë është e kundërta, marrja me këtë temë dhe Kuvendi i Kosovës duhet të merret me këtë temë. Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë rezolutën që dënon krimet e komunizmit, do të thotë do të jemi të saktë në shprehje- dënohen krimet e komunizmit. Kjo është besoj ajo që ne sot kemi në rend të

ditës dhe është një prej çështjeve më të rëndësishme me të cilat është marrë Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Dhe, unë shfrytëzoj rastin sot të shpreh respektin dhe të shpreh nderimin për gjithë ata persona, për të gjithë ata burra, ato gra, për dekada të tëra për të gjithë ato familje që me fëmijë e me pleq kanë qenë të internuar, kanë qenë të burgosur, kanë qenë të ndjekur, kanë qenë të hetuar, kanë qenë të përcjellë dhe kanë qenë të vrarë e të masakruar, të shpreh nderimin dhe respektin për qëndresën e tyre, për luftën që ata kanë bërë, për idealet e tyre, për idealet për lirinë dhe sot miratimi i kësaj rezolute është vetëm një akt simbolik për mirënjohje për ata njerëz është një akt i ri afirmimit moral, politik e unë tash do të flas edhe material, edhe një riafirmim edhe material për ata njerëz dhe për familjet e tyre.

Prandaj, them se ditë e sodit dhe miratimi i kësaj rezolute është një prej çështjeve të rëndësishme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Duke dënuar krimet e komunizmit dhe duke miratuar këtë rezolutë, unë besoj se nuk po e kryejmë punën, nuk po e mbylлим kaptinën, po e bëjmë të kundërtën. Po e hapim një kaptinë, me të cilën duhet të merremi gjithsesi dhe kërkoj edhe nga Qeveria që këtë rezolutë të mos e konsiderojë vetëm si një dokument politik që votohet në Kuvend dhe futet në sirtar. Miratimi i kësaj rezolute është njëllëloj çelësi, njëllëloj hapje e derës për Qeverinë që të fillojë një përces të përgatitjes, të infrastrukturës ligjore për trajtimin e temave që dalin nga kjo rezolutë.

Nën një, të hartohet Ligji për hapjen e dosjeve, që kjo çështje të mos i lihet stihisë, të mos i lihet opinionit. Unë e di që ka dosje, secili prej jush e di që ka dosje, ka dosje, po ku janë, ku s'janë, duhet t'i gjejmë ato! Por, do të thotë ato janë, sepse çdo pushtet komunist ka mbajtur dosje, ka bërë dosje dhe besoj shumica dërmuese e neve që jemi këtu, kemi dosje me nga mijëra faqe dhe duhet ato dosje të shikohen ashtu qysh kanë ndodhur në të gjitha vendet.

Çështja e dytë, është hartimi i Ligjit për pastërtinë e figurave publike. Nuk mundet kjo çështje aq lehtë të kalohet, duhet të përgatit Qeveria ligjin dhe ne ta diskutojmë dhe ta votojmë në Kuvend. Ligji i tretë është Ligji për ish të burgosurit politikë, i cili është përgatitur nga ekspertë dhe një grup i madh i deputetëve këtu, është nënshkruar është futur në procedurë, por ende është diku në procedurë, nuk jam krejt i sigurt ku është tash në çfarë instance, por është në procedurë, dhe hartimi i një varg ligjeve të tjera të cilat janë si rrjedhojë e miratimit të kësaj rezolute?

Unë po e përfundoj fjalën duke thënë edhe pak për aspektin teknik, nëse ka fjalë, nëse ka fjali që mund të mos qëndrojnë si duhet, është mirë pra edhe një herë Komisioni të bëjë një pauzë, të mos e shtyjë, të mos e nxjerrim prej rendit të ditës, të bëjmë një pauzë dhe të shikojmë nëse ka ndonjë paqartësi ose ndonjë fjalë që mund të rregullohet, t'i bëjmë një redaktim të tekstit, por ta votojmë sot. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet Mark Krasniqi.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Nëse mendojmë të diskutojmë për këtë temë, shumë moti ia kemi nisur, sidomos vitin e kaluar, të konsumohet kjo temë. Megjithatë, unë po e shoh që, fatkeqësisht, nuk jemi të gatshëm as teknikisht, as politikisht të hymë të punojmë në këtë drejtim. Në qoftë se mendojmë teknikisht, zoti Kryetar, është krejt e papranueshme për një gjë të tillë të na vijë materiali sot, të hyjë në rend të ditës sot kjo pikë e rendit të ditës dhe të diskutohet sot dhe të vijë në pikëpyetje a të shkojë si rezolutë, a të mos shkojë. Kolegët deputetë dalin dhe i thonë njëri- tjetrit, nuk e ke lexuar mirë dhe nuk e ke kuptuar, e ke kuptuar, domethënë kjo është një gjë që vërtet nuk është dashur të ndodhë në qoftë se ishin respektuar procedura dhe kjo ish ardhur ashtu si duhet.

Megjithatë, realisht ne kemi një material para vetes, një rezolutë e cila, për mendimin tim, është shumë e thatë, zoti Kryetar. Dënimi i sistemit komunist kush ka të drejtë më shumë në botë të kërkojë dënimin e këtij sistemi se populli shqiptar? Dhe, në qoftë se hymë të flasim për këtë periudhë, vërtet do t'i bëjmë dëm vetes, sepse unë mendoj 99% të familjeve shqiptare, por edhe të komuniteteve të tjera janë të prekur nga ky sistem. A duhet të dënohet, natyrisht se duhet dënohet, por realisht këtë po e kërkon edhe Bashkësia Evropiane. Sa jemi përgatitur ne vetëm me formë deklarative me një rezolutë ta dënojmë këtë sistem, kjo është jo e mjaftueshme. Kjo na bënë ta kuptojmë, pikërisht sot, para kësaj pike të rendit të ditës, kishim në rend dite emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe ne e pamë se na ka ardhur në Kuvend për ta votuar një njeri që nuk duhet votuar. Unë dëgjova kolegun tim këtu që mori disa shembuj që i kemi në krye të institucioneve të cilët, vërtet, ndoshta nuk e kanë vendin të jenë aty. Dhe, ndoshta është herët, sepse edhe në rezolutë shkruan pika 6: "Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për një proces gradual". Ndoshta jemi të papërgatitur, por gradual nuk ka, duhet të ngutemi, duhet t'i hartojmë ligjet dhe t'i miratojmë ligjet, për pastrimin e figurave shumë shpejtë, sepse sa më shumë të vonohemi në këtë drejtim, shumë më vështirë do ta kemi ta zëmë hapin me shtetet që veç po përgatiten për integrim dhe e kanë marrë këtë hap. Unë mendoj se nuk e kemi problem dhe e kemi obligim të ngutemi për arsye se, ndoshta, shumica e dëshmitarëve na kanë vdekur dhe kemi edhe pak, zoti Kryetar, edhe pak dëshmitarë, ata duhet t'i shfrytëzojmë edhe t'i kemi dëshmitë, të bashkëpunojmë, domethënë ne e kemi obligim më pak të debatojmë për këtë çështje, se nuk kemi nevojë të flasim për atë sistem. Të gjithë e kemi provuar në lëkurën tonë, por kemi nevojë të flasim, të gjithë të angazhohemi, t'i hapim dosjet pa dashur që t'i revanshohemi askujt, por të jemi korrektë, të sinqertë dhe ta dënojmë ashtu si duhet, por me ligj, zoti Kryetar. Andaj, unë mendoj se këtë rezolutë duhet ta miratojmë, por në këtë rezolutë duhet të hyjë decidivisht një kohë e caktuar, domethënë shumë shpejtë që ta sjellë Qeveria në Kuvend Ligjin për pastërtinë e figurës, domethënë unë nuk dua ta zgjas më shumë, ky është mendimi, mendoj edhe i grupit tonë parlamentar, dhe me këtë mendoj unë që po e përfundoj. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit!

Kjo çështje vërtet është moti, por për ta radhitur në rend të ditës, mendoj se ka votuar Kuvendi dhe nuk ka qenë vullneti im. Tekstin nuk e kam hartuar unë, këtë mendoj duhet ta keni parasysh.

Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet Nait Hasani.

MARK KRASNIQI: I nderuari Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Ju përshëndes të gjithëve për zemërsisht,

Teksti i Rezolutës së Kuvendit të Kosovës për krimet komuniste na është dorëzuar para 2 – 3 orëve, kështu që nuk ka mundësi të shqyrtohet dhe të diskutohet për te më hollësisht. Këtu u tha se nuk është fjala për ideologjinë, as për qeverinë komuniste, por vetëm për krimet e periudhës komuniste.

Megjithëse përmenden në rezolutë shumë krime të asaj kohe, asnjë nga ato nuk argumentohet me asnjë shembull. Mjerisht, shembuj të tillë në Kosovë ka pasur për së tepërmi. Nga ana tjetër, nuk përmendet motivi i krimeve të tilla, qëllimi kryesor i tyre, e tjera. Përveç kësaj, nuk përmendet me asnjë fjalë viktima e krimeve komuniste në Kosovë, as në Jugosllavi, në përgjithësi.

Unë shkurtimisht do t'i përmend disa shembuj, disa argumente të cilat mendoj se duhet patjetër ta kenë vendin në këtë rezolutë.

Para së gjithash, krimet e regjimit komunist në Kosovë kanë qenë drejtuar kundër shqiptarëve, me qëllim të pastrimit etnik të trojeve etnikisht dhe historikisht shqiptare. Këtë qëllim dhe këtë praktikë gjenocidiale e ka pasur dhe e ka zbatuar edhe regjimi në Jugosllavinë monarkiste ndërmjet dy luftërave botërore, përkatësisht nga fundi i vitit 1918 deri në prill të vitit 1941. Në atë kohë janë burgosur dhe janë likuiduar me mijëra shqiptarë të cilëve ua ka marrë tokën ai regjim dhe kështu e ka detyruar me dhunë më se 250.000 shqiptarë të emigrojnë në Turqi. Edhe gjatë sundimit të qeverisë komuniste jugosllave, gjithashtu janë shpërngulur rreth 250.000 shqiptarë në Turqi dhe pjesërisht në Shqipëri.

Akademiku serb, Vasa Çubrilloviq, dhe nobelist serb, Ivo Andriq, kanë qenë ideatorë të politikës së tillë. Çubrilloviqi ia ka paraqitur qeverisë monarkiste më 1937 elaboratin "shkencor" për pastrimin etnik të Kosovës dhe të viseve të tjera etnikisht shqiptare.

Një elaborat tjetër Çubrilloviqi ia ka paraqitur Qeverisë komuniste jugosllave në tetor 1944. Ai tekstualisht thotë se "tash lufta është në këmbë dhe masat drastike që merren për realizimin e këtij projekti nuk do të ndikojnë në opinionin ndërkombëtar, sepse lufta është luftë". Gjatë regjimit komunist janë bërë krime më të mëdha ndaj shqiptarëve, kudo në Jugosllavi, se gjatë sundimit të dinastisë së Karagjorgjeviqëve në kohën e sundimit të tyre.

Mjafton të përmendim tragjedinë e Tivarit, kur në mbarim të marsit të vitit 1950 u pushkatuan vetëm në Tivar 4200 shqiptarë të mobilizuar gjëja për të luftuar kundër nazistëve gjermanë në Dalmaci e në Slloveni. Edhe kaq viktima, ndoshta, edhe më tepër kanë pasur po këtë fat në valët e Detit Adriatik në Dubrovnik, në Trogir dhe në vende të tjera gjatë bregdetit.

Mjafton të përmenden edhe krimet e shumta ndaj shqiptarëve që i ka bërë brigada e Bokës së Kotorit në vitin 1945, e sjellë në Kosovë për pastrimin etnik nga armiqtë e popullit, kuptohet nga shqiptarët. Por, krimet e tilla nuk kanë fund, ato gjithmonë janë bërë me qëllim të pastrimit etnik të popullsisë autoktone shqiptare dhe për ta kolonizuar këtu elementin sllav, të cilit qeveria ia ka ngarkuar gjithashtu politikën e saj.

Pa argumente, më duket se rezoluta do të jetë e zbehtë dhe nuk do të jetë bindëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Përsëritës Qeverinë që ka ardhur, pikërisht për Rezolutën, që t'i dëgjojë edhe mendimet çka ka ndodhur në të kaluarën.

KRYETARI: Përqendrohu në tekstin e Rezolutës.

NAIT HASANI- Ju faleminderit shumë! Unë desha të ndalem në disa pika të Rezolutës, sepse Rezoluta ka, një tekst është i miratuar. Nuk pajtohem me disa parafolës që thanë se këtu nuk përmendet sistemi, sepse është pika e dytë e Rezolutës, ku thotë: ” krimet e regjimit”. Krimet e regjimit, do të thotë, krimet e sistemit komunist, ndërsa pika e tretë, po ashtu. Në pikën e katërt, unë kam një ndryshim që kërkoj edhe fjala “gjenocid” është në pikën e katërt, por t'i shtohet edhe një pikë e kësaj rezolute, që do të thotë që Kuvendi i Kosovës mbi këtë bazë të Rezolutës “vë para drejtësisë vendore e ndërkombëtare urdhërdhënësit dhe autorët e drejtpërdrejtë të krimeve ende të padënuara”. Kjo është një pikë që unë kërkoj të hyjë në Rezolutë, që e fuqizon Rezolutën dhe u jep mundësi qytetarëve të Kosovës ta ndiejnë shfajësimin e tyre.

Ndërsa në pikën 6 të Rezolutës është munduar të bëhet një huti dhe unë kërkoj të hiqet kjo pjesë, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për një proces. Janë shtuar fjalët “gradual”, “të përgjegjshëm”, prapë është shtuar një pjesë “dhe të planifikuar mirë”. Kjo do të thotë që na lë neve dyshime kujt duam t'ia qesim dosjet, kujt duam t'ia fshehim dosjet, kujt duam t'ia zbulojmë dosjet, kënd duam ta angazhojmë e nuk duam ta angazhojmë, cilit i jepet mundësi politike të manipulimit, kështu që unë kërkoj që këtu të hiqen këto dy pika, domethënë “Kuvendi i Kosovës angazhohet për një proces të përgjegjshëm të hapjes së dosjeve të krimeve dhe të bartësve të tyre”.

Për mua kjo një e është plotë, kurse për këtë rezolutë na obligon Asambleja e Përgjithshme e Evropës, numër 1096 dhe, në fund, pikërisht në këtë pikë të Asamblesë kërkohej: “të gjykojë ato pa kurrfarë dileme”, kështu që neve na obligojnë të marrim vendime dhe në kuadër të kësaj rezolute t'i nxjerrim ligjet, shumë ligje u përmendën, por ligjet, sidomos Ligji për fytyrat publike ose për pastërtinë e fytyrave publike, i cili do të mundësojë që të mos ketë në Gjykatën Kushtetuese ish -njerëz të komunizmit, ish-njerëz që kanë dënuar, ish- njerëz që kanë gjykuar, ish- njerëz që kanë vdekur nëpër burgje, pikërisht nga ata njerëz. Pra, të mos të kemi prokurorë të cilët i kanë, të them, duart e përlyera, të mos kemi gjykatës të cilët kanë dënuar, por të kemi njerëz të cilët janë njerëz që e duan vendin e vet, luftojnë për vend të vetin, punojnë për vend të vetin dhe janë të gatshëm ta japin kontributin e tyre.

Për mua, Rezoluta është shumë e vonshme, kjo rezolutë është dashur të ndodhë, ndoshta, menjëherë pas luftës në vitin 1999, Kuvendi i parë kur është mbledhur në vitin 2001- ta miratojë këtë rezolutë dhe prej atëherë Kuvendi i Kosovës i pari të prijë

në këtë drejtim dhe të jetë i përshtatshëm për të ardhmen që edhe në Kuvend, por edhe në shoqërinë e Kosovës të vijë njerëz tamam të cilët e meritojnë të jenë në vendet publike.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Kryeministri dhe deputeti Hashim Thaçi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet për të gjithë të pranishmit,

Ne sot e vumë në rend dite dhe është e vërtetë që e votuam, do të thotë ta fillojmë debatin lidhur me një temë apo konkretisht me Projektrezolutën që e ofroi Komisioni për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë. Por, unë kujtoj që vetë fillimi dhe vetë seanca po tregon që ky debat të merret vetëm si lexim i parë për shumë arsye, edhe politike, edhe të tjera, në mënyrë që Kuvendi, deri në seancat e tjera, deri në miratim, deri në votim të plotë të kësaj rezolute, të zhvillojë edhe më tutje debatin e brendshëm këtu, si dhe Kryesia e Parlamentit, pra, të vazhdojë debatin edhe me pjesët e tjera të shoqërisë civile, në mënyrë që kjo projektrezolutë dhe kjo rezolutë të begatohet dhe brenda saj të ketë një përmbajtje shumë më të mirë se sa që e ka tash.

Edhe unë e lexova për aq sa më lejoi koha këtë projektrezolutë brenda seancës, por kujtoj që për shkak të natyrës dhe të peshës së madhe politike që e ka, për ta shëndoshur, do të thotë, ardhmërinë tonë dhe për të bërë vlerësime sa më objektive dhe për t' i dhënë përbërje të duhur, unë kujtoj që nuk është tepër vonë që ta kemi edhe një seancë edhe dy të tjera dhe, më në fund, të miratohet kjo rezolutë, sepse kështu siç është, ka mjaft zbrazësi dhe është bajagi e pështjelluar dhe mendoj që është më mirë dhe në vetë mandatin e Parlamentit që ta formulojë për vetë peshën politike që e ka kjo rezolutë. Pra, iu bashkëngjitëm atyre që duhet brenda kësaj rezolute të qëndrojnë të gjitha ato kode brenda kësaj kornize që vërtet ne si Parlament, pra, t' i dënojmë krimet dhe gjenocidin e komunizmit në '45-tën dhe deri në luftën e fundit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Sot është iniciuar për diskutim kjo rezolutë që është inicuar më herët, që është si draft, mund të them, por pasi që u dëgjua këtu edhe më herët kërkesa që të jetë edhe Qeveria, natyrisht se edhe ne duhet ta japim mendimin tonë, por këtu do të flas edhe si kryeministër, edhe si deputet.

Jemi në muajin janar të vitit 2009, do të thotë është 19- vjetori i rënies së komunizmit në Kosovë. Unë kam qenë 20 vjeçar. Është muaji për të mbajtur mend, por edhe duhet t'ju them hapur dhe sinqerisht, edhe ditë për të ecur përpara.

Komunistët që kontrollonin krejt rajonin, kryen akte të tmerrshme. Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë. Kjo e keqe ka robëruar milionë e milionë njerëz nëpër botë, edhe në Evropën Lindore, ku është kryer terror dhe tirani, tirani mbi shumë jetë, u mbajtën në robëri, pa liri njerëzore me milionë e milionë njerëz. Ishte kohë frike, por si gjithmonë edhe kohë shprese. Dhe, për këtë shpresë njerëzit sakrifikuan. I keni edhe në sallë këtu. Besimi ynë për të ardhmen e mundi frikën dhe atë të keqe. Por, duke dëgjuar disa fjalime këtu, mendova në vetveten, thashë, mos e kemi shpikur ne komunizmin në Kosovë dhe është shpërndarë në botë?

Komunizmi ka qenë vetëm pretekst dhe mjet për shtypjen nacionale në Kosovë, të nderuar deputetë. Në Kosovë kanë ndodhur dy lloj krimesh, dhune: krimi komunist dhe gjenocidi serb, që nuk u përmend.

Kosova dinte që kjo e keqe do të mposhte kurëdoherë dhe liria do të fitohej. Populli i Kosovës nuk ka pasur probleme me regjimet, po ndërroreshin apo jo në Beograd, por ka pasur problem dhe përpjekjet e popullit të Kosovës kanë qenë për liri nacionale. Beogradi mund t'i ndërronte regjimet, por një shekull i tërë atje janë ndërruar regjimet, por dhuna ka vazhduar deri sa kulmoi me gjenocid në vitin 1999.

Pra, raportet apo përpjekjet e popullit tonë kanë qenë përpjekje për liri nacionale dhe jo për t'i ndryshuar regjimet në Beograd. Prandaj, nuk duhet përzier luftën e shqiptarëve të Kosovës për liri me asnjë ideologji. Nuk u kryen krime ndaj shqiptarëve në Kosovë në vitet '45 – '90 vetëm pse shqiptarët refuzonin komunizmin, por pse refuzonin dhe luftonin Jugosllavinë, përkatësisht Serbinë.

Beogradi terrorizonte shqiptarët, jo pse ishin të kësaj apo asaj ideologjie, por pse kërkonin liri kombëtare dhe të drejta demokratike.

Shqiptarët u dëbuan në Turqi me dhunë, jo për çështje ideologjike, por për spastrim etnik. Gjithashtu, në vitin 1968 shqiptarët u vranë e u burgosën pse kërkonin liri dhe jo për çështje ideologjike. Edhe Adem Demaçi dhe shumë të tjerë, u mbajtën në burg deri më 28 vjet, jo për çështje ideologjike, por për liri nacionale.

Vrasjet, burgosjet, keqtrajtimet e mbi 500.000 shqiptarëve më 1981-89 nga Jugosllavia, përkatësisht Serbia, ndodhën jo vetëm pse shqiptarët refuzonin të bëheshin komunistë, por pse kërkonin që Kosova të bëhej republikë.

Të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës,

Edhe pse ne nuk duhet ta harrojmë dhe nuk do ta harrojmë asnjëherë të kaluarën, është koha që të ecim përpara. Është koha për të thënë, e kaluara është e kaluar dhe shumë e hidhur, por të shikojmë dhe të punojmë për të ardhmen. Liria ngadhënjeu ashtu sikurse edhe fryma njerëzore, fryma e Kosovës është gjallë.

Kosova është shkëputur nga e kaluara, është zotuar dhe ka vizion për të ardhmen, prandaj ne duhet të ngrihemi të bashkuar si popull, si politikë, krenar me trashëgiminë tonë dhe duke kujtuar rrezikun, tiraninë që e kaluam për t'u bashkuar për të ardhmen.

Sot është dita kur ne duhet të themi hapur, të kujtojmë e mos të harrojmë dhe të ecim përpara të bashkuar për të ndërtuar një Kosovë më të fuqishme, më të përparuar, me mirëqenie sociale më të lartë për të gjithë qytetarët e Kosovës, me vizion të qartë që Kosova të jetë pjesë e NATO-së dhe e Bashkimit Evropian.

Ne na duhet uniteti dhe bashkë në demokraci dhe veprimet si në çdo vend tjetër demokratik në rajon e më gjerë.

Komunizmi si frymë dhe ideologji nuk do të dominojë kurrë më asnjëherë në vendin tonë. Komunizmi ka shkuar edhe si mentalitet nga këto hapësira, së bashku me protagonistët e tij. E ardhmja është demokratike dhe me ligje demokratike. Prandaj, të nderuar deputetë, iniciativa ka qenë e Kuvendit për këtë çështje, keni kërkuar që Qeveria të jetë në Kuvend, jemi këtu dhe çdo vendim i juaji do të jetë i respektuar për Qeverinë e Kosovës. Por, dua edhe të theksoj se lexojeni Rezolutën me vëmendje, ka edhe kosto financiare, prandaj ne do t'i kryejmë obligimet tona kushtetuese në përputhshmëri me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!
Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit!

Debati i disa deputetëve çon në drejtim të dallimeve që këtu po mundohen të paraqiten. Absolutisht nuk ka të bëjë, Kryeministrin e falënderoj për qëndrimin e paraqitur në kuptimin e asaj se çka dëshirojmë prej kësaj Rezolute. Grupi Parlamentar i LDK-së fuqishëm e ka dënuar edhe e mbështet çdo lloj krimi që regjimi komunist në të kaluarën ka bërë ndaj këtij vendi dhe ne në fillim e paraqitem admirimin tonë, simpatinë të plotë dhe mbështetjen për të gjithë ata individë, familje, njerëz dhe kolektivisht vuajtjet që i kemi kaluar në këtë rrafsh. Andaj, dëshirojmë që kjo Rezolutë mos të jetë deklarative, dëshirojmë që kjo Rezolutë të jetë e pastër, gjuha, angazhimi ynë mos të vazhdojë me debatin pas miratimit, por debati të përcjellë miratimin e diçkaje. Ne duhet të mësohemi të flasim, mandej të vendosim, e jo të vendosim e mandej të kthehemi të debatojmë. Nëse do kohë, do angazhim, do sqarim dhe qëndrimi ynë është unik në këtë rrafsh, ne mendojmë që kjo duhet të ndodhë, nuk ka alternativë tjetër.

Pika tre kërkon implikime të mëdha, dhe 1 milion shqiptarë të Kosovës, kolektivisht ky popull e ka një plagë të hapur ende në shtëpi. Përmenden regjionet me masakra. Në Gjilan janë edhe 1000 të humbur nga Lufta e Dytë Botërore, të pagjetur, janë edhe shumë varre që ju kanë mbetur rrugëve, që nuk kanë mundur të hyjnë në varreza të fshatrave dhe askush respekt as nuk ka treguar, as nuk mund të tregojë. Vjen një ditë një kohë kur duhet ta tregojmë respektin tonë, por jo në mënyrën çfarë mund të besojmë që ndodhë vetëm kështu deklarativisht, jo! Mendoj që është rruga që e paraqitem ne dhe do t'i paraqesim, ne deputetët e japim mbështetjen tonë.

Ne e dënojmë regjimin, komunizmin, sepse ata kanë bërë krime. Se sa kanë qenë dhe çfarë kanë qenë kushtet, ne e dimë. Regjimi i ka pasur njerëzit e vet, ka pasur edhe shqiptarë dhe kjo dihet publikisht. Regjimi i ka realizuar qëllimet e veta përmes

mekanizmave dhe njerëzve të vet gjithkund. Në pikën 2, absolutisht unë desha të sqaroj dhe është motivi im kryesor. Shqiptarë nuk ka pasur vetëm në Kosovë, shqiptarë ka pasur pak më shumë në ish-Jugosllavi se në Kosovë, dhe pasojat kanë qenë pak a shumë të njëjta. Në këtë rrafsh, qëndrimin tonë vetëm desha ta konfirmoj. Deputetët e LDK-së sot dinë ta paraqesin mendimin e vet, por unë si shef i Grupit Parlamentar e paraqes qëndrimin edhe të Partisë, e mbështet, e kam mbështetur kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së për iniciativë dhe ne nuk kemi prua asnjë dallim këtu. Përkundrazi, kemi dashur të kontribuojmë që kjo mënyrë e punës nuk i kontribuon as Parlamentit, as Qeverisë, as atyre njerëzve që kanë vuajtur, e numri i tyre është shumë i madh.

KRYETARI: Hetem Çeku e ka kërkuar fjalën.

RASIM SELMANAJ: I nderuar Kryetar, jam pa kartelë, kjo është arsyeja pse ka dalë emri.

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo rezolutë në retrospektivë mua më kthen personalisht 30 vjet mbrapa. Nuk kam pritur që kjo Rezolutë të jetë sot dhe as që kam përgatitur diçka, por kjo temë më provokon gjithsesi që t'i them disa fjalë.

Komunizmi ka qenë një e keqe për të gjithë popujt që e kanë provuar këtë sistem antinjerëzor dhe antidemokratik, por shqiptarët e Kosovës janë ata që kanë pësuar më së shumti ngase regjimi komunist ka qenë edhe regjim antishqiptarë për ata shtypur të drejtën tonë për vendvendosje.

Si pasojë e këtyre krimeve, qindra mijëra njerëz kanë qenë të diskriminuar në forma të ndryshme. Jo pak raste në këto tri dekadat e fundit janë në Kosovë që u janë nënshtruar këtyre krimeve, duke ua shua jetën me torturë dhe askush deri më sot nuk është marrë në përgjegjësi. Nga torturat e ish punëtorëve të sigurimit, shumë veprimtarë janë detyruar të gjuhen nga katet, siç është quajtur atëherë të SUP-it të atëhershëm dhe, një pjesë e tyre, si pasojë e kësaj kanë vdekur.

Unë po i përmendi tre shembuj: Xhemajl Blakaj, më 9 nëntor të vitit 1986 nga burgu i Pejës hedhet nga punëtorët e sigurimit të atëhershëm prej katit të tretë dhe, si pasojë e kësaj, vdes. Dua ta përmend edhe në shembull tjetër të ngjashëm. Xhemajl Berisha, më 6 prill të vitit 1989 hedhet nga burgu i Prizrenit dhe po ashtu nga kjo vdes...

KRYETARI: Rasim, me gjithë respektin, e kemi tekstin e Rezolutës. Na jemi ...

RASIM SELMANAJ: i nderuari kryetar, po flasim....

KRYETARI: Ne po flasim rreth tekstit të Rezolutës.

RASIM SELMANAJ: Ne po flasim për tekstin, i nderuar Kryetar, dhe po flasim për krimet që kanë ndodhur në kohën e komunizmit, prandaj konsideroj se jam në temë. Një

shembull tjetër, jo rastësisht po e përmendi, Mal Morina, nga Liboniqi i Pejësë në vitin 1986 është gjetur i varur në fshatin e tij të lindjes, si pasojë e ftesës nga punëtorët e sigurimit, ditë më parë ai ka qenë i ftuar dhe ka pasur ftesën tjetër me detyrë të caktuar dhe nga ky presion, ky njeri, ky veprimtar detyrohet ta bëjë këtë akt.

Përmasat e këtij gjenocidi, për të cilin po flasim sot, të komunizmit, janë shtrirë edhe në forma të tjera diskriminuese. Dëshiroj të rikujtoj lëçitjen, që ka qenë një formë e diskriminimit, sidomos të shqiptarëve, por edhe përjashtimet nga shkollat. Pa dashur të përmend veten në këtë rast, por për ta vërtetuar se çfarë formash të represionit, gjegjësisht të masave diskriminuese kanë marrë në kohën e komunizmit, jam unë një nga ata. Në vitin 1981, pas burgosjes, shkolla në të cilën unë kur kam qenë, për të treguar se ata janë luftëtarë të denjë kundër nacionalizmit dhe irredentizmit, dënimi ka qenë jo vetëm për mua, por edhe për dhjetëra të tjerë ish nxënës të gjimnazit “Vëllazëritë Frashri” ku thuhet: Rasim Selmanaj përjashtohet pa të drejtë shkollimi në asnjë shkollë në Jugosllavi, edhe pse këto në ligjet ekzistuese të kohës kur ka vepruar ky regjim, nuk kanë ekzistuar, por këta njerëz për të treguar se janë të pa... për ta vazhduar këtë luftë kundër nacionalizmit shqiptarë.

E keqja është se pjesa dërmuese e prokurorëve dhe e gjykatësve që kanë shqiptuar dënime drastike, janë gjallë, ata sot punojnë normalisht, disa edhe janë avancuar.

Këtu, në këtë Parlament ka shumë deputetë dhe udhëheqës të institucioneve që kanë qenë të goditur nga krimet e këtij komunizmi, nga krimi i këtij sistemi antishqiptar dhe unë konsideroj që të paktën do të duhej që këta njerëz që kanë zbatuar politikën diskriminuese antishqiptare, të kërkojnë falje. Sido që të jetë, një shoqëri normale dhe demokratike siç po pretendojmë të jemi ne, do të duhej që të reformojmë fillimisht sistemin gjyqësor, e pastaj para ligjeve tona demokratike të japin përgjegjësi ata që kanë bërë krime në kohën e komunizmit.

Dhe, krejt në fund, e përshëndes nxjerrjen e kësaj Rezolutive, por dëshiroj që kjo të mos mbetet Rezolutë formale, por pikat e saj të zbatohen në përpikëri, sidomos pika 4, ku thuhet, citoj pjesën e fundit të fjalisë: “vënien para drejtësisë vendore, ndërkombëtare të urdhërdhënësve dhe të autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve ende të pa dënuara”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Drita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Përshëndetje të gjithëve,

Edhe unë, po ahtu si edhe kolegët e tjerë, mendoj se është dashur të jemi të përgatitur për këtë çështje dhe jam dëshmitare se si hyri në rend dite, ndonëse unë nuk e votova për shkak se mendoj se është dashur të jetë një ditë e veçantë, ku ne do të vinim të përgatitur dhe, natyrisht, do ta kishim tekstin e draft rezolutës në dorë.

Sido që të jetë, për këtë moment dua të them vetëm disa fjalë lidhur me atë që nevoja që ne të merremi me këtë çështje, është një nevojë e domosdoshme për faktin se ka qenë një histori e cila drejtpërsëdrejti ka cenuar interesat kombëtare të shqiptarëve dhe

mendoj se Rezoluta, ashtu siç është e hartuar, duket se ka rrëshqitur më tepër apo ndoshta po ndjek linjën e modeleve të rezolutave që kanë dalë nga vendet tjera, por rasti ynë është i veçantë.

Ne të gjithë e dimë çka ka qenë komunizmi për ne. Komunizmi është ai që ka penguar Rezolutën e Bujanit, komunizmi ka forcuar idenë që kombi shqiptar të mbetet i ndarë. Babai im ka qenë i burgosur gjatë komunizmit për përpjekje për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Pra, komunizmi, nën një, e ka parashenjë etnike si një instrument politik, i cili i ka shërbyer veçanërisht Serbisë dhe dominimit serb drejtpërsëdrejti për të shkatërruar substancën shqiptare.

Meqenëse shumë është investuar dhe shumë është sakrifikuar që të ruhet kombi shqiptar, pavarësisht deportimeve e të gjitha atyre çështjeve, detyra jonë si gjeneratë që jemi sot, duhet të japim qëndrimet zyrtare se si e vlerësojnë dhe si e gjykojmë këtë periudhë dhe mendoj se një paragraf i kësaj Rezolute domosdo duhet të merret me aspektin e shtypjes kombëtare dhe nuk mund të kalojë kjo Rezolutë, e cila praktikisht merret vetëm me pasojat në planin e të drejtave të njeriut.

Rezoluta duhet përfshijë që komunizmi ka qenë instrument politik, i cili ka mbajtur të ndarë kombin shqiptar dhe e ka mbajtur të shtypur, e ka penguar emancipimin tonë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputeti, Adem Salihaj,

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të them sinqerisht, unë kam menduar që një Rezolutë kaq e rëndësishme që i dënon krimet gjysmëshekullore të komunizmit, do të duhej të debatohej dhe të kishte një atmosferë tjetër në Kuvend. Mendoj se është një akt shumë i rëndësishëm politik që shënon një vijë kufiri, një ndarje të një periudhe të madhe historike, një vijë të ndarjes së ecjes sonë përpara, të proceseve demokratike dhe një përpjekje për t'i gjykuar ato krime që kanë ndodhur në të kaluarën.

Mendoj se Kuvendi i Kosovës është vonuar pak, por megjithatë nuk është vonuar shumë. Është momenti i përshtatshëm që të aprovohet një rezolutë e tillë dhe ky moment është më i përshtatshëm sepse sot ky Parlament është Parlament i Republikës së Kosovës, është i pavarur dhe ka të drejtën legjitime që ta bëjë një gjë të tillë.

Këtu u shtrua shpesh çështja e procesit të hartimit dhe të aprovimit të kësaj Rezolute. Mua nuk më pëlqen që hyri në këtë formë sot si pikë e rendit të ditës, por sipas të gjitha gjasave, nuk kishte mënyrë tjetër, sepse Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi para 6 muajsh i ka hyrë hartimit të kësaj Rezolute, që 3 muaj e ka kryer dhe ia ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit nuk e ka proceduar për shqyrtim dhe aprovim në Kuvend.

Përkundër kësaj, Kryetari i Kuvendit ia ka kthyer një letër Komisionit, i cili ka kërkuar sqarime për këtë dhe ka kërkuar që kjo Rezolutë të harmonizohet me Kryesinë e

Kuvendit. Do të thotë, këtu ka pasur diçka që nuk ka qenë në rregull dhe e ka sjellë situatën deri këtu ku jemi sot.

Mund të them që një draft rezolutë ka qenë e përgatitur edhe nga mandati i kaluar i Kuvendit të Kosovës, e cila, sipas të gjitha gjasave, nuk ka hyrë fare në procedurë.

Mund të themi që Rezoluta për dënimin e krimeve të komunizmit është shumë e rëndësishme, veçanërisht për popullin shqiptar në Kosovë, sepse populli shqiptar i Kosovës ka qenë viktimë e dyfishtë e regjimit komunist, ka qenë viktimë e dyfishtë sepse është shtypur edhe në aspektin kombëtar, edhe në atë ideologjik dhe ka pasur pasoja më të mëdha se të gjithë popujt tjerë që kanë vuajtur nën diktaturën komuniste.

Unë kam qenë i mendimit që në Rezolutë gjërat të jenë pak më të konkretizuara, të emërtohen më konkretisht ata që kanë bërë krime. Kjo është një mundësi që të plotësohet kjo Rezolutë, megjithatë mendoj se Rezoluta është mirë dhe duhet të aprovohet, sepse hap mundësinë që të bëjë një rehabilitim politik, moral, shpirtëror e çfarëdo qoftë të të gjitha atyre qindra e mijëra viktimave që kanë qenë viktimë e këtij regjimi dhe që kanë sakrifikuar dhe pa sakrificën e të cilëve ne nuk do ta kishim këtë liri dhe demokraci që e kemi sot.

Pajtohem që mund të ketë vërejtje, nuk është një dokument i përsosur dhe nuk duhet pritur nga Komisioni që të ketë një dokument të përsosur. Rezoluta është një akt i rëndësishëm, i cili duhet të kompletohet në Kuvend dhe të aprovohet, por nuk mund të pajtohem me vërejtje të tipit se Gogoli është pas dere, se unë kam vërejtje, se ka kuptime të... është thënë ajo e kundërta e asaj që është dashur të thuhet, e tjera, e tjera, sikur dikush ka nevojë ta frikësojë Kuvendin dhe të mos e aprovojë këtë Rezolutë. Nëse vërtet ka kërkesa që të mos e aprovojme këtë rezolutë dhe janë kërkesa të arsyeshme, ne mund t'i diskutojmë dhe nuk ka arsye që dikush t'i fshehë ato. Mendoj se jemi një parlament shumë demokratik i hapët dhe transparent dhe mund ta bëjmë këtë pa asnjë problem.

Unë mendoj se me aprovimin e kësaj Rezolute hapen shumë mundësi për një proces shumë pozitiv në Kosovë, natyrisht nëse aprovohen, nxirren dhe aprovohen edhe ligjet që u përmendën këtu nga shumë deputetë dhe e bëjnë të mundur me të vërtetë dënimin e krimeve të komunizmit, po e bëjnë të mundur edhe rehabilitimin moral, politik, fizik e të gjitha format e atyre që kanë qenë viktimë të këtij krimi. Dhe, viktimë ka pasur shumë, por ne duhet të jemi të vetëdijshëm se në të gjitha segmentet e shoqërisë sonë janë edhe ata që kanë kryer krime në kohën e regjimit komunist. Janë edhe ata, mund të jenë edhe këtu, mund të jenë në të gjitha segmentet e Qeverisë dhe të institucioneve tona dhe mendoj që nuk është e moralshme as në aspektin politik e as njerëzor që të ndodhë kjo në shoqërinë kosovare, që ai që ka bërë krim dhe ai që ka qenë viktimë të punojnë, po e zëmë, në të njëjtën zyre dhe të thonë se të dytë punojnë për të mirën e kësaj shoqërie. Mendoj se kjo nuk duhet të ndodhë dhe nuk jemi që të bëjmë tash një gjenocid ndaj atyre, por megjithatë në aspektin moral dhe politik duhet të pastrohet kjo. Po ashtu, do të jetë pozitive edhe hapja e dosjeve, natyrisht e kujdesshme, por megjithatë duhet të hapen, sepse ajo është pjesë e të kaluarës sonë, pjesë e kësaj shoqërie dhe ne nuk duhet frikohemi fare prej kësaj.

Në fund, mendoj që më pozitive është që të aprovohet kjo Rezolutë kështu si është, sesa t'i hyjmë rrezikut që ta shtyjme për njëherë tjetër dhe ndoshta të mos vijë fare në Kuvend. Ky është problemi pra, unë jam i mendimit dhe kështu si është me ndonjë të metë të vogël, megjithatë është më pozitive ta aprovojmë, sesa të mos e aprovojmë fare, ta prolongojmë dhe të mos e sjellim më asnjëherë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pa dashur tash këtu t'ju maltretoj me biografinë time familjare, siç u dëgjuan, do të hyj direkt në disa propozime për tekstin. Mendoj se në tekst është dashur të përdoret fjala "raciste". Kemi këtu fjalën disa herë të përdorur "komuniste-shoviniste", por mungon fjala raciste nga vetë fakti se krimet në komunizëm, ashtu siç u cek këtu se ka pasur edhe ndaj grupeve etnike tjera, ndaj shqiptarëve kanë qenë më të ashpra pikërisht nga fakti se shqiptarët i takojnë një race tjetër, pra nuk kanë qenë sllav apo nuk janë sllav, andaj edhe krimet ndaj shqiptarëve kanë pasur elemente raciste sidomos në mes viteve '90 dhe '99.

Po ashtu, mungon fjala "okupim" për shkak se, siç e dimë, Kosova ka qenë e okupuar, andaj këto dy fjalë mua ma merr mendja se ka mënyra që të futen këtu, duke shpresuar se ky tekst do të ripërpunohet edhe një herë, pra nuk është teksti final.

Po ashtu, zoti Kryetar, unë do të doja që në këtë tekst të jetë edhe një pikë për personat të cilët, siç u përmendën këtu disa herë në mënyra të ndryshme, kanë marrë pjesë në krimet ndaj popullatës, këtu me theks të posaçëm shqiptare, po edhe ndaj të tjerëve, apo bashkëpunëtorë – t'iu ndalohet që të marrin poste me rëndësi publike. E kam parasysh, edhe këtu u përmend Ligji për pastërtinë e fytyrave publike dhe të merret në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më konkrete, por mendoj se edhe në këtë rezolutë duhet të jetë një rresht aty duke folur për këta persona, se nuk është në rregull, ashtu siç u cek këtu, që personat e njëjtë në vitin 1988 në emër të Jugosllavisë socialiste vetëqeverisëse të jenë për ndryshime kushtetuese, e sot na shesin pallavra për patriotizëm. E ka shumë të tillë dhe janë bartës të institucioneve të rëndësishme shtetërore. Nuk është në rregull që njerëzit të cilët diferencuan irredentistë, që më vonë u shndërruan në separatistë shqiptarë, apo që në mënyrë indirekte i ndihmuan procesit të diferencimit – sot të mbajnë poste të rëndësishme shtetërore, poste të rëndësishme publike. Patëm edhe këtë rastin sot të mëngjesit, të paradites, më falni, këtë personin që na servohet për ta votuar për Institutin Gjyqësor, që është një rast shumë qesharak dhe gjithmonë kjo arsyetohet me demokracinë, thuaja se demokracia njerëzve ua ndalon të drejtën kriminelëve që të rifunksionalizohen. Nuk jam për atë që atyre t'iu hiqet koka, u mor vesh, ama që të ndahet shapi prej sheqerit, duhet. Nuk është në rregull që bashkëpunëtorët e Hitlerit përsëri, pas Luftës së Dytë Botërore, të udhëheqin në Gjermani. Nuk ka ndodhur askund në botë ajo, për shkak se me vetëdije, gjithmonë po flas për ata entuziastët që i dimë publikisht, nuk po flas për agjentët sekretë, të cilët nuk i dimë dhe nuk dua të paragjykoj, por për kë duam të dimë diçka, ekzistojnë edhe më tutje dokumentet, kujt i intereson është "Rilindja", janë arkivat e i shohim se kush çka ka thënë, me çfarë entuziazmi dhe çfarë kontributi ka dhënë në sistemin monist me vetëdije të plotë. Nuk flas për ata që nga zori kanë devijuar, por po flas për këta entuziastët që tashti na shiten si patriotë.

Për ta përfunduar këtë, po them, fjala “raciste” duhet të futet aty, për shkak se në ish-Jugosllavi ka pasur dozë të racizmit goxha ndaj shqiptarëve, nga fakti se shqiptarët nuk janë sllavë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Riza Smaka!

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit!

Zoti Kryeministër, ministra dhe deputetë,

Për të folur për komunizmin, do të duheshin 24 si ideologji, si doktrinë e si politikë, e tjera e tjera. Këtu mendoj që nuk është fjala për të, por është fjala për diçka tjetër, e kemi një dokument përpara dhe për ta diskutuar. Prandaj, unë do të përpiqem për të qenë krejtësisht konciz.

Unë personalisht kur shkruaj, po e zëmë, çka do që shkruaj, që hartoj, kurrë nuk jam i kënaqur, por përpiqem edhe një herë, edhe një herë, kështu që ky tekst, natyrisht, mos ta merr hartuesi për bazë, si tendencioz, por megjithatë do të duhej të riformulohej, se i ka disa formulime të pakompletuara. Fillimisht, ju lutem, e lexoj vetëm pasusin e parë.

“Duke iu referuar Rezolutës 1481 dhe rezolutës...”. Cilës? Domethënë “së mëparshme”. Cila është ajo e mëparshme? Është shkruar pa përgjegjësi, “numër, të miratuara nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 2006, përkatësisht me 1996”. Po, ky është një tekst që nuk mund të qëndrojë as në hartimet elementare, se lëre më kështu. Ndryshe, unë këtë dokument e quaj tepër serioz, meritë për t’iu kushtuar një kujdes i veçantë.

Se ka gabime ortografike, u tha edhe nga profesori Hajdaraj. Unë do të kisha potencuar se ekziston disharmonia gjuhësore e termave në shqip, në serbisht dhe në boshnjakisht, që modeomos duhet të harmonizohen.

Për shembull, përdoret pa kriter herë “regjim” herë “sistem”, a regjimi është diçka tjetër, sistemi është diçka tjetër, ka definicione dhe janë të ndryshme, janë nocione të ndryshme.

“Populli” do të duhej të zëvendësohej me “komb”. Ja pse. Që nga revolucionet borgjeze, në Evropë është miratuar termi komb. Bile-bile, edhe ai është i diskutueshëm kur thuhet “marrëdhënie ndërkombëtare”, se kombet nuk kanë kurrfarë marrëdhënie, as e drejta ndërkombëtare. Po, quhen shtete kombëtare, asisoj sepse ato janë vërtet marrëdhënie ndërshtetërore, jo ndërkombëtare. Ekziston këtu një shprehje ndër të tjera “hetim shkencor ligjor”. Nuk ka hetim shkencor, as hetim ligjor. Domethënë, është një shprehje e papërgjegjshme. Do të ishte, eventualisht, “gjurmim”, apo “hulumtim”, ama jo hetim shkencor ligjor.

Ky dokument apelohej në preambulë. Në preambulë nuk mund të apelohej, por do të duhej të apelohej në dokument.

Të meditohej. E kemi edhe zëvendëskryeministrin më kompetent për këtë pikë që po aludoj. Të meditohej edhe për ratifikimin e Rezolutës së Asamblesë Parlamentare, sepse ne nuk jemi anëtar i EU-së, a ky është një dokument që i referohet këtij dokumenti që do të duhej të bazohej në të.

Përfundimisht, zoti Kryetar, unë angazhohem që të merren disa, veçanërisht disa thekse që i potencoi zotëri Thaçi, mua më pëlqyen shumë, zotëri Salihaj e të tjerë, të mos e teproj duke i cituar dhe, natyrisht, ka edhe nga kolegët e nderuar që kanë ngritur disa pika që do të duhej të thuheshin dhe të inkorporoheshin, të inkludoheshin në këtë tekst. Ne ta miratojmë këtë në parim, e në seancën e ardhshme do ta kishim një tekst që e meriton për të qenë tekst i kompletuar edhe me përmbajtje, po edhe me formulime adekuate. Faleminderit.

KRYETARI: Deputet, këtë po e thua në emrin tënd apo në emër të grupit parlamentar? Kemi edhe disa deputetë që janë lajmëruar për fjalë. Është mirë ose të shkurtohen fjalët, ose...Si jeni të mendimit? A po e ndërpresim? Jo, në parim, nuk është projektligj për ta votuar në parim. Deputet Ibrahim Makolli, deputeti Smaka ishte i mendimit që për shkak se teksti duhet të plotësohet, të shtyhet. A pajtohesh ti me kërkesën e tij. Ti e ke kërkuar, Grupi juaj sot e keni dhe ka hyrë në rend dite. Fjalën e ka deputetit Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me vetë faktin që ne, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, tash e tre muaj për një rezolutë e cila do të dënonte krimet e komunizmit, kemi kërkuar që kjo çështje të shtrohet sot në rend të ditës, tashmë është në rend të ditës dhe, natyrisht, varet prej deputetëve të Kuvendit se cili do të jetë trajtimi i mëtutjeshëm i kësaj çështjeje. Jemi po ashtu të vetëdijshëm që ky tekst mund të mos jetë i përkryer, por varet tashmë nga secili deputet veç e veç se cila do të jetë natyra e mëtutjeshme e trajtimit të saj. Megjithatë, ne qëndrojmë në pozicionet në të cilat kemi qenë.

KRYETARI: Fjalën e ka Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk ka dyshim se të gjithë deputetët në mënyrë unanime e dënojnë dhe ne falënderojmë komisionin parlamentar që e ka bërë punën kryesore, por unë propozoj që një komision i përbashkët nga të gjitha grupet parlamentare ta marrin tash mandatin nga ju, të punojnë në tekst të kësaj rezolute dhe kohën kur Kryesia e Kuvendit e parasheh të arsyeshme, e paraqet para deputetëve prapë.

KRYETARI: Shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Meqë shihet se rreth tekstit u bë shumë fjalë, atëherë pasi është edhe teksti, përveç të tjerash, atëherë unë mbështes propozimin e zotit Lutfi Haziri, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYETARI: Deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne nuk e mbështesim një hap të tillë. Arsyeja është shumë esenciale dhe qenësore për krejt Kuvendin e Kosovës. Ne e mbështesim nevojën se ka nevojë që ky tekst të rishikohet, mirëpo mundësia që të prolongohet forma e miratimit të kësaj rezolute për neve është e papranueshme, prandaj mendojmë dhe japim propozim, le të mbetet një orë që përfaqësuesit e grupeve parlamentare ta kryejnë punën e vet rreth këtij teksti dhe

pastaj le të vijë për miratim në seancë plenare. Kjo është forma që Kuvendi i Kosovës demonstroi seriozitetin e vet se është i gatshëm të ballafaqohet me këtë materie dhe, për fund, çdo formë tjetër që është paraqitur këtu, është ikja ndaj përgjegjësisë, është ikja, prapë po e them, ndaj përgjegjësisë dhe Kuvendi i Kosovës nuk tregon konsistencë në atë çka është deklaruar më herët sa i përket kësaj materie dhe, përfundimisht, do të jetë një mesazh jo i mirë, një porosi e keqe për qytetarët e Kosovës dhe për të gjithë ata të cilët kanë qenë viktimë e ish-sistemit. Prandaj, konsideroj që një pauzë njëorëshe, ku përfaqësuesit e grupeve parlamentare do të hartonin, edhe njëherë do të rishqyrtonin tekstin në fjalë dhe pastaj seanca plenare le ta miratojë, apo e refuzon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se e kemi dënuar komunizmin sot, e kemi shkoqur në Kuvend dhe besoj se ka pak forume në botë ku ju ka përmendur emri më shumë atij farë akademiku serb, s'po ia përmendi edhe njëherë, se hyn në rekord edhe një herë. Ua harroni emrat, se s'është bash mirë t'iu përmenden shpesh në Kuvend. Unë e thashë në fillim se mendimi im është që rezoluta është e kotë, se po humbim kohë, se edhe nëse do të donim ta votonim një rezolutë kësajsoj, është një rezolutë e keqe. Rezoluta nuk iu ndihmon njerëzve që kanë qenë viktimë të krimeve të komunizmit. Realisht, nëse lexohet mirë, ka elemente të cilat edhe mund ta amnistojnë dikë, nëse dikush do ta lexojë mbarë. Mendoj se kjo rezolutë kësajsoj nuk mund të përmirësohet as për një orë, as për dy, as për pesë. Kuvendi duhet të punojë edhe të nxjerrë diçka tjetër, e cila është diçka e vlefshme, më afatgjatë dhe e cila nuk na humb kohë tash, kur kemi shumë, shumë punë të rëndësishme për të bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni! Deputeti Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar! E tha Lutfiu, po unë ndoshta vetëm tek pjesa obligative, që do të duhej të vendosë Kuvendi. Nëse vendos, jo t'i lihet Kryesisë, kur ua merr mendja, por nëse teksti duhet të përmirësohet, siç u tha, këtu mund të vendosë ky Kuvend, që të formohet komisioni. Unë po ju lus të dëgjoni dhe, nëse është raporti i Qeverisë në seancën e ardhshme, ose mund të jetë vetëm miratimi para atij raporti në seancën e ardhshme, ose në seancën pasuese. Unë jam i mendimit që në seancën e ardhshme mund të bëhet edhe kjo, por të marrë vendim Kuvendi sot dhe kjo është obligative, pastaj nuk mund të prolongohet, siç flitet këtu, dhe s'duhet të prolongohet, s'ka asnjë arsye. Por, a ka nevojë të përmirësohet teksti, shumëkush e tha. Nëse është kjo, ju lutem, le të marrë vendim Kuvendi, të formohet komisioni prej grupeve parlamentare së bashku me Komisionin për Legjislacion dhe në takimin e radhës të jetë obligim që kjo të dalë në miratim, pa diskutime tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, është kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike që t'iu lehet shëfave të grupeve dhe komisionit. Unë mendoj se kjo edhe duhet të lihet kështu sikur që e kërkoj Lutfi Haziri, nën një. Në dy, mendoj që derisa këtu u tha se Rezoluta ka implikime buxhetore dhe, nëse ka implikime buxhetore, unë mendoj se Qeveria duhet t'i sjellë cilat janë implikimet.....

(Ndërhyrje nga deputetët)

Dhe, nuk po e zgjasim, por shkojmë e votojmë atë që e tha, do të thotë propozimin e Lutfi Hazirit – që shefat e grupeve ta harmonizojnë tekstin. Më duket është shumë e qartë. Shefat e grupeve përfaqësojnë grupet politike dhe mendoj se kanë të drejtë ta harmonizojnë tekstin. Ju lutem!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

(Ndërhyrje nga deputetët)

Urdhëro, Ibrahim Makolli! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit! Kryetar, po më duket jo e sinqertë, jo e drejtë që të kërkohet tashmë nga grupet parlamentare të përcaktojnë nga një deputet në një komision, kur grupet parlamentare janë të përfaqësuara në Komisionin për Legjislacion, i cili e ka punuar këtë rezolute. Ky Kuvend e ka plotësisht të drejtën që për secilin nen, secilën pikë të kësaj rezolute të deklarohet, mund ta hedhë, mund ta pranojë ose mund të mos e pranojë në tërësi. Por, që tash të krijohet një komision tjetër, në kohën kur 3 muaj ditë ka punuar një komision tjetër, unë konsideroj se është fyerje për deputetët veç e veç në atë komision, është edhe fyerje për grupet parlamentare. Po deklarohem që në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së nuk do të marrë pjesë asnjë deputet në një komision të tillë, sepse ne e kemi komisionin ku jemi të përfaqësuar si Grup Parlamentar.

KRYETARI: Deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër, ministra,
Deputetë, kolegë shumë të nderuar,

Ne futëm në rend dite sot, me kërkesën e një grupi parlamentar, që të diskutohet një draft, po theksoj, një draft rezolute, sepse ka qenë draft i propozuar nga komisioni dhe, në princip, unë jam që të respektohet ideja e propozuesit që të diskutohet kjo sot. Pra, ky diskutim, qoftë i kësaj natyre çfarë ndodhi këtu, tregoi që po të hapet diskutimi për një draft, siç ndodh në çdo Kuvend, ka edhe plotësime, ka ide, ka saktësime. Unë për vete dëgjova me vëmendje diskutimin e Kryeministrit. Kurrë më të koncentruar nuk e kam parë duke biseduar për një problem. Unë dëgjova disa deputetë që kanë dhënë propozime që janë shumë, shumë esenciale, unë mendoj. Tash ne jemi në procedurë. Ne duhet të jemi serioz. E kemi në rend dite, një zgjidhje sot do ta japim. Në rast se Kuvendi mendon se duhet të vazhdojë ta japim një variant përfundimtar nga kjo seancë, kjo seancë shumë lehtë mund të mbyllet sot dhe të vazhdohet nesër me tekstin e kryer, për të cilin unë pajtohem me zotin Makolli, nuk ka nevojë të krijohet kurrfarë komisioni tjetër. Ekziston komisioni i cili merr përsipër të rishqyrtojë të gjitha propozimet që kanë ardhur, të cilat mund të jenë shumë të dobishme. Bile, në disa pika shumë të dobishme. Meqë unë kisha ndërmend, duke menduar se do të bisedojmë për secilin nen veç e veç dhe i kam të gjitha vërejtjet që i kam, unë nuk po i them këtu, po ua jep vërejtjet atyre, për ta mbyllur dhe për të mos lënë moskuptime, disa nga kolegët e mi i kam edhe të zanatit, që thanë se unë po përmendi e s'po sqaroj. Atëherë, le ta lexojnë krejt ata që janë të zanatit shqip nenin 5, le ta lexojnë që tash dhe le të shohin a është mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hydajet Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Unë kam për të thënë dhe kam për të thënë shumë, më falni! Po, meqë është fjala për propozimet tash, çka të bëjmë, unë mund edhe të përmbahem dhe të mos diskutoj, për të respektuar edhe frymën, që mendoj na duhet. Megjithatë, më lejoni vetëm të përmend se ne në këtë Kuvend kemi miratuar disa rezoluta. Në secilën prej tyre kemi pasur edhe vërejtje. Nuk ka tekst me të cilin mund të kënaqet secili. Si ka thënë kardinali Rishelie: “më jep dy vargje dhe unë gjej arsye për ta varë autorin”. Gjejmë arsye, por nëse duam ta kalojmë, ka mundësi. Ne kemi kaluar Kushtetutën, kemi kaluar sa e sa ligje, kemi kaluar tani edhe, për shembull, Ligjin për dekoratat, i cili thotë se ata që kanë kaluar kohë nëpër burgje, s’mund të përfshihen në këtë ligj. Kemi kaluar Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, që thotë: “të burgosurit s’mund të jenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese” dhe s’na ka bërë ndonjë përshtypje. Bile, edhe ndonjë përpjekje për t’i korrigjuar nuk ka ecur, dhe sa e sa... Dhe, tani ka ardhur puna që ne të kapemi për aspektet ortografike, sintaksore dhe ndonjëherë terminologjike. Kurse, keni parasysh, zonja e zotërinj, së pari është një iniciativë e kamotshme. Vetëm Kosova s’ka bërë asgjë dhe Kosova ka më shumë arsye për të ecur në këtë fushë dhe për të ecur, jo për të shpupurishur plagët vjetra, jo për të hapur varrë të reja, por për ta mbyllur njëherë e përgjithmonë këtë kaptinë dhe për të hyrë në procesin e normalizimit të pajtimit dhe të ecjes përpara. E keni autorizuar komisionin. Komisioni e ka kryer punën e tij. Teksti që keni përpara është në të vërtetë një amalgamë e teksteve të vendeve tjera dhe ju siguroj, krahasoni, është më i mirë sesa secili prej tyre.

Unë i përgëzoj ata që kanë punuar. Por, mos të harrojmë vetëm që ka familje të tëra që ende e kanë dëmkën “armiqësore”. Ka njerëz që ne i nderojmë nëpër akademi përkujtimore, por në letrat tona ata janë ende “armiq të popullit, të shtetit” e tjera.

(Ndërhyrje)

Si? Ka, ka! Adem Demaçi, Ali Aliu, Kadri Osmani e tjerë që kanë mbajtur sa e sa burgje, me letra ende janë të dënuar. Unë e kam përmendur edhe në këtë sallë, kur Zijadin Spahiu, një i dënuar i 68-tës, konkurronte pas luftës për prokuror, ai refuzohet me arsyen e vetme – “ke qenë i dënuar”! Dhe, ka qenë i dënuar absolutisht pa faj. Pa faj kanë qenë edhe ata që kanë bërë vepra, po ai ka qenë krejt i rastit. Dhe, thotë: “po, më keni dënuar ju, zotëri, dhe më keni dënuar, e dini, pa faj”. Është e vërtetë, por letrat e thonë kështu!

Do ta lejojmë ne tash këtë gjendje vetëm për shkak sepse s’qenka formuluar më së miri ose siç i duket dikujt. Zotëri, le të flasim hapur. Nëse ka arsye tjera, siç kemi vepruar deri tani, ne mund të gëlltisim, mund ta zvarrisim. Por, nuk shoh ndonjë arsye, sepse është një obligim ndaj Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Rezolutës së saj, është një obligim ndaj brezave, është një obligim ndaj kategorive të tëra që janë dëmtuar dhe presin një satisfaksion. Presin një satisfaksion së paku moral.

Këtu u përmend kostoja. Dakord! Por, ju lutem, kjo është një rezolutë. Vendet tjera kanë nxjerrë madje deklaratë dhe kjo nuk shkakton kosto financiare, por kërkon që të hyhet në procesin e rehabilitimit dhe kompensimit. Nëse atje ka pastaj arsye për të kalkuluar, le ta bëjë Qeveria. Rezoluta vetëm e obligon Qeverinë. E njëjta gjë është me Ligjin për të

drejtat e ish të burgosurve politikë. Vetëm Kosova nuk e ka rregulluar këtë çështje dhe Kosova ka më shumë arsye, ju i dini arsyet, ju i dini shifrat, mos t'ua përmend unë. Dhe, përsëri, arsyeja ka qenë kostoja, edhe pse ligji në parim e rregullon çështjen dhe ia lë qeverisë që t'i rregullojë implementimin dhe koston e saj.

Prandaj, ju lutem, siç e tha edhe kolegu Kosumi, ne duhet ta mbyllim kaptinën e tensioneve, konflikteve, të represionit, e tjera, dhe të hapim kaptinën e pajtimit dhe nuk e bëjmë këtë për të hapur “Kutinë e Pandorës”, as për “ndjekje shtrigash”. Askush nuk ka arsye për t'u frikësuar. Kosova ka dëshmuar se është në gjendje që të ndërtojë unitet dhe të bëhet shembull për të gjithë tjerët. Unë jam i sigurt se kjo frymë do të na ndjek edhe në këtë proces që po hyjmë. Prandaj, unë mendoj se vërejtjet mund të merren parasysh nga komisioni dhe ne mund ta autorizojmë komisionin që të bëjë redaktuarën e fundit. Por, ndonjë vërejtje, më lejoni të jam i drejtpërdrejt, për shembull që të futet “racizmi” nuk është në asnjë nga rezolutat e vendeve evropiane dhe objektivisht nuk shoh arsye, sepse karakteri shovinist e nënkupton edhe atë. Ose që të futet fjala “komb” në vend të fjalës “popull”, ka raste kur shkon. Por, megjithatë, ne s'mund t'i ndajmë qytetarët vetëm mbi baza etnike. Është fjala për popullin e Kosovës, për popullatën e Kosovës, për të gjithë ata që kanë qenë viktimë të represionit, pa dallim nga kombësia, feja, raca, e tjera. Ka pasur edhe të kombësive tjera që kanë qenë viktima dhe, natyrisht, duhet të përfshihen. Kjo nuk e përjashton atë dimensionin që u theksua me të drejtë këtu, që është në radhë të parë antishqiptar, është gjenocidal dhe kjo është tashmë diçka e njohur.

Unë, prandaj, zoti Kryetar, ju lus për mirëkuptim që Rezoluta të mos zvarritet. Le të miratohet ashtu siç është, kurse Komisioni le të bëjë spastrimin e tekstit, lektura le ta bëjë lekturën dhe le të ecim pastaj me hapa tjerë që na presin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Jo, nuk ka replikë, sepse s'ta ka përmendur emrin! Hajt, Zafir Berisha, e ka fjalën. Deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Unë, njëherë dua të shpreh keqardhje, zoti Kryetar, se nëse ky kalkulator këtu është në rregull, unë i treti e kam kërkuar fjalën. Megjithatë, po e marr i tridhjeti dhe kjo s'është në rregull. Edhe ashtu, unë flas shumë rrallë, por unë dua të shpreh njëherë shqetësimet e mia para të gjithë kolegëve deputetë për një qasje shumë joserioze për një temë dhe rezolutë tepër serioze. Realisht, kah mesi i këtij debati konsiderova se erdhi në nivel të debati i seriozitetit, por seriozisht derisa Lutfi Haziri në vend se t'i gjykojë, i përshëndet krimet dhe nuk kërkon falje thjeshtë këtu, nuk është kah dihet se çka është kah flitet në këtë Parlament për një temë tepër interesante.

Unë, meqë e kam kërkuar fjalën i pari, kam pasur të them diçka shumë konkrete, por megjithatë nga të gjithë kolegët që u bisedua deri tash, nuk është konsumuar ajo temë. Kjo çështje po mendoj se është dashur më herët të trajtohet dhe thjeshtë ne mbi 50% të deputetëve të këtij Parlamenti i përkasim një kategorie që faktikisht jemi të shkelur në formë të ndryshme, domethënë nga regjimi komunist. Dhe, nëse nuk është bërë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kjo ndoshta ka qenë alfa dhe omega që të mundet shoqëria e Kosovës të futet në binarë të një zhvillimi të mirëfilltë, sepse nuk mund të ketë zhvillim, seriozitet dhe përgjegjësi në institucione kudo nëse janë me një vend ata që na kanë dënuar dhe ne të dënuarit. Shtrohet pyetja, pse? Sepse ata të cilët e kanë zbatuar “programin jugosllav për Kosovën”, për të cilin unë po mendoj se në pikën 2 të

Rezolutës, megjithatë, për t'i dhënë autoktoninë kësaj rezolute, duhet të përmendet për ta ditur se nuk është copy-paste kjo rezolutë e shteteve të ish-jugollsisë, por është e Kosovës. Unë mendoj se në vitet e 80-ta unë kam qenë fëmijë, nëse zoti Selmani është përjashtuar në shkollë të mesme, unë si armik i shtetit në shkollën fillore jam përjashtuar dhe, realisht, dikush e ka zbatuar “programin jugosllav për Kosovën”. Dhe, mendoj se duke qenë në Rezolutë kjo, sigurisht se disa nga bartësit e institucioneve fatkeqësisht dalë-ngadalë, nëse ka ndjenja morale, duhet të largohen sepse, në fund të fundit, Kosova pretendon të futet në Evropë dhe nuk mund të futet në Evropë me logjikën e atyre që faktikisht kanë zbatuar “programin jugosllav për Kosovën” ose kanë qenë pjesë e gjenocidit dhe e maltretimeve sistematike të sistemit komunist.

Unë, edhe një herë kërkoj, me gjithë defektet që mund të ketë Rezoluta, kjo Rezolutë të kalojë dhe realisht t'i hapë dyert miratimit të shumë ligjeve që pritet, e njëri nga ata që është edhe në sirtar duke pritur, që dalë ngadalë ne si institucione të shtetit demokratik të Kosovës para një kategorie të madhe të qytetarëve të Kosovës ta vëmë një dorë mbi ato plagë që ka krijuar regjimi komunist. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po dua të replikoj, nëse e ka keqkuptuar ose u bë lapsus-lingua diku, që, në emër të Grupit Parlamentar dhe në emrin timin thashë dënohet dhuna, dënohet dhuna dhe u jepet solidaritet familjeve, individëve, kategorive të shoqërisë sonë që kanë vuajtur nga kjo dhunë. Edhe duke qenë pjesëtar i një lëvizjeje antikomuniste në moshën fëmijërore, rinore, sido që u quajt të viteve të 90-ta, ne jemi të obliguar ta çojmë në këtë drejtim. Absolutisht! Mu për arsye se është copy-paste e shteteve tjera, që u përmendën këtu nga kryetari i Komisionit në mënyrën më të sinqertë, sepse përvojat janë në modë, nuk janë përvojë e keqe, Kroacia, Lituania, Estonia dhe Polonia kudo që është parë, sepse Asamblea Parlamentare e Këshillit të Evropës ka kërkuar nga shtetet ish-komuniste të distancohen. Ne duhet të distancohemi një ditë, më mirë sot ose tjetër... Rasti ynë specifik është diçka tjetër që folëm. Por nuk është mirë, unë dua ta sqaroj, nëse Zafiri e ka keqkuptuar, në rregull. Po, nëse Zafiri deshi veç ta përmend, të kualifikojë, është diçka tjetër, por më shumë ka mund të jetë keqkuptim, po e marr si të tillë, unë desha të sqaroj. Jo që distancohemi, por jemi larg kësaj dhe dëshirojmë që gjithmonë drejtësia të vijë në vend. Po, profesori Sabri Hamiti e përmendi, këtu ka, kjo deklaratë ka shumëçka për të cilat duhet punuar kujdesshëm. Është një periudhë kohore që është kaluar në Kosovë, është kaluar shumë gjatë dhe gjithmonë është thënë, nëse nuk gabo, komunistët ideologjinë që e kanë pasur, nuk e kanë njohur etninë. Nuk e kanë njohur etninë. Unë e përmenda në fillim, për ne si grup parlamentar, ideologjia dhe etnia kanë qenë problem i regjimit. Krimet kanë ndodhur nga regjimi për shkak të dy motiveve. Kurgjë tjetër dhe këto qëndrojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem! Urdhëroni, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Unë, duke pasur konsideratë edhe moshën e zotit Lutfi Haziri, unë ia përmenda emrin me qëllim që t'i jap mundësi që ta përmirësojë vetveten, sepse është shumë e vërtetë se ka gabuar dhe ky ishte qëllimi i gjithë asaj. Sepse, prapë po e përsëris, gjenerata e Lutfi Hazirit dhe gjenerata ime e më poshtë nuk kanë mund të jenë pjesë,

ndoshta edhe librezën komuniste ta kenë në mënyrën formale, siç e kanë marrë disa vetëm e vetëm për t'u punësuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dëgjoni! Ne do të marrim një pauzë... Ju lutem, deputetë! Duhet ta marrim një pauzë, sepse, ju e dini, e kemi bërë një votim dhe në votim me vota ndonëse të kufizuara, kërkesa e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është miratuar. Prandaj, ju lutem, shefat e grupeve në një pauzë prej 15 minutash le të vijnë e të bisedojnë me mua në zyrën time.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, a të fillojmë?

Të nderuar deputetë, në sallë jemi 64 deputetë. Ne biseduam me shefat e grupeve parlamentare. Këta janë të mendimit që Komisionit për Gjyqësi dhe Legjislacion t'i bashkohen shefat e grupeve parlamentare dhe ta përgatisin një tekst për të miratuar në seancat e ardhshme.

(Ndërhyrje)

Në seancën e ardhshme! Mirë! Në seancën e radhës. Mirë! A jeni dakord?
Faleminderit!

Lus regjinë dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Në sallë janë 69 deputetë.

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi voton që Komisionit përkatës t'i bashkohen shefat e grupeve parlamentare dhe të përgatisin tekstin e Rezolutës për seancën e radhës. Mirë u pafshim në seancën e radhës, që e kemi më 29 janar.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve